

**UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE**  
**ЈУГОИСТОЧЕН ЕВРОПСКИ УНИВЕРЗИТЕТ**  
**SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY**  
**Fakulteti i shkencave shoqërore bashkëkohore**  
**Studime posdiplomike**



**PUNIMI I MAGJISTRATURËS**

**TEMA: Marrëdhëniet ndërkombëtare në mes Republikës së Italisë dhe  
Republikës së Shqipërisë**

**Mentori:**

**Prof.Dr.Mr. JONUZ ABDULLAI**

**Kandidati:**

**SHKURTE FEJZI**

**Tetovë, 2018**

## **Përmbajtja**

### **Mirënjohje**

### **Hyrje**

#### **1. Marrëdhëniet Ndërkombëtare si realitet botërorë**

1.1. Teoritë e Marrëdhënieve ndërkombëtare

1.2. Marrëdhëniet politike ndërkombëtare

1.3. Subjektet dhe kreatorët e marrëdhënieve ndërkombëtare

1.4. Shteti Sovran si subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare

1.5. Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacia moderne

#### **2. Politika e jashtme dhe diplomacia**

2.1. Aktorët e politikës e jashtme

2.2. Roli i presidentit në politikën e jashtme

2.3. Raporti i politikës së jashtme dhe politikës së brendshme

2.4. Diplomacia publike dhe digjitalizimi

2.5. Diplomacia dhe globalizimi

#### **3. Historiku i marrëdhënieve ndërkombëtare mes Republikës së Italisë dhe Republikës së Shqipërisë**

3.1. Politika e jashtme e Shqipërisë

3.2. Politika e jashtme e Italisë dhe Marrëdhënjet bilatërale pas anëtarimit të Shqipërisë në NATO

3.3. Politika e jashtme shqiptaro-italiane nga epoka e Skënderbeut deri në shekullin

XXI

4. Shpalosja e rezultateve nga hulumtimi i realizuar në periudhën kohore: dhjetor 2018 – mars 2019

## **Mirënjohje**

Nëpërmjet këtij studimi m'u dha mundësia të shoh nga afër realitetin e politikave të jashtme dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në tërësi, dhe në mënyrë më të specifikuar të bëj analizë të gjerë mbi marrëdhënien bilaterale mes dy shteteve fqinje, siç janë Republika e Shqipërisë dhe ajo e Italisë.

Kam, kënaqësinë të shpreh mirënjohjen time më të thellë për personat të cilit me kanë dhënë mbështetjen e tyre gjatë gjithë kohës që kam punuar në këtë studim. Mentorit tim, Prof. Dr. Mr. Jonuz Abdullahi, i takon falënderim me i veçante për koordinim dhe udhëheqje profesionale të punës dhe finalizimin teorik të punimit.

Njëkohësisht falenderoj të gjithë ligjëruesit e Fakultetit të Shkencave Politike për frymëzimin që më kanë dhënë dhe kanë bërë të mundshëm zhvillimin dhe rritjen time akademike.

Asnjëherë nuk do të arrij të shpreh falënderimin tim ashtu siç e ndiej ndaj familjes sime për durimin, mirëkuptimin dhe përkrahjen në të gjitha fazat e studimit. Ky rrugëtim nuk do të ishte i mundur pa inkurajimin dhe mbështetjen e tyre.

## Hyrje

Struktura e temës së masterit mbi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacinë publike siguron një arsimim solid në njohjen e koncepteve teorike mbi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacinë që nga diplomatët dhe politologët e parë, duke kaluar pastaj në analizimin e bazës legale të politikës së jashtme italiane dhe shqipëtare, të metat dhe përparësitë e tyre. Një vend të veçant zënë mësimet lidhur me teknikat e politikës së jashtme, llojet e politikave të jashtme bashkëkohore, si dhe teoritë kyçe të cilat spjegojnë fenomenin e paqes dhe të luftës në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Disa nga specifikat e politikës së jashtme janë, fokusimi i politikës së jashtme në disa fusha të veçanta, kufizimet gjeografike, interesimi i shtuar për aleanca regjionale dhe integrimin në organizata ndërkombëtare, sidomos në ato të sigurisë. Politika e jashtme është e prirë për të zgjedhur pozicione neutrale në çështje ndërkombëtare që nuk lidhen drejtpërdrejt me interesat vitale të tij dhe në përpjekjet për gjetjen e ndonjë aleati të fuqishëm e të besueshëm.

Marrëdhëniet e mira me shtetet fqinjë ndaj proceseve integruese janë shumë të rëndësishme për politikën e jashtme. Mjetet që përdoren për realizimin e politikës së jashtme nga ana e shteteve të vogla si për shembull Shqipëria janë më të kufizuara. Këto shtete zakonisht mbështeten në përdorimin e diplomacisë si mjetin kryesor për realizimin e politikës së jashtme, posaçërisht disa formave të diplomacisë, të cilat janë më efektive për politikën e tyre të jashtme.

Më konkretisht ky studim përqëndrohet në analizen e politikës së jashtme të Italisë dhe Shqipërisë dhe kontributin e shtetit italian në rimëkëmbjen, stabilizimin dhe në integrimin evropian të Shqipërisë. Thelbi i këtij punimi qëndron tek analiza dhe ndikimi që ka pasur Italia, me anë të politikës së jashtme lidhur me procesin e rimëkëmbjes dhe të integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Duke u mbështetur në analizën e burimeve historike, në mënyrë më të veçantë të atyre pas komuniste, punimi përpiket të trajtojë në mënyrë tërësore dhe të detajuar rolin dhe kontributin e Italisë në një proces kaq të rëndësishëm.

Rënja e regjimeve komuniste në të gjithë Ballkanin Perëndimor pas viteve '90 e riktheu rajonin në radarët e diplomacisë Italiane, rajon nga i cili Italianët kishin dalë në mënyrë katastrofale pas

Luftës së Dytë Botërore. Roli I Italisë në rajon zë një vend të vëçant edhe për faktin se gërshetohet me përpjekjen e këtyre vendeve për tu integruar ne BE.

Pas ndryshimeve politike në Shqipëri, marrëdhënjet midis dy vendeve fqinjë jan ritur ndjeshëm. Në përpjekjet e para për demokraci, Italia u evidentua si një nga partnerët më të rëndësishëm strategjik të Shqipërisë, duke ndihmuar dhe kontribuar në reformat institucionale. Mëtej marrëdhënjet dypalëshe janë karakterizuar nga një aktivitet intensiv. Mbështetja italiane ishte e pranishme në pothuajse te gjitha fushat ne Shqipëri, duke rikonfirmuar faktin se Italia ishte donator kryesor dypalësh në Shqipëri. Ky intensifikim u jetësua edhe mëtej në aspektin e takimeve dypalëshe në nivele te larta, edhe në kontakte të shpeshta, që ofrojnë përmbajtje konkrete dhe efektive, poashtu kanë për qëllim të ofrojë nje analiz të përgjithshmë të marrëdhënjëve politiko-ekonomike mes dy shteteve fqinjë.

Nuk mund të mohojmë se marrëdhënjet ndërmjet dy vendeve janë karakterizuar nga një intensitet I ndryshueshëm gjat viteve të demokracisë shqiptare.

Qëllimi I këtij punimi është qe të ofrohet një pasqyrë e raporteve gjeopolitike dhe diplomatike mes dy shteteve fqinje, perfshire ngjarjet dhe marredhenjet mes dy shteteve që nga antikiteti, duke I dhene nje theks te vacant periudhes kohore post diktatoriale deri te zhvillimet e viteve të fundit të cilat kanë qenë shumë të rëndësishme për integrimin e Shqipërisë në strukturat evropiane.

## **1.Marrëdhëniet Ndërkombëtare si realitet botërorë**

Marrëdhënjet ndërkombëtare janë një discipline e rreptë të cilat gjurmët e parai kanë hasur që në antikitet, kur filloi të krijohet shteti.

Ato studiojnë tërësinë e marrëdhënieve në një shoqëri të caktuar ndërkombëtare.

Fusha e marrëdhënieve ndërkombëtare në kuptimin e ngushtë të termit ka të bëjë me marrëdhëniet midis qeverive të botës. Megjithatë këto marrëdhënie nuk mund të kuptohen të marra veçmas. Ato janë të lidhura ngushtë me faktorë të tjerë (siç janë organizatat ndërkombëtare, korporatat shumëkëmbëshe dhe individet); me struktura të tjera shoqërore (përfshinë ekonominë, kulturën dhe politikën kombëtare) dhe me ndikime gjeografike e historike. Marrëdhëniet ndërkombëtare përbëjnë një temë të gjërë e cila ka pika kontakti me disa fusha të tjera studimi.<sup>1</sup>

Ky kapitull i parë përcakton marrëdhëniet ndërkombëtare si një fushë studimi, paraqet faktorët që kanë rëndësi për to dhe rishikon rrethanat historike e gjeografike në të cilat janë vendosur marrëdhëniet ndërkombëtare.

Rritja e interesit për marrëdhënie ndërkombëtare vjen si pasojë e përmbajtjeve dhe formave të reja të veprimit ndërkombëtarë tepër të degëzuar dhe e një lidhjeje në rritje të subjekteve të ndryshme ndërkombëtare. Sipas politologut Radovan Vukadinoviq *”Kushtet ndërkombëtare ose, më mirë, zhvillimi i një mjedisi ndërkombëtarë dhe proceset që lindin aty janë duke u lidhur gjithnjë e më ngushtë me zhvillimet e mëtejshme jo vetëm të marrëdhënieve ndërkombëtare, por edhe me zhvillimin e brendshëm të shteteve moderne.”*<sup>2</sup>

Bota është bërë më e lidhur dhe më e njësuar, prandaj vëzhgimi i sjelljes së protagonistëve ndërkombëtarë kërkon patjetër një vëmendje më të madhe si për shkaqe teorike, ashtu edhe për shkaqe praktike.

Si pjesë e shkencës politike, marrëdhëniet ndërkombëtare merren me *politikën ndërkombëtare* – vendimet e qeverive në lidhje me veprimet e tyre kundrejt qeverive të tjera. Megjithatë, kjo fushë studimi është deri diku ndërdisiplinore, sepse lidh politikën ndërkombëtare me ekonominë, historinë, sociologjinë dhe disiplinën të tjera. Tradicionalisht, studimi i marrëdhënieve

---

<sup>1</sup> Joshua S. Goldstein, *Marrëdhëniet ndërkombëtare*, Dituria, 2003, fq.17

<sup>2</sup> Radovan Vukadinoviq, *Marrëdhëniet politike ndërkombëtare*, Kolegji VICTORY, Prishtinë 2009, fq.9

ndërkombëtare është përqëndruar në çështjet e luftës dhe të paqes – nënfushën e sigurimit ndërkombëtarë. Lëvizjet e armëve dhe të diploamtëve, përpilimi i traktateve dhe krijimi i aleancave, zhvillimi dhe zgjerimi i aftësive ushtarake – këto kanë qenë temat që sundonin në marrëdhëniet ndërkombëtare në të kaluarën, sidomos në vitet 1950 dhe 1960 dhe ende zënë vend qendrorë në këtë fushë.<sup>3</sup>

Ekzistojnë dy modele kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare në historinë diplomatike.

1. Modeli Evropian- i bazuar në koceptin e balancit të forcës të ndërtuar mbi modelin e shteteve kombëtare dhe sovranitetit.

2. Modeli Amerikan- i bazuar në vlerat kryesore amerikane: lirinë dhe vetëvendosjen kombëtare.<sup>4</sup>

Në Evropë, nga Kongresi i Vjenës e deri te shpërthimi i Luftës së Parë Botërore, ekzistonte bindja se ishte vendosur një system perfekt në marrëdhëniet ndërkombëtare. Mirëpo, me shpërthimi e luftës sëparë botërore ky system evropian i sigurisë dështoi, prej kurë edhe Evropa humbi primatin e udhëheqësisë diplomatike në botë. Shtetet e Bashkuara të Amerikës pas paqes së Varsavjes, e bënë të qartëse ata nuk do të luanin sipas lojërave evropiane e as do të përfillnin sistemet e tij të sigurisë së para vitit 1914. Kjo u pa aq më tepër pas shpërthimit të Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjes së “paqes së San Franciskos”, kur ishin themeluar OKB-të. Ndërkaq pas Luftës së Dytë Botërore, Evropa u gjend në situatën që të mbrohej nga jo-evropianët. Amerikanët për të parën herë u vunë në pozitë ta mbrojnë Evropën në kohë paqe në peridhën e Luftës së Ftohtë. Fundi i Luftës së Ftohtë, poashtu nga amerikanët inauguroi doktrinën e re në marrëdhëniet ndërkombëtare-atë për: “Rendin e ri botërorë”, i cili shënoi fundin e ndarjes bipolare të botës.

Si pas autorëve B.Reka, B. Bashkurti dhe Y.Sela “*Bota, sot, por edhe Evropa ndodhet para sfidave të reja dhe nga dy tendenca kontradiktore: nga coptimi dhe nga globalizimi, apo nga ndarjet dhe integrimet. Ekziston pajtimi se marrëdhëniet ndërkombëtare , sa janë shkencë po aq janë edhe realitet botërorë.*”<sup>5</sup>

Me rritjen e interesimit për marrëdhëniet ndërkombëtare gjegjësisht për aktivitetin diplomatik dhe kur diskrecioni i saj ngushtohet, u krijua modelimi i metodave të reja të diplomacisë. Edhe pse teoria e marrëdhënieve ndërkombëtare zhvillohet me praktikën e udhëheqjes së saj;

---

<sup>3</sup> Joshua S. Goldstein, *Marrëdhëniet ndërkombëtare*, Dituria, 2003, fq.18-19

<sup>4</sup> Blerim Reka, Bardhok Bashkurti, Ylber Sela, *Hyrje në Marrëdhëniet Ndërkombëtare* Arbëria Design, (viti II), fq.95

<sup>5</sup> Blerim Reka, Bardhok Bashkurti, Ylber Sela, *Hyrje në Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Arbëria Design, (viti II), fq.6

kristalizimi i këtyre teorive klasike në marrëdhëniet ndërkombëtare u arrit pas gjysmës së shekullit të kaluar.

Në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare njihen një mori funksionesh të shkëlqyeshme diplomatike. Në realitetin bashkëkohorë ato paraqesin një ambient të tregut të madh botëror. Në këtë ambient të globalizimit, shtetet pjesmarrëse ballafaqohen me politika të ndryshme, me qëllim të realizimit të interesave maksimaliste që para vetes i parashtron çdo shteti ose bashkësi shtetesh. Rritja e numrit të subjekteve në politikën e jashtme ka edhe pasoja negative sepse krijohen politika të jashtme ose kundërshtarë brenda të njejtit shtet.<sup>6</sup>

Megjithatë, është e mundshme që rregullat dhe parimet themelore të marrëdhënieve ndërkombëtare, të vazhdojnë të zbatohen edhe pse rrethanat në të cilat ato janë krijuar mund të ndryshojnë në peridhën e re që ka filluar të shpalojet. Më e rëndësishmja për këto rregulla dhe parime në dijen tradicionale mbi marrëdhëniet ndërkombëtare është koncepti i pushtetit dhe teorite e marrëdhënieve ndërkombëtare të cilat do ti trajtojmë në vijim.

---

<sup>6</sup> Jonuz Abdullai, *Politika dhe Politikat Publike*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq.152



## **1.1. Teoritë e Mrrëdhënieve ndërkombëtare**

Studiuesit e marrëdhënieve ndërkombëtare kerkojnë të kuptojnë se përse ngjarjet ndërkombëtare ndodhin në mënyrën që shfaqen e jo ndryshe. Këto përgjigje mund ti gjejmë duke gjurmuar në vijimësinë e drejtpërdrejtë të ngjarjeve dhe të vendimeve që çojnë në një rrjedhojë të veçantë. Edhe pse mund të meren përgjigje përshkruese nga më të ndryshmet, për marrëdhëniet ndërkombëtare nuk do të na mjaftojnë vetëm këto përshkrime pa pasur dije teorike dhe aftësi për përgjithësimin e tyre.

Historia e botës është historia e ndryshimit në interpretimin teorik të marrëdhënieve ndërkombëtare. Në çdo periudhë një paradigmë apo asje ndihmuese e të studiuarit të një subjekti të veçantë, si edhe marrëdhëniet ndërkombëtare, është lartësuar për të influencuar gjykimet në lidhje me faktin se cilat karakteristika të subjektit janë më të rëndësishme, cila enigmë pret që ti jepet zgjidhje, dhe se cilat kriteret do të udhëheqin investigimin. Këto paradigme apo “supozime themelore që studiuesit bëjnë rreth botës që po studiojnë” kanë një prirje për ti korriguar, në mënyrë që të spjegohen zhvillime të reja. Teoria evoluon gjithmonë si një përpjekje për të qëndruar e sinkronizuar me lavjerrësin e historisë.<sup>7</sup> Luftërat e mëdha kanë qenë veçanërisht të fuqishme në prurjen e ndryshimeve domethënëse në interpretimin teorik të çështjeve botërore. Tre luftëra të tilla, që transformuan sistemet, dominuan shekullin e XX: Lufta e Parë, Lufta e Dytë dhe Lufta e Ftohtë; dhe, në të njëjtën mënyrë, sulmi terorit i 11 shtatorit 2001, shkatërroi rregullin e mëparshëm ndërkombëtarë. Ç’do formësim i perceptimeve të politikbërjes në politikën botërore duhet të nxis zhvillimin e politikave që ruajnë më mirë rregullin botërorë. Në këtë mënyrë, teoritë që drejtojnë mendimin e politikbërësve dhe studiuesve, në rretahan të ndryshme historike, na tregojnë më shumë rreth politikave botërore në vetvete.

Qëllimi i këtij nënkapitulli është të elaborojë tre teoritë kryesore të marrëdhënieve ndërkombëtare siç janë: Teoria Realiste, Teoria Liberale dhe Teoria Konstruktiviste.

Realizmi në kontekstin e marrëdhënieve ndërkombëtare, përfshin një shumëllojshmëri të teorive dhe metodave, të cilat besojnë se shtetet janë kryesisht të motivuara nga fuqia, dëshira për pushtet

---

<sup>7</sup> Charles E. Kegley, JR. *Politikat botërore (Tendenca dhe transformimi)*, UFO Press, Tiranë, 2009, fq.26

ekonomik dhe ushtarak ose për siguri, dhe jo idealet apo etikën. Ndër teoricientët e realizmit klasikë do të veconim : Tukididi, Thomas Hobbes, Nikolo Makiaveli, Von Klausewitz, Hans Morgenthau.

Gjashtë parimet bazë të realizmit sipas Morgenthau:

- ✓ Realizmi beson se politika është qeverisje nga ligjet objektive të cilat karakterizohen nga natyra e njeriut.
- ✓ Shtyllë kryesore e realizmit politik është koncepti i interesit të përcaktuar në kushtet e fuqisë e cila injekton mënyrën racionale në çështjen e politikës, dhe kështu bën teorike të kuptuarit e politikës.
- ✓ Realizmi supozon se interesi i përcaktuar si objektiv i fuqisë është një kategori e cila është universalisht e vlefshme, por nuk do të thotë se është fikse për të gjithë. Fuqia është kontrolli i njeriut mbi njeriun.
- ✓ Realizmi politik është në dijeni të rëndësisë morale të veprimit politik.. Ai është gjithashtu në dijeni të tensionit midis komandës morale dhe kërkesave për veprim politik të suksesshëm.
- ✓ Realizmi refuzon të identifikojë aspiratat morale të një kombi të veçantë, me ligjet morale të cilat drejtojnë universin. Është koncepti i interesit të përcaktuar në aspektin e pushtetit që na mbron nga politika pa mend.
- ✓ Realizmi politik është i bazuar në konceptin pluralist të natyrës së njeriut. Por, në mënyrë autonome për të zhvilluar një teori apo sjellje politike, "njeriu politik" duhet të jetë i shkëputur nga aspekte të tjera të natyrës njerëzore.<sup>8</sup>

Realistët kanë nocione të qarta rreth sitemit ndërkombëtar dhe tiparet e tij themelore. Të gjithë realistët e karakterizojnë sistemin ndërkombëtar si anarkik. Nuk egziston asnjë autoritet mbi shtetin ; shteti është sovran.Kjo strukturë anarkike kufizon veprimet e vendimmarrësve dhe ndikon në shpërndarjen e kompetencave ndërmjet aktorëve të ndrryshëm.Sidoqoftë, realistët ndrryshojnë nga njeri-tjetri përse i përket shkallës së autonomisë së shtetit në sistemin ndërkombëtar. Realistët tradicionalë pranojnë se shtetet veprojnë në mënyrë të pavarur dhe i japin formë sistemit,ndërsa neorealistët besojnë se shtetet kufizohen nga struktura e sistemit. Për të dyja palët, anarkia është parimi bazë rregullues, ç'ka do të thotë që secili shtet në sistem, të

---

<sup>8</sup> Hans J. Morgenthau, *"Six Principles of Political Realism,"* Politics Among Nations: The Struggle for Power and Peace, Fifth Edition, Revised, page. 4-15

kujdeset para së gjithash për interesat e tij kombëtare. Realistët e karakterizojnë sistemin ndërkombëtar në bazë të përmasave të polaritetit.<sup>9</sup>

Shtetet janë aktorë të rëndësishëm pasi ata kanë fuqinë, e cila është aftësia jo vetëm për të ndikuar ndaj të tjerëve por edhe për të ndikuar përfundimet në mënyrë që të arrijnë rezultate që nuk do të vinin në mënyrë të natyrshme. Shtetet kanë fuqi si në raport me shtetet e tjerë, ashtu edhe në raport me aktorët brenda shtetit. Për realistët fuqia është monedha e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe përbën një qëllim në vetvete. Fuqia është një koncept shumë dimensional. Egzistojnë katër lloj fuqish: Burimet natyrore të fuqisë (gjeografia, resurset natyrore, popullsia); Burime të matshme të fuqisë (zhvillimi industrial, aksesimi në burime); Burime të pamatshme fuqie (imazhi kombëtar, mbështetja publike dhe lidhshipi). Fuqia e shtetit në marrëdhëniet ndërkombëtare ushtrohet nëpërmjet:

1. Mjeteve diplomatike (Negociatat)
2. Mjeteve ekonomike (Sanksioneve positive, sanksioneve negative)
3. Mjeteve ushtarake (Imponimit, permbajtjes)

Realistët e venë theksin tek interesat dhe fuqia si prioritet i shteteve. Atyre nuk u intereson koncepti i drejtësisë. I vetmi interes që shfaqin realistët për drejtësinë lidhet me dy faktorë:

- ✓ Drejtësia është celsi që siguron influencën
- ✓ Drejtësia siguron bazën mbi të cilën aktorët drejtojnë interesat e tyre

Për shpërthimin e luftës, janë akuzuar karakteristikat e udhëheqësve të veçantë dhe cilësitë e përgjithshme të njerëzve (natyra egoiste). Disa udhëheqës të veçantë, janë agresiv dhe luftënxitës. Ata e përdorin pozitën e tyre të udhëheqjes për të çuar më tej kauzën e tyre. Sipas realistëve lufta ndodh për shkak të karakteristikave personale të udhëheqësve kryesorë. Ndërsa sipas neorealitëve lufta shpërthen për shkak të strukturës anarkike të sistemit ndërkombëtar. Në një sistem të tillë, lufta është rrjedha logjike e veprimit që duhet të ndërmerret.<sup>10</sup>

Liberalizmi është ideologji politike e lindur gjatë epokës moderne dhe bashkëkohore, e cila synon të vëjë sa më shumë kufij në fuqinë dhe ndërhyrjen e shtetit, në mënyrë që të sigurojë lirinë individuale dhe si rrjedhojë autonominë e tij kreative. Liberalizmi si një doktrinë politike, në fillim ka qenë në sulm të ashpër ndaj apsolutizmit dhe privilegjit feudal, duke e mbrojtur

---

<sup>9</sup> Donnelly Jack " *Realism and international relations*" chapter III, page 7-

<sup>10</sup> [https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Realizmi\\_Klasik\\_dhe\\_Neorealizmi](https://sq.ëikipedia.org/ëiki/Realizmi_Klasik_dhe_Neorealizmi)

qeverinë kushtetuese dhe më vonë atë përfaqësuese. Ideologjia politike si një sistem mendimesh- idesh, zanafillen e vete e ka nga mesi i shekullit XVIII, si një product i Perendimit të industrializuar. Ideologjia, në këtë periudhë kohore, është paraqitur si një përmbledhje gjithëpërfshirëse idesh, me anën e së cilës një grup shoqëror krijon botkuptim të quajtur liberalizëm.

Liberalizmi ka kontribuar në formimin e idesë së demokracisë moderne, e cila hedh një hap përpara demokracisë së shumicës: të drejtat individuale dhe të minorancës nuk mund të shtypen nga shumica, edhe pse është vullneti i popullit.<sup>11</sup>

Kjo teori për ligji vëmendjen tonë mbi sjelljen e shtetit, implikimin e ndërvarësisë ekonomike, dhe rolin e normave globale dhe të institucioneve në promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtarë. Liberalet ndryshojnë nga realistët në disa pika të rëndësishme. Në bërthamën e liberalizmit është besimi tek arsyeja dhe mundësia për progress.<sup>12</sup>

Individualizmi është parimi kryesorë i ideologjisë liberale. Në realitetet, liberalizmi i kushton një rëndësi të ,adhe individit, i cili sipas tyre do të duhet të ndërtojë një shoqëri të lirë dhe të mirëqenies. Individu në këtë shoqëri do të veprojë dhe do të zhvillohet sipas aftësive të veta. Varësisht nga kapaciteti individual që posedon çdo individ, do të jetë në kërkesë të asaj që është më e mirë dhe më e vlefshme. Liberalizmi është ideologji politike që individit dhe aftësitë e tij kreative i vendos në qendër të vëmendjes, duke mbështetur çdo iniciativë individuale pa ndërhyrje nga jashtë. Disa konkluzione mund të japin përcaktimin e teorisë liberale. Këto janë:

- ✓ Nevoja për të zëvendësuar qëndrimin që shtrëngon, duke krijuar tension njësisë së qenies njerëzore me atë që shtrëngon besimin mendjengushtë nacionalist me panvarësimin e shteteve sovraane;
- ✓ Rëndësia e individit – dinjiteti i tyre esencial dhe barazia themelore përgjatë rrjedhës së historisë, dhe nevoja thelbësore për të vendosur mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirisë, përpara interesave kombëtare dhe autonomisë së shtetit;
- ✓ Përdorimi i fuqisë së ideve, nëpërmjet edukimit, për të nxitur opinionin publik kundër luftës.

Tre elementet themelore të teorisë liberale janë: arsyeja; barazia dhe toleranca; dhe konsensusi dhe kushtetueshmëria. Arsyeja në ideologjinë liberale përcakton aftësinë e individit në sjelljen e

---

<sup>11</sup> Jonuz Abdullai, *Politika dhe Politikat Publike*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq.67

<sup>12</sup> Charles E. Kegley, JR. *Politikat botërore (Tendenca dhe transformimi)*, UFO Press, Tiranë, 2009, fq.31

gjykimit të urtë në dobi të vetes. Arsyeja i mundëson individit-njeriut me aftësitë e veta që i posedon të shkoj drej tprogresit dhe zhvillimit të përgjithshëm. Barazia është elementi i dytë i teorisë liberale ku njerëzit janë të barabartë në shoqëri, ata kanë lindur të barabartë në shprehjen e vlerës morale. Ky barazim shihet në të drejtën dhe në përfaqësimin e barabartë, “veçanarisht në formën e barazië ligjore dhe barazisë politike”.

Poashtu mendimi liberal mbron tezën sipas të cilës marrëdhëniet shoqërore dhe pushteti duhet të mbështeten mbi pajtimin ose marrëveshjen e dëshiruar pa ndonjë shtypje ose ndikim. Pajtimi, si një parim i ideologjisë liberale, përqëndrohet në nevojën e pajtueshmërisë në mes të qeverisë dhe të qeverisurve. Pushteti politik, sipas ideologjisë liberale duhet të krijohet në bazë të pëlqimit të atyre ndaj të cilëve qeveris pushteti. Kushtetushmëria është një parim i ideologjisë liberale, sipas të cilës duhet ndërtuar shteti juridik. Ndërtimi i shtetit juridik, në bazë të këtij parimi do të mund të realizohet në bazë të ndarjes së pushtetit dhe të ekzistimit të kushtetutës, e cila garanton liritë dhe të drejtat e njeriut dhe përcakton raportin në mes individit dhe shtetit.<sup>13</sup>

Elementi i parë i përbashkët i mendimit liberal është dhënia e theksit në ndërmarjen e reformave politike, për të ndërtuar demokraci të qëndrueshme. Në përputhje me teorinë liberale, praktika për zgjedhjene konflikteve të aplikuara brenda vendit mund të përdoren edhe në lidhje me mosmarrëveshjet ndërkombëtare. Lideret e shoqërizuar me kulturën demokratike ndajnë një botëkuptim të njëjtë. Duke e parë politikën ndërkombëtare si një zgjatim të politikës së brendshme, ata mund ta zbatojnë gjerësisht aplikueshmërinë e normave për të rregulluar konkurrencën ndërkombëtare. Debati ndërmjet qeverisjeve demokratike rralëherë shkallëzohet në luftë sepse secila nga palët pranon legjitimitetin e tjetrit dhe pret që ai të mbështetet në mjete paqësore për zgjedhjen e konfliktit. Shtysa e dytë e përbashkët për liberalët është vënja e theksit në tregun e lirë. Idea që tregtia mund të reduktojë konfliktin është rrënjësore që në veprat e Emmanuel Kant, Charles De Secondat Montesquieu, Adam Smit, dhe në shumë mendimtarë të ndritur. Doktrina që e çliron tregun si një ndihmë në ruajtjen e mospërshkallëzimit të mosmarrëveshjeve në luftëra, mbetet një propozim i veçantë. Më në fund e përbashkëta e tretë, në teorizimin liberal është një instrument juridik për institucionet globale. Liberalët rekomandojnë zëvendësimin e politikës dhe vdekjeprurëse të balancës së fuqisë me oragnizata të bazuara në parimin që kërcënimi i paqes kudo është një kërcënim për këdo. Ata shohin politikën e jashtme sit ë hapur në një shoqëri globale që po lind, e populluar nga aktorë që njohin koston e

---

<sup>13</sup> Jonuz Abdullai, *Politika dhe Politikat Publike*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq.70

konfliktit, ndaj interesa të rëndësishme dhe mund ti realizojnë këto interesa duke përdorur institucionet për ndërmjetësimin e konflikteve apo zgjojnë pasione nacionaliste kërcënuese ndaj marrëdhënieve paqësore.<sup>14</sup>

Konstruktivizmi – Qe nga fundi i Luftës së Ftohtë shumë studiues të marrëdhënieve ndërkombëtare i janë kthyer konstruktivizmit social për të kuptuar politikat botërore. Megjithëse konstruktivizmi është “një paradigme jo e ngjajshme me interpretimet tjera, ndanë disa supozime të njëjta me realistët dhe liberalët”, ai është ndryshe. Në kontrast me realizmin dhe liberalizmin, të cilët theksojnë se si faktorët material, si fuqia ushtarake dhe mirëqenia ekonomike, ndikojnë marrëdhënie ndërmjet shteteve, teoria konstruktiviste thekson se në ç’mënyrë bota rrotullohet rreth ideve sociale, impakti i të cilave është mjaft i gjerë mbi politikat botërore. Siç cekëm edhe më parë realiteti ndërkombëtarë përcaktohet nga përfytyrimet tona mbi botën. Të gjithë ne jemi të ndikuar nga konceptimet kolektive të politikës botërore, që përforcon më shumë nga trysnia sociale që ushtron mbi ne, grupi të cilit i përkasim. Duke ditur që mënyra se si ne e kuptojmë botën është e ndërtuar nga marrëdhëniet shoqërore, dhe sesi idetë mbizotëruese formojnë besimet tona rreth asaj se çfarë është e pandryshueshme dhe se çfarë mund të reformohet, na lejon që ti shohim politikat botërore në një dritë të re kritike.<sup>15</sup>

Për konstruktivistët, loja e fuqive ndërkombëtare sillet rreth aftësive të aktorëve nëpërmjet debatit në lidhje me vlerat, për tju bindur të tjerët që të pranojnë idetë e tyre. Njerëzit dhe grupet bëhen të fuqishëm kur përpjekjet e tyre finalizohen me pranimin e ideve dhe normave që ato advokojnë, dhe me shfaqjen e një kulturë të përbashkët mirkuptimi. Kapaciteti i disa organizatave transnacionale joqeveritare aktive, si Organizata për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, apo Greenpeace, që e provojnë ndryshimin global duke bindur shumë njerëz që të pranojnë idetë e tyre rreth lirive politike dhe mbrojtjes së mjedisit, janë shembuj të asaj sesi konceptet morale dhe normat ligjore janë të pranuar gjerësisht dhe mund të ndryshojnë botën. Konstruktivistët dallojnë thellësisht nga realistët dhe liberalët pasi insistojnë më së shumti në atë që politikat botërore ndërtohen në mënyrë sociale.

Çdo teori ofron një filtër për të parë një pamje të komplikuar. Si të tilla, ato ndihmojnë në shpjegimin e supozimeve që qëndrojnë pas retorikës politike në lidhje me politikën e jashtme.

---

<sup>14</sup> Charles E. Kegley, JR. *Politikat botërore (Tendenca dhe transformimi)*, UFO Press, Tiranë, 2009, fq.33

<sup>15</sup> Charles E. Kegley, JR. *Politikat botërore (Tendenca dhe transformimi)*, UFO Press, Tiranë, 2009, fq.38

Edhe më e rëndësishme, teoritë veprojnë si një kontroll i fuqishëm për njëri-tjetrin. Zbatuar në mënyrë efektive, ato zbulojnë dobësitë në argumentet që mund të çojnë në politika të gabuara.

## **1.2. Marrëdhëniet politike ndërkombëtare**

Lidhja e sotme e subjekteve ndërkombëtare, kushtëzimi i ngjarjeve dhe proceset që po bëhen pjesë përbërëse dhe gati e përhershme e sjelljes së këtyre protagonistëve në planin ndërkombëtarë, hapin mundësinë për një vëzhgim dhe hulumtim më të rregullt të dukurive të jetës ndërkombëtare. Në bashkësinë ndërkombëtare, si një mjedis i madh që përbën kuadrin dhe njëherësh edhe vendin ku zhvillohen ngjarjet kryesore ndërkombëtare, rrjedhin procese shumë të rëndësishme, të cilat ndikojnë në dinamikën e jetës politike ndërkombëtare dhe në sjelljen e bartësve kryesorë të saj. Lëvizjet dinamike dhe të shumëllojshme në planin e gjerë ndërkombëtarë hapin mundësinë për një angazhim të gjerë të subjekteve të shumta të aksionit ndërkombëtarë, ndërsa konfliktet e forcave themelore të shoqërisë në skenën ndërkombëtare shfaqen, po ashtu, nëpërmjet kundërshtimeve ose përpjekjeve për harmonizimin e koncepteve të ndryshme kundërthënëse politiko-shoqërore dhe ekonomike.<sup>16</sup> Marrëdhëniet politike ndërmjet vendeve të ndryshme përfshinë një sërë veprimtarish – diplomacinë, luftën, marrëdhëniet tregatë, aleancat, shkëmbimet kulturore, pjesëmarrjen në organizata ndërkombëtare, e tjerë. Kushtet dhe rrethanat që ndikojnë mjaft në marrjen e vendimeve dhe masave nga ana e qeverive, pastaj pasojat që rrjedhin prej tyre dhe rezultatet e dallimet që ekzistojnë ndërmjet shteteve, përbëjnë varibalet themelore të bazave të sistemit politik ndërkombëtarë.

Shumë faktore siç janë, p.sh., ata gjeografike, demografike, ekonomike etj., mund të ndikojnë në tiparet themelore dhe në aftësinë e nje shteti, përkatësisht në vendin e tij në sistemin politik ndërkombëtarë. Këta faktorë do të marin një rëndësi akoma më të madhe kur bëhen analiza krahasuese e mundësisë së funksionimit të një shteti në kuadër të një nën sistemi ose bashkësie politike rajonale të caktuar, së cilës i përket ky shtet. Faktor mund të jetë edhe forca e drejtuar nga politika, që kthehet në një element dinamik, i cili, si i tillë, mund të ushtroj ndikim mbi marrëdhëniet ndërkombëtare. Për shembull ekonomia, si faktorë i marrëdhënieve ndërkombëtare, njëherësh është edhe forcë që ndikon në kapacitetin e një shteti të caktuar; mirëpo, në të njëjtën kohë, ajo, në kushtet e reja, gjithsesi mund të shërbejë edhe si instrument shumë i rëndësishëm i politikës së jashtme.<sup>17</sup> Në fakt subjektet e marrëdhënieve politike ndërkombëtare veprojnë me vullnet dhe vetëdije, kurse me veprimet e veta mund të ndryshojnë në kuptimin pozitiv apo

---

<sup>16</sup> Radovan Vukadinoviq, *Marrëdhëniet politike ndërkombëtare*, Kolegji VICTORY, Prishtinë 2009, fq.9,10

<sup>17</sup> Radovan Vukadinoviq, *Marrëdhëniet politike ndërkombëtare*, Kolegji VICTORY, Prishtinë 2009, fq.74



negativ marrëdhëniet ndërkombëtare. Subjekte të marrëdhënjeve ndërkombëtare janë shtetet, organizatat ndërkombëtare, levizjet e ndryshme politike, firmat ndërkombëtare, grupet e njerëzve dhe, në situatë të caktuara edhe njeriu si individ. Faktorët e marrëdhënjeve ndërkombëtare paraqiten si dukuri që ushtrojnë ndikim mbi dinamikën e marrëdhënjeve ndërkombëtare dhe mbi pozitën e një shteti të caktuar në bashkësinë ndërkombëtare, mbi proceset që lindin, mbi ndërveprimet e karakterit ndërshtetëror. Në fazën bashkëkohore të studimit të marrëdhënive ndërkombëtare faktorët marrin një vend të rëndësishëm dhe gati të gjithë studiuesit i trajtojnë ata si variable kryesore të jetës politike ndërkombëtare, në bazë të të cilave sistemi i marrëdhënive politike ndërkombëtare mund të vëzhgohet, të teorizohet dhe të analizohet.<sup>18</sup>

Në vazhdim do të shtjellojmë disa veçori themelore të faktorëve të caktuar, studimi i të cilave, mbasi kanë karakter të përhershëm, ka rëndësi për marrëdhënjet ndërkombëtare dhe, përmes të cilëve, mund të identifikohet një numër të madh ngjarjesh politike ndërkombëtare.

Faktori gjeografik- konsiderohet njëri ndër faktorët qendrorë i marrëdhënive ndërkombëtare. Nisur nga fakti se gjeografia është nëna e historisë, në të kaluarën janë bërë përpjekje për spjegimin e marrëdhënive ndërkombëtare me anë të faktorëve të tillë gjeografik. Në disa etapa të marrëdhënive ndërkombëtare u është kushtuar rëndësi e veçantë disa veçorive gjeografike dhe kjo pat gjetur jehonë të drejtpërdrejtë në formulimin e politikës së disa shteteve. Në shekullin XIX profesori gjerman Ratzel, publikoi veprën e njohur *Politische Geografie* (1897), ku shtronte idetë e veta për raportin ndërmjet gjeografisë dhe politikës. Sipas Ratzel-it, sipërfaqja e territorit ndikonte drejtpërdrejtë edhe në horizontet politike, kështu që kjo vetëdije për hapësirën është shumë më e zhvilluar te popullsia e shteteve të mëdha, sesa te banorët e shteteve të vogla, të cilët gjoja kanë në dispozicion horizonte të ngushta dhe intelekt të pakt. Secili shtet ka për detyrë të luftojë me mjedisin rrethues të jashtëm për të ruajtur hapësirën që posedon dhe secili shtet i organizuar mirë synon të rrit territorin e vet, sepse kjo rritje do të thotë “afrim të lëndës e para dhe të pasuritë”, ose të paktën, kjo jep siguri më të madhe.

Qasja gjeopolitike ndaj marrëdhënive ndërkombëtare, domethënë përpjekjet që me anë të gjeografisë të spjegohen, ose, mundësisht edhe të parashikohen marrëdhëniet ndërkombëtare, sot kanë humbur rëndësinë e tyre. Në qoftë se shikohen nga perspektiva e sotme këto spekulime mbi raportin ndërmjet hapësirës, historisë dhe politikës, mund të vihet re se pikëpamjet e

<sup>18</sup> Radovan Vukadinović, *Marrëdhëniet politike ndërkombëtare*, Kolegji VICTORY, Prishtinë 2009, fq.75

gjeopolitikave kanë qenë shumë të ndryshme dhe se ata, duke bërë spjegime gjeografike, merrnin elemente të ndryshme, që favorizonin tezat e veta.<sup>19</sup>

Faktori demografik- shpesh konsiderohet si një faktorë tejet I rëndësishëm I marrëdhënieve ndërkombëtare. Shtimi I lartë natyrorë I popullsisë që moti merej si një nga treguesit themlorë të fuqisë së shtetit dhe në bazë të tij tentohej të përcaktohej politika e një vendi dhe rëndësia e tij në marrëdhëniet ndërkombëtare. Zhvillimi I botës së pas luftës, është shumë indikativ, pikërisht në aspektin e disa shteteve, të cilat para luftës sihin shtirur si të mbipopulluara kurse presionin demografik e kishin përdorur si faktorë të angazhimit të tyre politik. Për politikën ndërkombëtare, të dhënat për numrin e banorëve të një vendi në kuadër të vlerësimit të fuqisë ushtarake të tij, në të kaluarën kanë pasur rëndësi të madhe. Megjithatë, në zhvillimin e pas luftës të marrëdhënieve ndërkombëtare një karakteristik e rëndësishme e zhvillimeve demografike lidhet me emigrimin dhe migrimin e popullsisë.

Një shembull mjaft adekuat është fenomeni I emigrimit të popullsisë shqiptare në Republikën e Italisë gjatë viteve 1990, ku si pasojë Republika e Shqipërisë dobësohej intenzivisht sin ë aspektin politik ashtu edhe në ate ekonomik.

Faktori teknologjik- I marrëdhënieve ndërkombëtare pasqyrohet në zhvillimin dinamik të hkencës dhe teknikës, gjë që përbën njërën nga karakteristikat më kryesore të zhvillimit të botë së sotmë. Për marëdeniet ndërkombëtare teknologjia, përkatësisht faktori teknologjik është I rëndësishëm si konteksst I sjelljes së njeriut dhe I zhvillimit të bashkësisë ndërkombëtare. Zhvillimi teknologjik është I pashmangshëm në dinamikën e vet, gjë që ka edhe anën positive, edhe anën negative të tij. Po të shikohet teknologjia e kohës së paqes, për shembull, përdorimi I energjisë atomike për qëllime civile, mund të përfundohet se një zhvillim I tillë I mëtejme në drejtim të përsosjes dhe të përfitimeve më të mëdha, vetëm sa mund ta përmirësojnë jetën e njeriut. Mirëpo, nga ana tjetër nëse mbahet parasysh edhe pashmangshmëria e përsosjes së vazhdueshme të armëve, gjë të cilën e vemë re përdit, mund të thuhet me siguri të plotë se kjo garë e shtrenjtë dhe e rrezikshme merr shumë miliarda të cilat do të mund të përdroeshin për qëllime shumë të dobishme dhe humane. Zhvillimi I shkencës dhe teknikës po bëhet sot treguesi kryesorë I strategjiseë kombëtare të zhvillimit. Dëshira e vendeve të reja për pavarësi politike duhet të lidhet automatikisht me përpjekjet për pavarësim teknologjik. Nga ana tjetër vendet e fuishme industriale orvaten të krijojnë një strategji të tillë të politikës së jashtme, që do të

---

<sup>19</sup> Radovan Vukadinović, *Marrëdhëniet politike ndërkombëtare*, Kolegji VICTORY, Prishtinë 2009, fq. 83

vazhdonte tu siguronte atyre qasje të lirë ndaj lëndëve të para ose tregjet tradicionale për plasmanin e prodhimeve të veta. Kriteret teknologjike konsiderohen si trehues shumë të rëndësishëm të prestigjit dhe statusit që ka një shtet në marrëdhëniet ndërkombëtare. Veçanarisht kjo është e dukshme te shtetet e mëdha, të cilat nuk kursejnë mjete që pikërisht përmes arritjeve të veta teknologjike të tregojnë përparësitë e politikës dhe modelit të tyre të zhvillimit.<sup>20</sup>

Faktori ushtarak- I marrëdhënieve ndërkombëtare, I kuptuar si mundësi e përdorimit të potencialit ushtarak, sikurse në të kaluarën, edhe sot ka rëndësi shumë të madhe në zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Nocioni i forcës ushtarake sot është shumë më I gjerë sesa konceptimi klasik I armëve të ndryshme të një ushtrie kombëtare, të cilën, përveç forcës së rregullt ushtarake, e përbëjnë edhe të gjitha ato elemente të pozitës së vendit dhe ekonomisë kombëtare që kanë lidhje të drejtpërdrejta me përgaditjen e armës në paqe dhe me përdorimin e saj eventual në luftë. Kjo do të thotë se pozita gjeografike, numri I banorëve, zhvillimi industrial, stabiliteti politik shoqërorë, mundësia e përdorimit të rrugëve të komunikimit e tjerë, janë elemente të rëndësishme të cilat, e përbëjnë nocionin e forcës ushtarake.<sup>21</sup>

Njohja e ligjshmërive të zhvillimit shoqërorë të botës dhe analiza e mundësive reale në një etapë dhe teritor të caktuar përbën parakushtin e parë të një qasjeje të tillë ndaj marrëdhënieve ndërkombëtare. Parashikimi shkencor I perspektivës së zhvillimit të ardhshëm, përkatësisht vlerësimi I faktorëve ë mund të kenë ndikim pozitiv apo negativ në kronologjinë e ngjarjeve duhet të mbështeten mbi baza reale, jashtë çdo idealizimi ose shikimi subjektivist të realitetit. Kjo do të thotë se një analzië parimore e raportit të përgjithshëm të forcave botërore dhe prirjet e zhvillimit të mëtejshëm duhet të shoqërohen nga një vlerësim I gjithanshëm dhe objektiv për raportin dhe shpërndarjen e forcave, për veprimin e ndikimeve më të ndryshme në një vend të caktuar, lidhur me përcjelljen e faktorëve ekonomik, politik, ushtarak, ideologjik ,teknologjik dhe të gjithë faktorëve të tjerë të cilët ndikojnë në përcaktimin e zhvillimeve ndërkombëtare të caktuara.

---

<sup>20</sup> Radovan Vukadinović, *Marrëdhëniet politike ndërkombëtare*, Kolegji VICTORY, Prishtinë 2009, fq.106

<sup>21</sup> Radovan Vukadinović, *Marrëdhëniet politike ndërkombëtare*, Kolegji VICTORY, Prishtinë 2009, fq.107

### **1.3. Subjektet dhe kreatorët e marrëdhënieve ndërkombëtare**

Subjektet e marrëdhënieve ndërkombëtare janë bartëse të veprimtarive dhe të ngjarjeve të caktuara, që janë karakteristike për marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo do të thotë se subjekt quhet secili bartës i një veprimtarie, e cila ndikon pozitivisht a negativisht në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kritere thelbësore përcaktuese, krahas kohëzgjatjes së një veprimtarie të tillë, domethënë vetëdija dhe synimi për të bërë a për të mos bërë diçka, janë gjithsesi edhe pasojat e një veprimi të tillë, të cilat duhet të kenë patjetër domethënie ndërkombëtare.

Vetëm kur ndodh bashkimi i kësaj veprimtarie, domethënë lidhja ndërmjet angazhimit të vullnetshëm, të vetëdijshëm dhe të qëllimshëm dhe efekteve të realizuara, të cilat kapërcejn kuadrin e kufijve shtetëror të një vendi mund të flitet për bartës të ngjarjeve dhe të veprimtarive, të cilat mund të quhen subjekte të marrëdhënieve ndërkombëtare. Rrethi i subjekteve të marrëdhënieve ndërkombëtare është shumë i gjërë dhe ai, krahas shtetit që është subjekti me i vjetër, rëndom edhe më kryesori, i veprimeve ndërkombëtare, përfshin: organizatat qeveritare dhe joqeveritare, lëvizjet politike me karakter ndërkombëtar, kombet, grupet e njerëzve dhe njeriun individ, i cili në situata të caktuara mund të veproj edhe si subjekt i marrëdhënieve ndërkombëtare.

Karakteristikë e mjedisit ndërkombëtar në të cilin veprojnë shtetet me politikën e vet të jashtme, me njëri nga karakteristikat dhe veçantitë themelore është se pikërisht shtetet sovrane dhe marrëdhëniet në mes tyre janë thelbi i atij mjedisi. Shtetet sovrane e krijojnë mjedisin ndërkombëtar dhe njëkohësisht në të veprojnë me politikën e vet të jashtme. Në mes tyre vendosen marrëdhëniet dhe shtetet i vendosin normat që i rregullojnë raportet në këtë mjedis, në bashkësinë ndërkombëtare. Në veprat e shumta që merren me marrëdhëniet ndërkombëtare, Paqja e Vestfalit e vitit 1648 merret si fillim i epokës bashkohore të marrëdhënieve ndërkombëtare. Edhe historia e marrëdhënieve ndërkombëtare e vendosin këtë ngjarje si kufi kryesor që do të ndaj marrëdhëniet e parregulluara ndërmjet shteteve me ato që do të krijohen pas vitit 1648. Lufta religjioze tridhjetëvjeqare, në të cilën morën pjesë gati të gjitha shtetet e atëhershme të Evropës, mori fund me paqen që duhej tu konvenonte të gjitha këtyre shteteve, veçanërisht protagonistëve më të fuqishëm.

Duke njohur sovranitetin kombëtar si një nga parimet kryesore, Paqja e Vestfalit ishte themeli mbi të cilin u ndërtua sistemi i marrëdhënieve të reja ndërkombëtare. Sovraniteti u bë tipari

kryesor i shteteve që i përkisnin këtij sistemi dhe ai garantonte secilit shtet të drejtën e plotë brenda kufijve të vet dhe autonomi të plotë në planin e politikës së jashtme. Sovraniteti ishte themeli i sistemit të ri të decentralizuar evropian, në të cilin njihej barazia e të gjitha shteteve. Shkelja e decentralizimit do të thoshte në të njëjtën kohë edhe shkelje e sovranitetit të njërit ose të më shumë shteteve. Autoriteti i sistemit të ri nuk mbështetej më te kisha, por mbi marrëveshjen e shteteve më të rëndësishme. Burime të reja të legjitimitetit tani ishin kongreset e fuqive të mëdha, të cilat mblidhen pas luftërave të mëdha për të arritur marrëveshje me konsensus lidhur me mundësin e funksionimit të ri të sistemit. Një tjetër karakteristikë e veprimit politika të sistemit të paqes së Vestfalis ishte vendosja e baraspeshës së forcave, ashtu që secila nga fuqitë e mëdha ndiqte me vigjilencë zhvillimet të kundërshtaret e saj, duke krijuar aleanca kur e kerkonte nevoja e ruajtjes së baraspeshës.

Shteti që është zbatues i politikës së jashtme dhe faktori kryesor në bashkësinë ndërkombëtare si subjekti i vetëm burimor si në marrëdhëniet ndërkombëtare ashtu edhe në të drejtën ndërkombëtare është bashkësi e territorit të caktuar, e popullsis në këtë territor, të pushtetit sovran dhe efektiv mbi popullsin në këtë territor, që te vendosë marrëdhëniet me shtetet e tjera. Shteti është subjekti i vetëm burimor në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe në të drejtën ndërkombëtare.<sup>22</sup>

### *Aspekti teorik I shtetit*

Shteti është nocioni më i diskutuar në shkencat shoqërore. Që nga antika në mesjetë dhe tutje deri ne kohën tonë, që nga polisitet greke e shteti skllavopronar, nga mbretëritë feudale mesjetare e shtetet sovraane të modelit Vestfalian, e deri të shtetet bashkëkohore, ai si fenomen shoqëror ishte studiuar nga më shumë disiplina: nga filozofia, sociologjia, ekonomia politike, drejtësia, dhe së fundi nga shkencat politike. Në teori dominojnë dy funksione themelore të shtetit:<sup>23</sup>

*Shteti si tatim mbledhës* - Sipas disa autorëve ajo që shtetet bënin në shekullin XVI ishte: mbledhja e taksave dhe bërja e luftrave. Sipas këtij shpjegimi, shtetet që bënin luftra me zgjerimin e territoreve, zgjerimin edhe bazën tatimmbledhëse, e më të zgjerohej edhe ushtria e tyre. Pastaj kjo ushtri ndërmerre luftëra të reja pushtuese territoriale, ato serish shtonin fuqinë

---

<sup>22</sup> E. Petriq, *Politika e jashtme*, Prishtinë, 2012, fq. 217

<sup>23</sup> Blerim Reka, Bardhok Bashota, Ylber Sela, *Marrëdhëniet ndërkombëtare*, Shkup, 2016, fq. 154

tatim mbledhëse. Dimensionit të parë tatim mbledhës së shtetit, gradualisht u forcua edhe dimensionit ushtarak i tij.

*Shteti si fuqi* - Në kuptim të këtij modeli të shteteve, mund të thuhet se shteti është koncentrim i fuqisë (dhunës), i reduktuar në fund në forcën ushtarake. Ky është koncepti (nga shekulli XIX), i cili siç po shihet doli mbi atë të konceptit bazik të shekullit XVI. Mirëpo, kjo dhunë, apo kjo fuqi e shtetit, duhet të jetë e legjitimuar. Prandaj edhe thuhet se shteti posedon monopolin e dhunës legjitime. Kjo do të thotë se shteti është institucion i cili është i legjitimuar nga populli i tij, sepse përfaqëson atë popull, vepron në emër të atij populli, brenda dhe jashtë kufijve të tij.<sup>24</sup>

Deri më tani burimi më i rëndësishëm për qasjen e parë mbetet vepra e sociologut politik dhe historianit të ekonomisë, Maks Veber. Pikënisja e Veberit, e cila binte në kundërshtim me shumicën e ideve të deri atëherëshme, ishte se shteti nuk mund të përkufizohet në lidhje me qëllimet apo funksionet e tij, por duhet kuptuar më shumë në lidhje me mjetet e tij të veçanta. Kështu ai thoshte se: “Shteti nuk mund të përkufizohet në lidhje me qëllimet e tij. Rrallë ka detyra, të cilat nuk merren në dorë nga ndonjë organizim politik dhe nuk ka asnjë detyrë, për të cilën dikush mund të thotë se i takon gjithmonë atyre organizimeve, të cilat janë ndërtuar politikisht. Si përfundim, si çdo organizim politik, shteti modern mund të përkufizohet vetëm në lidhje me mjetet, që janë specifike për të dhe konkretisht, përdorimi i forcës fizike”.

Një organizim politik i detyrueshëm, me veprimtari të vazhdueshme, do quhet shtet për aq kohë sa stafi i tij administrative të përballojë me sukses kërkesat për monopolin e përdorimit legjitim të forcës fizike për ruajtjen e rendit.<sup>25</sup> Shteti modern ka një rend administrativ dhe ligjor, i cili mund të ndryshojë me ligj, drejt të cilit orientohen aktivitetet e organizuara të stafit administrativ, që kontrollohen gjithashtu me anën e rregulloreve. Pretendimi i shtetit modern për të monopolizuar përdorimin e forcës është po aq esencial sa edhe karakteri i juridiksionit të detyrueshëm dhe veprimtarisë së tij të vazhdueshme. Termi shtet në tërësi përfshin gjithë institucionet dhe instrumentat e institucioneve dhe të pushtetit politik. Shteti modern është njëkohësisht i ndarë dhe i lidhur edhe me shoqërinë civile. Ky raport i komplikuar dhe i dyanshëm është dhe mbetet objekt debati dhe analizë në aspektin e zhvillimit të shtetit dhe të teorisë normative rreth tij. Klasikët e mendimit politik si Hobbs, Rusoi, Kanti theksonin identitetin e shtetit dhe të shoqërisë si korelacion ndërmjet tyre. Ndërsa mendimtar të tjerë si

---

<sup>24</sup> Blerim Reka, Bardhok Bashota, Ylber Sela, *Marrëdhëniet ndërkombëtare*, Shkup, 2016, fq. 154,155

<sup>25</sup> CH.Pierson, *Shteti modern*, Tiranë, 2009, fq 18

Hegel e Tokvil theksonin marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe si entitete të pavarura. Ndërsa Karl Marksi theksonte se shoqëria civile mund të formojë një entitet ekonomik me ndikim mbi sferën publike si pjesë e superstrukturës ose si bazë ekstra-institucionale në lidhje me interesa publike që përpiqen të ndikojnë mbi shtetin nëpërmjet lidhjeve të ndryshme me të. Marksistë të tjerë si Antonio Gramshi dhe neomarksistet e kohëve tona i kanë parë e i shohin shoqërit civile të integruara me shtetin në shumë forma dhe pjesë të tij ose edhe si pjesë të aparatit ideologjik shtetëror, duke përfshirë këtu organizata të nshumta.<sup>26</sup>

### *Territori*

Aspekti strategjik i territorit shtetëror ndodh shpesh të kuptohet si fuqi shtetërore, sepse prej tij burojnë mundësit e furnizimit me lëndë të para, karakteri i zhvillimit industrial dhe përdorimi i hapësirës ushtarake. E drejta ndërkombëtare nuk e percakton madhësin minimale të shtetit, si dhe as faktin që territori i shtetit duhet të jetë i perkufizuar saktësisht nga shtetet tjera. Mjafton që shteti ta ketë bërthamen e territorit që padyshim është i tij.

Në marrëdhëniet ndërkombëtare janë veçanërisht të rëndësishme konfliktet për faktin se a është krijuar ndonjë shtet i ri në ndonjë territor. Raste të tilla janë në veçanti statusi ndërkombëtar juridik i Tajvanit, problem i Abhazisë, Osetisë Jugore, dhe të ashtuquajturës Republikës së Qipros veriore.<sup>27</sup> Te të gjitha shtetet nën sovranitetin e të cilave kanë qenë shtetet e reja këmbëngulin në sovranitetin e vet. Kina rreth Tajvanit, Qiproja rreth Qipros Veriore, Serbia rreth Kosovës, Gjeorgjia rreth Abhaziz dhe Osetisë Jugore.

### *Sovraniteti*

Ekziston një pajtim i plotë për sa i përket nevojës së ekzistimit të sovranitetit, të cilin shtetet mund ta manifestojnë në planin e brendshëm dhe të jashtëm, por njëherësh është tepër vështirë që nocioni i sovranitetit në çdo situatë të percaktohet më saktësi.<sup>28</sup> Pikëpamja e Bodinovit, sipas së cilës, sovraniteti është pushteti më i lartë që nuk pranon asnjë tjetër më të lartë se ai, në fazat e ndryshme të marrëdhënieve ndërkombëtare, në veçanti pas luftës së dytë botërore, nuk do ishte e lehtë të zbatohet kundrejt të gjitha bashkësive shtetërore, formalisht të pavarura. Prandaj është më mirë të bëhet klasifikimi në sovranitetin që ka të bëjë me politikën e brendshme dhe në sovranitetin që ka të bëjë me marrëdhëniet ndërkombëtare. Sovraniteti në marrëdhëniet

---

<sup>26</sup> Lisen Bashkurti, *Diplomacia bazat teorike*, Tiranë, 2016, fq 243

<sup>27</sup> E.Petriç, *Politika e jashtme*, Prishtinë, 2012, fq 225

<sup>28</sup> <http://limit.al/2018/03/09/shteti-subjekt-i-marredhenieve-nderkombetare-kosova/>

ndërkombëtare merret si fakt, kurse qeverit trajtohen si përfaqësuese legale të bashkësis shtetërore. Sipas disa pikëpamjeve sot është e pa mundur të ketë sovranitet të plotë dhe më asgjë të kufizuar, sepse kjo do të binte në kundërshtim me mundësit e rregullimit të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe me krijimin e çfardo kornizash të një sistemi të organizuar politik ndërkombëtar. Vendosja e një raporti ndërmjet shteteve dhe normave të së drejtës ndërkombëtare është më së i domosdoshëm për ruajtjen dhe funksionimin normal të marrëdhënieve ndërkombëtare.<sup>29</sup>

Shteti është Sovran, për këtë arsye edhe qeveria e tij që e zbaton pushtetin faktik nuk mund të jetë juridikisht e nënshtuar ndonjë pushteti tjetër, por duhet të jetë pushteti më i lartë sovran. Atribut thelbësor i shtetit është sovraniteti, thelbi i sovranitetit është pavarësia. Me sovranitet duhet të kuptohet, se pushteti që e zbaton qeveria e këtij shteti, është pushteti më i lartë, në aspektin formal juridik i panënshtuar ndaj askujt dhe i pavarur prej cilitdo pushtet tjetër, pra është pushteti kulmor brenda dhe i pavarur jashtë. Pushteti Sovran nuk është absolut, është i kufizuar me rregullin juridik, me të drejtën ndërkombëtare. Mirëpo, e drejta ndërkombëtare është shprehje e vullnetit të shteteve. Më të vertet se më të kufizohet pushteti i shteteve, por me vullnetin e tyre, pasi që ato vetë e krijojnë të drejtën ndërkombëtare. Pra nënshtimi ndaj të drejtës ndërkombëtare assesi nuk e mohon sovranitetin e shtetit.<sup>30</sup>

Sovraniteti është nocioni themelor i të drejtës ndërkombëtare, që shenon pushtetin kulmor dhe të pandarë siç e ka shteti, që ta zbatojë dhe ta sigurojë respektimin e ligjeve të tij brenda kufijve të vet.

### *Popullsia*

Në marrëdhëniet ndërkombëtare është e rëndësishme popullsia e shtetit, si popullsia e vet ashtu edhe popullsia e shteteve tjera, të atyre që me politikën e vet të jashtme ballafaqohet shteti. Popullsia e shtetit është bashkësi e personave mbi të cilët ai e zbaton pushtetin e vet kulmor. E drejta ndërkombëtare nuk e percakton kufirin e poshtëm të numrit të popullsisë që të flasim për shtetet. Kështu sot, shtetet dhe anëtarët e OKB-së dhe "shteteve sovra" janë edhe shtetet me disa dhjetëra banorë, apo me disa mijëra banorë (Monako, San Marino, Lihtenshtajni, Andora). Disa shtete kanë disa qindra milionë apo madje edhe mbi një miliard banorë (Kina, India, SHBA). Si shtetet e para ashtu edhe të dytat, si shtete dhe si anëtarë të OKB-së janë formalisht të

---

<sup>29</sup> Radovan Vukadinoviç, *Marrëdhëniet politike ndërkombëtare*, Prishtinë, 2006, fq.126

<sup>30</sup> E.Petriç, *Politika e jashtme*, Prishtinë, 2010, fq.236



barabarta. Parimisht janë të barabarta në të drejta dhe në obligime sipas të drejtës ndërkombëtare, por kuptohet, edhe për shkak të dallimeve në numrin e popullatës janë të ndryshme sipas fuqisë dhe sipas rolit faktik në jetën ndërkombëtare. Pikërisht popullsia është njëri nga elementet më të rëndësishme të fuqisë së shtetit, me ç'rast nuk kemi të bëjmë vetëm me numrin, por edhe me kualitetin e saj (unitetin apo jo unitetin, shkallen e zhvillimit dhe dallimet në fe, në gjuhë, në kulturë, në arsim, në lojalitet, në gjendjen shëndetësore, etj. Popullsia e shtetit si element i fuqisë së tij ndikon dukshëm në politikën e jashtme të secilit shtet, qoftë si shkak për konflikte me shtete tjera, qoftë si bartës i opinionit publik.<sup>31</sup> Banorët e shtetit janë qoftë shtetasit e tij, qoftë ata që kanë shtetësi tjetër, apo kanë ndonjë status tjetër të rregulluar ndërkombëtar –juridik, psh.statusin e të huajit, statusin e refugjatit, por që banon në shtet. Se kush e ka shtetësin dhe kush guxon të banojë në territorin e atij shteti parimisht vendos secili shtet sovran vetëm, por, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare që i vendos kufizimet në këtë vendimmarrje, para se gjithash nga aspekti i ruajtjes së të drejtave të njeriut. Parimi themelor mbetet: vendimi mbi popullsinë është shprehje e sovranitetit shtetëror.<sup>32</sup>

Çështjet në lidhje me popullsinë e shtetit janë shpesh objekt i konfliktit ndërmjet shteteve si nëse kemi të bëjmë me problemet e shtetësisë, me problemet e dëbimit dhe ekstradimit, me çështjet në lidhje me statusin e refugjatëve dhe të azilit, pra, të drejtën e popullsisë që të zgjedhë ndërmjet shtetësive, mbrojtjen e pakicave, etj. Këto çështje, shpesh problematike edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare, janë shpesh objekt i politikës së jashtme. Përveç numrit të banorëve dhe atyre elementeve që u përmendën, për marrëdhëniet ndërkombëtare mund të jetë me shumë rëndësi përbërja e popullsisë së një vendi, domethënë, nëse kemi të bëjmë me një komb homogjen apo me një bashkësi shumëkombëshe, me çfarë shkalle integrimi të tyre kemi të bëjmë, cili komb është numerikisht zotëruar, etj.

Problem i posaçëm në marrëdhëniet ndërkombëtare bashkëkohore janë migracionet bashkëkohore të popullsisë, vecanërisht të ashtuquajturat migracionet ilegale. Migracionet e mëdha që ndodhin për shkaqe ekonomike dhe demografike prej pjesëve të pazhvilluara të botës në territorin e BE-së, SHBA-ve dhe Kanadasë shpërngulet një numër i madhë i njerzve. Migracionet masive kanë krijuar bashkësi të numerta, që sipas mënyrës së jetës, traditave, kulturës, gjuhës, fesë, dallojnë nga popullsia autoktone.

---

<sup>31</sup> E.Petriç, *Politika e jashtme*, Prishtinë, 2012, fq.219

<sup>32</sup> E.Petriç, *Politika e jashtme*, Prishtinë, 2012, fq.220

### *Qeveria*

Ekzistimi i një pushteti të organizuar, që është në gjendje të kontrolloj popullsin dhe territorin, përbën një element tjetër të rëndësishëm, të cilit supozohet ta ketë secili shtet bashkëkohor. Qeveria zgjidhet dhe organizohet në përputhje me legjislacionin kombëtar, kurse punët e jashtme, që kanë rëndësi të veçantë, ushtrohen përmes autoritetit special të punëve të jashtme.<sup>33</sup> Ka shumë raste kur qeveria, për shkaqe të ndryshme, nuk është në gjendje të kontrolloj situatën në vendin e vet. Nëse behet fjalë ekskluzivisht për një situatë të brendshme, (kryengritje ose revolucion), ekzistimi i shtetit nuk vihet në pikëpyetje deri në momentin e angazhimit të forcave të konsiderueshme të jashtme. Në historinë e marrëdhënieve ndërkombëtare mund të gjejm një varg shembujsh të njohjes madje edhe të atyre qeverive që kishin humbur faktikisht kontrollin mbi vendet e veta dhe ndodheshin në emigrim.

---

<sup>33</sup> Radovan Vukadinoviç, *Marrëdhëniet Politike ndërkombëtare*, Prishtinë, 2006

## **1.4 . Shteti Sovran si subjekt I marrëdhënieve ndërkombëtare**

Shteti është një koncept shumë i rëndësishëm në studimin e politikës, prandaj gjithmonë ka qenë çështje diskutimi dhe vazhdon të jetë preokupim i hulumtuesve bashkëkohorë, në veçanti sot, gjatë debateve të shumta shkencore për rendin e ri botërorë.

*“Shteti është një tërësi e dallueshme institucionesh politike, qëllimi i veçantë I të cilëve është organizimi i studimit, në emër të interes të përbashkët, Brenda një teritori të caktuar.”<sup>34</sup>*

Për të dalluar shtetin nga shoqëria civile dhe shtetin nga aparati shtetërorë-ekzekutiv, politologu A.Heywood parashtroi një bazë sipas të cilës klasifikoi pesë veçori të shtetit:

1. Shteti është Sovran.
2. Institucionet e shtetit janë qartazi “publike” për dallim nga institucionet “private” të shoqërisë civile.
3. Shteti – ushtrim legjitimiteti.
4. Shteti është një mjet studimi.
5. Shteti është një njësiterritoriale.<sup>35</sup>

Pa hyrë në elaborime më të thella socio- filozofike të problemit të shtetit, gjë që edhe nuk është lëndë e tezës sime, mund të japim vetëm një prerje të përgjithshme të të gjitha teorive mbi shtetin dhe atë në dy grupe të mëdha teorish mbi shtetin:

1. Teoritë sociologjike, (që shtetin e shpjegojnë si fenomen shoqëror) dhe
2. Teoritë jo-sociologjike, (teologjike, që shtetin e shpjegojnë si një fenomen jo-shoqëror).<sup>36</sup>

Si rrjedhorë e shekullarizimit të shoqërive perëndimore kah mesi I shekullit XVII dhe humbjes së dominimit politik të kishës katolike në Evropë, sidomos pas paqes së Vestafalisë (1648), dhe në kontestin e iluminizmit fillojnë botëkuptimet fetare të marrin gjithnjë e më shumë karakterin e çështjes private sesa si rend shoqërorë e politik i dominuar nga pushteti religjioz. Në këtë atmosferë të konflikteve të ashpra, por edhe të krizës së pushtetit të kishës dhe mbretit, filluan

---

<sup>34</sup> Jonuz Abdullai, *Politika dhe Politikat Publike*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq.52

<sup>35</sup> Jonuz Abdullai, *Politika dhe Politikat Publike*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq.54

<sup>36</sup> Blerim Reka, *Hyrje në Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Arbëria Design, Shkup, 2016, fq.53

ideologjitë e reja politike që ta përmbushin një zbrazëturë që la pas veti botkuptimi fetar dhe legjitimimi monarkist i politikës. Prandaj ishte nevojë imediate e kohës, formimi i një rendi dhe organizimi të ri shoqërorë e politik, pra edhe të krijimit të shtetit modern ose komb-shtet.<sup>37</sup>

Kësaj i parapriu edhe ndërrimi radikal i konceptimit të shtetit modern dhe ndarjes së pushtetit, nga një filozofi politike iluministe, promovuar nga Nikolla Makiavelli, Tomas Hobsi, Xhon Loku, Emanuel Kanti, Zhan Zhak Ruso e deri tek Karl Monteskuju.

Kthesa pragmatike në historinë moderne të marrëdhënieve ndërkombëtare ishte Traktati I Vestfalisë nga viti 1648, i cili pasoi pas luftës Tridhjetë Vjeçare ndërmjet Perandorisë së shenjtë Romake (në territorin e sotëm të Gjermanisë) dhe rivalet e saj.

Paqja e Vestfalisë u konfirmua edhe nga Traktati I Utrechtit (1713) ku përsëritej parimi se sovraniteti kombëtarë i çdo shteti duhej respektuar nga të gjithë shtetet. Kjo ide e barazisë në bazë të sovraniteti mundësoi çdo shteti të drejtën për të ndjekur politikën e brendshme dhe të jashtme pa ndërhyrje nga jashtë – gjë që përfaqëson parimin bazë të marrëdhënieve midis shteteve.<sup>38</sup>

E drejta e sovranitetit është një ndër çështjet më të rëndësishme të së drejtës ndërkombëtare, kurse respektimi i sovranitetit një ndër bazat kryesore të së drejtës ndërkombëtare dhe tërë sistemit ndërkombëtar. Me sovranitet nënkuptojmë pushtetin e plotë të shtetit mbi territorin dhe popullsinë (brenda shtetit) dhe pavarësinë e shtetit prej cilitdo shtet tjetër në marrëdhëniet ndërkombëtare. Sovraniteti përfshin më vetë të drejtën që çdo shtet pavarësisht të përcaktojë ose të ndërrojë rendin e vet politik ose ekonomik në bazë të vullnetit të vet dhe pa ndërhyrje nga jashtë, që të lidhë marrëveshje ndërkombëtare dhe të ushtrojë pushtetin më të lartë mbi një territor dhe juridiksionin mbi shtetasit e tij.

Përrjashtim nga kjo bëjnë vetëm servitutet ndërkombëtare dhe personat ose objektet që gëzojnë eksterritorialitet (misionet diplomatike, përfaqësuesit diplomatik, etj.). Përrjashtimet e tilla dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare, me të cilat shtetet vullnetarisht e kanë kufizuar pushtetin e tyre në interes të bashkëpunimit ndërkombëtar.

Për të analizuar më detajisht konceptin e Sovranitetit është e nevojshme të bëhet një ndarje në bazë të aspekteve dhe teorive.

Sovraniteti ka dy aspekte: aspektin e jashtëm, që ndonjëherë quhet aspekt negativ ose e drejtë e tij që mos të pranojë asnjë autoritet mbi vetë i cili do t'ia impononte mënyrën e sjelljes; dhe

---

<sup>37</sup> Breton Kotorri, *Marrëveshja e Vestfalisë*, Tiranë, 2012, fq.75

<sup>38</sup> Bekim Baliq, *Hyrje në Diplomaci dhe Politikë të jashtme*, 2010, fq.8-10

aspektin e brendshëm (aspektin pozitiv) ose pushtetin që jep urdhëresa pa kurrfarë kushtesh, supremacinë e shtetit si pushtet më të lartë ku ka pushtetin legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor.

Aspekti i jashtëm i sovranitetit është pavarësia. Shteti sovran është sinonim i shtetit të pavarur, duke qenë në pozicionin e barazisë juridike me shtetet e tjera dhe që përcakton lirisht politikën e tij të jashtme dhe të brendshme, duke nënkuptuar lirinë analoge të zgjedhjeve. Ndërsa sovraniteti i brendshëm manifestohet si e drejtë e shtetit që në mënyrë të pavarur të zgjedhë rendin e vet politik, ekonomik dhe shoqëror. Sistemi modern i marrëdhënirve ndërkombëtare, ka qenë ngritur dhe formësuar rreth parimit të sovranitetit shtetërorë. Thënë ndryshe, parimi i sovranitetit është shfaqur në njërin anë si një gurë themeli në organizimin e brendshëm të shteteve, dhe në anën tjetër si një nyje neuralgjike e rrjetit të sistemit ndërkombëtarë. Parimi i sovranitetit dhe implikimet që ndërlidhen me të, e kanë shoqëruar komplet epilogun e evoluimit të sistemit të marrëdhënive ndërkombëtare.<sup>39</sup>

Sovraniteti mund të kuptohet në dy këndvështrime, në atë juridik dhe atë politik. Përmes sovranitetit juridik Shteti mund të hyjë në marrëdhënie me shtete të tjera apo organizata ndërkombëtare përmes njohjes dhe respektimit të traktateve ndërkombëtare dhe aleancave apo detyrimeve diplomatike. Sovraniteti politik i referohet fuqisë së Shtetit për të imponuar çdo gjë që atij i duket e nevojshme. Megjithatë shtetet kanë sovranitetin juridik, sovraniteti politik shpesh varet nga opinioni i shteteve të tjerë në termat e zhvillimit të tyre social, politik dhe ekonomik.

Në kushtet e globalizmit dhe të procesit të integritit evropian, *sovraniteti i kufizuar* është bërë tashmë një realitet, duke u kthyer në një temë të nxehtë të debatit politik si edhe të shkencave politike.<sup>40</sup>

---

<sup>39</sup> Blerim Reka, Bardhok Bashota, Ylber Sela, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Shkup, 2016, fq.152

<sup>40</sup> <http://shtetiëeb.org/2017/05/20/ceshte-sovraniteti/>

## **1.5. Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacia modern**

Interesimi për marrëdhënie ndërkombëtare historikisht ka qenë i lidhur vetëm me udhëheqësin e një shteti (mbreti, sovrani) dhe rrethit të tij të ngushtë të elitës udhëheqëse, me rritjen e rrjedhshmërisë së informatave rritet edhe nevoja për to dhe interesimi për marrëdhënie ndërkombëtare u bart edhe në shtresat tjera të shoqërisë; te njerëzit që dinin të zhvillojnë saktësinë e qëndrimit në strukturat e politikës së jashtme, dhe në këtë mënyrë koha e absolutizmit kaloi në histori.

Me rritjen e interesimit me marrëdhëniet ndërkombëtare gjegjësisht për aktivitetin diplomatik dhe kur diskrecioni i saj ngushtohet, u krijua modeli i metodave të reja të diplomacisë. Edhe pse teoria e marrëdhënies ndërkombëtare zhvillohet me praktikën e udhëheqjes së saj; kristalizimi i këtyre teorive klasike në marrëdhëniet ndërkombëtare u arrit pas gjysmës së shekullit të kaluar.

Në praktikën e marrëdhënies ndërkombëtare njihen një mori funksionesh të shkëlqyeshme diplomatike. Ndërveprimet shoqërore, ekonomike dhe teknologjike në bashkësinë bashkëkohore ndërkombëtare e bëjnë të domosdoshme sajimin e mendimeve të reja për marrëdhëniet ndërkombëtare dhe plotësimin apo ndërrimin e praktikave të përdorura.

Në realitetin bashkëkohorë ato paraqesin një ambient të tregut të madh botëror. Në këtë ambient të globalizimit, shtetet pjesmarrëse ballafaqohen me politika të ndryshme, me qëllim të realizimit të interesave maksimaliste që para vetes i parashtron çdo shtet ose bashkësi shtetesh. Rritja e numrit të subjekteve në politikën e jashtme ka edhe pasoja negative sepse krijohen politika të jashtme ose kundërshtarë brenda të njejtit shtet.<sup>41</sup>

Diplomacia përbën “shtyllën kurrizore” të shtetit dhe kombit në marrëdhëniet ndërkombëtare. Bazuar tek fjalori i Oxfordit, diplomacia konceptohet si menaxhimi i marrëdhënies ndërkombëtare me anë të negociatave.

Qëllimi kryesor i diplomacisë është mirëmbajtja e marrëdhënies në mes të shteteve. Shtetet kuvendojnë mes veti, mbrojnë intersat e tyre, njoftojnë njëra tjetrën, i përparojnë marrëdhëniet kryesisht nëpërmjet të dërguarve dhe pranimit të dërguarve nga shteti përkatës.

---

<sup>41</sup> Jonuz Abdullai, *Politika dhe Politikat Publike*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq.152

Të dërguarit janë misionarë, ambasadorë, ose grupe të dërguara. Shefi i misionit dhe personat diplomatic d.m.th. Diplomatët, gëzojnë imunitet dhe të drejta të veçanta. Diplomacia themelet e saja I has që në kohët e hershme ku shfaqet nevoja për marrëdhënie dhe marrëveshje (tractate ndërkombëtare), ndërmjet shteteve sidomos pas luftës së dytë botërore, dhe që atë herë vjen duke u përmirësuar rëndësia si dhe pozita e organit diplomatik. Për të jetësuar parimet e përgjithshme të mirëkuptimit dhe të përvojës së diplomacisë, është e nevojshme të përkufizojmë cilësinë morale dhe intelektuale, që duhet të zotërojë diplomati profesionist, si n jë hallkë tepër e rëndësishme, jo vetëm për përfaqësuesin diplomatic por edhe për rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të diplomacisë në veçanti, të cilat veti nuk kanë thjesht karakter teorik, por para se gjithash dhe praktik. Njëpërmjet këtyre cilësive dhe sjelljeve mund të kuptojmë atë që në praktikë njihet si “Diplomaci e mirë” apo “Diplomaci e keqe”, me të cilën çështje janë marrë edhe shumica e autorëve të teorisë diplomatike duke cilësuar disa veti të përhershme që duhet ti ketë një diplomat, të cilat kanë ndryshuar në varësi të kohërave dhe kushteve të ndryshme historike.

Me qëllim të realizimit sa më efikas të funksioneve diplomatike, Konventa e Vjenës dhe e drejta ndërkombëtare parashohin lehtësime, privilegje dhe imunitete për përfaqësuesit diplomatic dhe në shkallë të caktuar edhe për pjesëtarët tjerë të personelit diplomatik. Sipas neneve 21 dhe 26 të konventës së Vjenës,<sup>42</sup> shteti pranues ka për obligim ndërmarjen e të gjitha masave të mundshme dhe të lejueshme me qëllim të fillimit sa më të shpejtë të punës në misionin diplomatik, apo puna është në vijim, të mundësojë të gjitha lehtësimet për kryerjen sa më me sukses të misionit diplomatik k të akredituar në teritorin e tij.

Të gjithë anëtarët e misionit kanë të drejtë qarkullimi në shtetin pranues, përveç në raste ku bëhet fjalë për sigurinë kombëtare të shtetit pranues.<sup>43</sup>

Privilegjet dhe imunitetet si dy nocione më të rëndësishme të së drejtës diplomatike dhe konsullare edhe pse shkojnë gjithnjë bashkarisht, si nocione çdo njëra e ka kuptimin e vet. Me nocionin privilegj nënkuptohet përparësi dhe respekte të veçanta që I takojnë personelit diplomatik dhe misionit diplomatic. Kurse me nocionin imunitet nënkuptojmë përjashtimin apo lirim të personelit të misionit diplomatic nga juridiksioni I shtetit pranues. Me gjithë atë, këto

---

<sup>42</sup> Neni 21 dhe 26 I Konventës së Vjenës

<sup>43</sup>

[http://ëëë.academia.edu/27669715/Privilegjet\\_dhe\\_Imunitetet\\_Diplomatike\\_sipas\\_Konvent%C3%ABs\\_s%C3%AB\\_Vjen%C3%ABs](http://ëëë.academia.edu/27669715/Privilegjet_dhe_Imunitetet_Diplomatike_sipas_Konvent%C3%ABs_s%C3%AB_Vjen%C3%ABs)

dy nocione në të shumtën e rasteve kanë pika të përbashkëta, pasi edhe privilegjet shpesh here reflektohen si imunitete dhe e kundërta.

Përfaqësuesit diplomatik janë të obliguar të respektojnë ligjet dhe sistemin juridik të shtetit pranues dhe në asnjë formë nuk duhet të përzihen në punët e brendshme të shtetit ku veprojnë, me qëllim të efikasitetit në ushtrimin e funksioneve të tyre.<sup>44</sup>

Konventa e Vjenës parasheh lehtësime, imunitete dhe privilegje për përfaqësuesit diplomatik dhe për funksionimin e misionit si tërësi. Edhe shteti pranues duhet tua lehtësojë punën diplomatëve që janë të akredituar në të, siç janë: e drejta e lëvizjes dhe qarkullimit, e drejta e komunikimit, e sigurimit të nevojave të përditshme të tyre e tjetër.

Konventa e Vjenës<sup>45</sup> përcakton se përfaqësuesit diplomatik fillojnë të gëzojnë privilegjet dhe imunitetet nga momenti i hyrjes së tyre në territorin e shtetit ku janë të akredituar për të marrë detyrën e tyre. Kurse për personat tjerë të cilët gjinden në territorin e shtetit pranues, privilegjet dhe imunitetet fillojnë të shfrytëzohen nga momenti kur bëhet notifikimi i emërimeve të tyre nga Ministria e Punëve të Jashtme.

Përfaqësuesve diplomatik, privilegjet dhe imunitetet u pushojnë në momentin kur ata përfundojnë funksionin e tyre, rrespektivisht kur lëshojnë territorin e shtetit ku edhe kanë qenë të akredituar. Privilegjet dhe Imunitetet për përfaqësuesin diplomatik vlejnë edhe në raste të shpërthimit të luftës në mes shtetit dërgues dhe shteti pranues. Këto vlejnë edhe për antarët e familjes së përfaqësuesit diplomatik në raste të vdekjes së tij gjerë në kthimin e tyre në shtetin e vet.

Konventa e Vjenës<sup>46</sup> parashikon që agjentët diplomatik të lirohen nga të gjitha tatimet dhe taksat me përjashtim të tatimeve indirekte; të tatimeve dhe taksave në pronë private të pasurive të palëvizshme në territorin e shtetit pranues; të tatimeve dhe taksave nga rroga dhe kapitali që realizohen nga bizneset private të cilat agjenti diplomatik i ushtron në territorin e shtetit pranues;

---

<sup>44</sup> Shumica e autorëve pajtohen me konstatimin se imunitetet janë të bazuara në të drejtën ndërkombëtare dhe kanë të bëjnë me përkufizimin e sovranitetit të shtetit pranues në emër të realizimit sa më efikas të funksionit diplomatik. Për dallim nga imunitetet, privilegjet më tepër bazohen në të drejtën e mbrendshme të shtetit pranues dhe nuk kanë të bëjnë me përkufizimin e sovranitetit të tij. Pjesë e konsiderueshme e privilegjeve praktikohen edhe si rregulla të mirësjelljes

<sup>45</sup> Konventa e Vjenës, neni 39

<sup>46</sup> Neni 34



të tatimeve dhe taksave që mblidhen si kompensim për shërbime të caktuara; të taksave për regjistrim gjyqësorë dhe fiskal, kur është fjala për pasuri të palëvizshme.<sup>47</sup>

Përfaqësuesit diplomatik, sipas Konventës së Vjenës gjithashtu janë të liruar edhe nga të dhënat e ndryshme doganore. Shteti pranues ka për obligim që të lejojë hyrjen apo ipmortimin e të gjitha sendeve për nevoja zyrtare apo personale të përfaqësuesve diplomatik. Por, agjentët diplomatik nuk kanë të drejtë që këto sende ti shesin apo ti tjetërsojnë në territorin e shtetit pranues. Përjashtim nga lirimi i doganimit mund të kemi në rastet kur ekziston dyshimi serioz se dërgesat e tilla përmbajnë sende që nuk janë në përdorim personal apo zyrtarë të misionit, ose sende importimi i të cilave është i ndaluar apo kontrolluar nga shteti pranues. Në këto raste kontrolli eventual i këtyre sendeve mund të bëhet vetëm në prezencë të përfaqësuesit diplomatik. Historia ka treguar se shpeshherë diplomatët e kanë keqpërdorur imunitetin e tyre duke shfrytëzuar rastin për qëllime dhe veprime të palejueshme dhe të paligjshme në shtetin pranues.

Në veprat që kanë të bëjnë me diplomacinë, thuhet më shpesh se e ashtuquajtura "diplomaci klasike" u shoqërua me shfaqjen e veprimtarisë diplomatike gjatë epokës së Kardinalit Richelieu dhe për tre shekuj u dëshmuua si një aktivitet i dobishëm dhe i qëllimshëm, nga shtetet.

Së fundi, diplomacia është një shkencë që studion dhe jep mësim çështjet relevante në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe zhvillimin e politikës së jashtme. Si shkencë është një përmbledhje e fushave të ndryshme shkencore, kryesisht politikës, por edhe historisë, gjeografisë, ligjit, ekonomisë dhe të tjera.

Sipas studiuesit Ralph G. Feltham në librin "Diplomacia", kategoritë e krerëve të misioneve diplomatike janë:<sup>48</sup>

- 1.) Ambasadorë
- 2.) Të dërguar, ministra të jashtëzakonshëm dhe ministra fuqiplotë
- 3.) Ministra resident

Këto kategori të mësipërme janë përcaktuar që nga Kongresi i Vjenës, i cili themeloi shërbimin diplomatik. Në bazë të Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Diplomatike paraqiten edhe funksionet e diplomatit:

- 1.) Përfaqësimi i shtetit dërgues në shtetin pritës

---

<sup>47</sup> Neni 33

<sup>48</sup> Ralph G. Feltham, *Diplomatic Handbook*, Eighth edition, Martinus Nijhoff Publishers, 2004 , pg.41-42

- 2.) Mbrojtja në shtetin pritës e interesave të shtetit dërgues dhe e shtetasve të tij, brenda kufijve të lejuar nga e drejta ndërkombëtare
- 3.) Negocimi me qeveritë e shtetit pritës
- 4.) Informimi me të gjitha mjetet e ligjshme për kushtet dhe zhvillimet në shtetin pritës dhe raportimi lidhur me ato të qeverisë së shtetit dërgues
- 5.) Nxitja e marrëdhënieve miqësore ndërmjet shtetit dërgues dhe shtetit pritës, si dhe zhvillimi i marrëdhënieve të tyre ekonomike, kulturore dhe shkencore.

Aparati i posaçëm shtetëror për zbatimin e diplomacisë përfshinë Politikën e Jashtme të shtetit, Ministrinë e Punëve të Jashtme, Shërbimet Diplomatike dhe Shërbimet Konsullore.

Politika e sotme diplomatike bazohet në dy lloje të diplomacisë, e këto janë: Diplomacia Bilateral dhe Diplomacia Multilaterale, por gjithashtu në kuadër të këtyre dyjave hyjnë edhe shumë forma dhe lloje tjera prej të cilave më të rëndësishmë janë:

- |   |                              |
|---|------------------------------|
| 1.) Diplomacia Klasike                                  | 12.) Diplomacia Parlamentare |
| 2.) Diplomacia Moderne                                  | 13.) Diplomacia Kulturore    |
| 3.) Diplomacia Postmoderne                              | 14.) Diplomacia Personale    |
| 4.) Diplomacia Tradicionale                             | 15.) Diplomacia Tranzitore   |
| 5.) Diplomacia e Fshehtë                                | 16.) Diplomacia Shtërnguese  |
| 6.) Diplomacia e Hapur                                  | 17.) Diplomacia e Qetë       |
| 7.) Diplomacia Dypalëshe                                | 18.) Diplomacia Zyrtare      |
| 8.) Diplomacia Shumëpalëshe                             | 19.) Diplomacia Publike      |
| 9.) Diplomacia e Samiteve                               | 20.) Diplomacia Qytetare     |
| 10.) Diplomacia Bërthamore                              |                              |
| 11.) Diplomacia Ushtarake dhe e Mbrojtjes <sup>49</sup> |                              |

---

<sup>49</sup> Ralph G. Feltham, *Diplomatic Handbook*, Eighth edition, Martinus Nijhoff Publishers, 2004, pg.46

Meqenëse teza që kam marrë për studim ka si fokus politikën e jashtme dhe marrëdhëniet ndërkombëtare në mes dy shteteve, atij shqipëtarë dhe italian, e shoh të patjetërsueshëm zërthimin më të detajuar të diplomacisë bilaterale.

Bashkëpunimi bilateral është diplomacia që përmes përfaqësimit zyrtarë, mbledhjes, analizimit dhe dërgimit të informacioneve dhe negociimit udhëheq marrëdhëniet midis dy shteteve sovraane. Atë e udhëheq ambasadori bilateral i cili edhe akreditohet te shteti pranues/nikoqir, zakonisht te shefi i atij shteti,(Presidenti apo Mbreti). Në kohët moderne, shprehja “diplomaci bilaterale” nënkupton komunikimin që zhvillohet vetëm në mes dy palëve, e që nuk e përcakton as mënyrën e as kontekstin në të cilin ato e zhvillojnë komunikimin. Kështu për shembull, biseda e drejtpërdrejt telefonike e ambasadorit italian në Berlin apo Shqipëri, me qëllim të parashtrimit të ndonjë pyetje, etj.

*(Bilateral Diplomacy: embassies, consular posts, and unconventional resident missions such as interests sections and representative offices; ehy they are the major part of the modern counter-revolution in dilomatic practice.<sup>50</sup>)*

Në rrethanat e tanishme, termi "diplomacia dypalëshe" nuk nënkupton asgjë më shumë se një komunikim që në çdo kohë është i kufizuar në dy anët. Kjo nuk tregon mënyrën ose kontekstin në të cilin ata komunikojnë. Diplomacia dypalëshe do të thotë ruajtjen e marrëdhënieve në bazë të "shtetit ndaj shteteve" nëpërmjet misioneve të përhershme të akredituara, e cila është një procedurë konvencionale për zhvillimin e diplomacisë bilaterale.

Mjeti kryesorë në bashkëpunimin bilateral është Negociata. Ato janë process për mes të cilit palët e interesuara i zgjedhin mosmarëveshjet, pajtohen për detyrimin e aksioneve, bëjnë Pazar për përfitime personale apo kolektive ose përpiqen të arrijnë zgjidhje të cilat ju shërbejnë interesave të ndërsjella.

Dallojmë dy lloje të negociatave: *soft dhe hard* – negociata e butë dhe e fortë. Negociatorët e butë (soft) përpiqen tu shmangen konflikteve personale dhe janë të gatshëm të bëjnë lëshime me qëllim të arritjes së marrëveshjes. Ata synojnë marrëveshje të përzemërt dhe shoqërore. Negociatorët e fortë (hard) shumicën e situatave e shohin si gara vullnetesh, në të cilat më së miri kalon pala e cila i mer pozicionet më të skajshme dhe në to këmbëngul më së gjati. Mirëpo

---

<sup>50</sup> Blerim Reka, *Hyrje në Marrëdhëniet Ndërkombëtare* Arbëria Design, (viti II), fq.95

pozicionet, dëshirat dhe rezultatet e negociatave në praktikë mund të jenë të gjëra në tërësi të ndryshme.

Ky nën kapitull shërben si një çelës hyrës drejt shtjellimit të çështjeve kryesore që do të analizojmë në vazhdim. Këtu janë përfshirë bazat teorike të diplomacisë duke përmendur fillimin e diplomacisë që në histori, dhe duke vazhduar në nevojat për përdorimin e marrëdhënieve diplomatike ndërmjet shteteve dhe më pas me ratifikimin e Konventës së Vjenës e cila ndryshe njihet edhe si Kushtetuta e Diplomacisë.

Më pas përmenden rëndësia e përfaqësuesve diplomatik, dhe rradhitja e tyre apo ndarja e trupit përfaqësues të diplomacisë, funksionet diplomatike, paprekshmëria dhe imunitete e tyre, dhe në fund përmendet edhe përfundimi i misionit diplomatik i cili është i një rëndësie të veçantë.

## **2. Politika e jashtme dhe diplomacia**

Në kushte bashkëkohore të zhvillimit të marrëdhënieve ndërkombëtare, kur në bashksinë ndërkombëtare ndodhin ndryshime të shumta, politika e jashtme e shteteve ka vend të dalluar. Transformimet e thella që I përjeton bota bashkëkohore, globalizimi, ndikimi I madh I revolucionit shkencorë-technik, me të gjitha pasojat që rrjedhin prej tij, dhe përpjekjet për demokratizimin e marrëdhënieve ndërkombëtare, ndikojnë në mënyrë të qënësishme në zgjerimin e të gjitha formave të kontakteve në të cilat edhe politika e jashtme ka rëndësinë e vet. Edhe pse nuk mund të pohoet se marrëdhëniet ndërkombëtare janë shumë e thjeshtë e politikave të jashtme të shteteve përkatëse, ose që të gjitha përmbajtjet e marrëdhënieve ndërkombëtare në tërësi mbulohen me politika të jashtme, është fakt se nga kjo formë e aktivitetit shtetërorë varet një pjesë e madhe e marrëdhënieve ndërkombëtare, duke pasur parasysh faktin se shtetet edhe më tej janë aktorë kryesorë të veprimtarisë ndërkombëtare. Duke u nisur nga ajo se politika e jashtme është pjesë përbërëse e aktiviteteve të gjithmbarshme të njeriut, ka historinë e vet, përvojat dhe rregullat e veta të qëndrueshme, dhe së në bazë të gjith kësaj janë të mbushura edhe krahasimet e caktuara, theksohet nevoja e studimit të politikës së jashtme si pjesë e rëndësishme e marrëdhënieve ndërkombëtare. Strategjia e përdorur nga qeveritë për të udhëhequr veprime të ndryshme në drejtim të shtetëve tjera definojnë politikën e jashtme. Konsiderohet se politika e jashtme është një veprimtari strategjike dhe e koordinuar për mes së cilës shtetet, nga njëra anë, mbajnë linja të përhershme të komunikimit me shtetet dhe subjektet tjera në marrëdhëniet ndërkombëtare, dhe nga ana tjetër, tentojnë të ndikojnë në sjelljet e këtyre subjekteve. Në fakt ndërveprimin kompleks të të gjithë akterëve që ne e quajmë “*marrëdhënie ndërkombëtare*”, në planin konkret identifikohet me politikën e jashtme.

Politika e jashtme e çdo vendi ka parasysh: ruajtjen e sigurisë dhe të panvarësisë së vendit dhe mbrojtjen e interesave të veta politike, ushtarake dhe ekonomike të tij. Pra, ajo është e lidhur me rezistencën ndaj çdo depërtimi dhe të çdo manipulimi nga vendet dhe ideologjitë e huaja dhe me përpjekjen e parreshtur për të realizuar ndonjë depërtim dhe manipulim të saj.

Politika e jashtme është e lidhur ngushtë me sigurinë kombëtare. Për të realizuar këtë synim kyç; mbrojtjen e sigurisë kombëtare, shtetet krijojnë rrjet të ndryshëm të kanaleve të informacioneve,

me qëllim të mbledhjes së informacioneve dhe të dhënave të rëndësishme që mund të afektojnë sigurinë kombëtare apo përgjithësisht interesat e shtetit.<sup>51</sup>

Ekzistojnë qasje të ndryshme rreth përkufizimit të politikës së jashtme të një shteti të cilat për bazë kanë marr indikator në lidhje me veprimtarinë e tyre, në një kohë të caktuar dhe në bazë të suksesit të aktorëve të politikës së caktuar. Këto qasje klasifikohen në këto grupe:

1. Qasja nacionale – e trajton politikën e jashtme si përshkrim të veprimtarisë së caktuar të shtetit.
2. Qasja historike – ofron shumë fakte, duke prezentuar ngjarjet nga e kaluara, mundësohet të bëhen interpretime të proceseve dhe dukurive bashkëkohore.
3. Qasja analitike – meret me shqyrtimin e determinanteve të ndryshme në të cilat mbështetet politika e jashtme e vendit përkatës. Kjo qasje shqyrton psh. Traditat historike, pozita gjeografike, interesin kombëtarë, qëllimet dhe mjetet me të cilat disponon politika e caktuar, vlerat dhe sigurinë që dëshiron të arrijë në rrethin ndërkombëtarë.<sup>52</sup>

Politika e jashtme është ngushtë e lidhur me politikën e brendshme, e cila shpreh drejtpërdrejtë strukturën klasore dhe raportet në shtetin përkatës. Në mesin e teorive dhe studiuesve të ndryshëm paraqiten këto elemente të përbashkëta:

1. Politika e jashtme është e lidhur fuqishëm me nevojat shoqërore që paraqiten në suazat e mekanizmave të politikës së brendshme.
2. Procesi I realizimit të politikës së jashtme varet nga përmbajtja dhe cilësia e politikës së brendshme
3. Në politikën e jashtme të cdo vendi pasqyrohen elementet karakteristike të politikës së brendshme të sistemit të caktuar shoqëroro-politik.
4. Kundërthëniet më të mëdha midis politikës së brendshme dhe të jashtme paraqiten në situata kur ekziston krizë e caktuar në plan të jashtëm.
5. Raportet me botën e jashtme mund të shfrytëzohen për krijimin e baraspeshës së brendshme në shtet.
6. Politika e jashtme mund të shfrytëzohet si instrument i liderizimit politik në shtet<sup>53</sup>

---

<sup>51</sup> Blerim Reka, Bardhok Bashota, Ylber Sela, *Marrëdhëniet Ndërkombëtare*, Arbëria Design, 2016, fq.221

<sup>52</sup> Jonuz Abdullahi, *Politika dhe Politikat Publike*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq.150

<sup>53</sup> Radovan Vukadinović, *Teoritë e politikës së jashtme*, Prishtinë, 2008, fq.31

Nga kjo lidhsmëri e intersave të politikës së brendshme dhe asaj të jashtme mund të konkludojmë se bëhet fjalë për një veprimtari tejet delikate dhe qenësore për egzistimin dhe zhvillimin e shtetit, si dhe për mirëqenien e vendit.

Në suaza të mjeteve të politikës së jashtme duhet veçuar mjetet diplomatike si formë e aktiviteteve shtetërore të orientuara ndaj shteteve tjera. Diplomacia është një mjet primar i veprimit politik që realizohet nëpërmjet të aktiviteteve të ndryshme në mes të shteteve të caktuara.<sup>54</sup>

Rëndësia e një politikbërjeje të suksesshme është e padiskutueshme sepse vetëm një politikë mjeshtërore e jashtme, një politikë e veprimeve domethënëse, mundëson një politikë të brendëshme frytdhënëse, që në fund të fundit është vetëm një marsh i thëlle i parëndesishëm.

---

<sup>54</sup> Iain Mc Lean, *Fjalor politik*, Oxford, Tiranë, 2001, fq.95

## **2.1. Aktorët e politikës e jashtme**

Nëse nisemi nga ajo se politika e jashtme është aktivitet i aktorëve në marrjen e vendimeve dhe në zbatimin e aksioneve të caktuara në planin e politikës së jashtme, menjëherë është evidente se për shkak të karakterit të politikës së jashtme ata aktorë duhet të jenë të shumtë dhe të ndryshëm. Që të shmangen mosmarrëveshjet e sigurta, është e nevojshme të jepen menjëherë tre vërejtje hyrëse.

- ✓ Me rastin e shqyrtimit të politikës së jashtme të ndonjë vendi përkatës, përkatësisht të paraqitjes së tij në fushën ndërkombëtare, është i zakonshëm identifikimi i plotë i organizatës shtetërore që krijon dhe zbaton politikën e jashtme me shtetin. Identifikimi i aktorëve dhe i shtetit është i pranishëm pothuaj në të gjitha punimet që meren me politikën e jashtme.
- ✓ Me aktorët e politikës së jashtme nënkuptojmë të gjithë ata persona privat ose kolektiv që marrin pjesë në procesin e marrjes së vendimeve të politikës së jashtme dhe në realizimin real të tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare.
- ✓ Duke patur parasysh karakterin e vendimmarjes së politikës së jashtme, që në të gjitha ata vende është i lindur në mënyrë të përpiktë me kreun politik, dhe përbën me punët e brendshme dhe mbrojtjen, një fushë shumë delikate të aksionit shtetëror politik, është e qartë që në këtë proces numri i aktorëve që vendosin realisht është relativisht i vogël.<sup>55</sup>

Në procesin e politikbërjes, shteti paraqitet si aktor kryesor, por në procesin e vendimmarjes dhe të zbatimit të aksioneve të caktuara të politikës së jashtme, marrin pjesë edhe aktorë të tjerë.

Aktorët kryesorë të politikës së jashtme janë përafërsisht të njëjtë në të gjitha vendet, vetëm se ndryshon roli dhe funksioni i tyre në vendet – shtetet përkatëse. Sipas rolit dhe rëndësisë në krijimin dhe zbatimin e politikës së jashtme, aktorët kryesorë janë:

1. Shefi i shtetit, Presidenti i shtetit
2. Qeveria, Kabineti, Presidiumi ose Pushteti ekzekutiv
3. Ministria e Punëve të Jashtme, e Mbrojtjes, e Financave dhe ministritë tjera
4. Pushteti Legjislativ (parlamentet, kuvendet, kongresi)
5. Shërbimi diplomatik

---

<sup>55</sup> Radovan Vukadinović, *Teoritë e politikës së jashtme*, Prishtinë, 2008, fq.50



Këto organe shtetërore janë pjesëmarrëse permanente në vendimarrjen dhe në realizimin e aksioneve konkrete në arenën ndërkombëtare.

Shefi i shtetit, pa marrë parasysh dallimet në tituj, gëzon kompetencat më të larta në fushën e politikës së jashtme. Pasi që është shef politik i vendit dhe të popullit të caktuar, asnjë vendim i qenësishëm i politikës së jashtme nuk mund të merret pa pjesëmarrjen ose dijeninë e tij. Duke vepruar në krye të politikës shtetërore, shefi i shtetit duhet të formulojë qëllimet kombëtare dhe të prashtrijë si detyra të caktuara në politikën e jashtme të shtetit të vet, duke u kujdesur vazhdimisht për zbatimin e tyre sa më efikas. Ndonjëherë pohoet se në kushte bashkëkohore të zhvillimit dinamik të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe të ndërrimeve shumë të shpeshta, shefi i shtetit nuk ka më mundësi që të ndjek pa ndërpre dhe hollësisht lidhjen që ekziston midis ndryshimeve në mjedisin ndërkombëtarë dhe të politikës së jashtme të vendit të vet, prandaj edhe vendimet që aim err janë të karakterit të përgjithshëm dhe mund të shërbejnë para se gjithash si udhërfyese dhe simbole në krijimin e politikës së jashtme. I ballafaquar me problem të shumta që i imponon jeta e përditshme, shefi i shtetit vazhdimisht konsultohet në mënyrë që të kuptojë sa më mirë ngjarjet e caktuara dhe të marrë vendimet e matura. Rrethi i këshilltarëve të tij, natyrisht, në çdo mjedis është i ndryshëm dhe nvalet nga një varg rretahanash. Ky mund të jetë aparat zyrtar i organizuar për politikë të jashtme, në disa vende ky është kreu partiak, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës flitet për të ashtuquajturin Kabinetin Kitchen, kurse në Britaninë e Madhe i jepet rol i madh establishmentit.<sup>56</sup>

Në SHBA-të ekziston një kontakt i përhershëm midis kryetarit dhe personit që merret me sigurinë kombëtare në kuptimin më të gjerë global. Pasi që këshilltarët e deritanishëm kanë qenë kryesisht profesorë të dalluar të marrëdhënieve ndërkombëtare, ndikimi i tyre tek kryetarët në fushën e politikës së jashtme ka qenë shumë i shprehur. Ndonjëherë madje pohoet se në programet ose në doktrinat e caktuara të politikës së jashtme nuk janë të përcaktuara idetë themelore të kryetarit, por të këshilltarëve të tij, të cilët më vonë kanë edhe mundësi të mëdha të ndjekjes së realizimit të tyre. Ministri i punëve të jashtme dhe ministria e punëve të jashtme kanë rol të dalluar dhe të rëndësishëm në krijimin dhe zbatimin e politikës së jashtme. Shefi i ministrisë së punëve të jashtme (ministri ose sekretari shtetërorë) në parim është figurë politike, e në dispozicion ka një aparat të madh të specialistëve, të angazhuar profesionalisht për kryerjen e detyrave të punëve të jashtme. Shefi i ministrisë së punëve të jashtme i ka disa funksione të

---

<sup>56</sup> Radovan Vukadinović, *Teoritë e politikës së jashtme*, Prishtinë, 2008, fq.52

ndryshme. Si person politik, ai duhet të kujdeset në mënyrë të rreptë për raportin midis politikës së përcaktuar në plan të brendshëm dhe politikës që zbatohet në marrëdhëniet ndërkombëtare. Njëkohësisht, ai është shef i ministrisë dhe kryen funksione të rëndësishme administrative, merr pjesë në planifikimin e politikës së jashtme dhe është këshilltarë i përhershëm i politikës së jashtme dhe shefit të shtetit. Ministrit e punëve të jashtme janë të organizuara në mënyra të ndryshme në vende përkatëse. Kuptohet, një varg vendesh të vogla nuk kanë nevojë as mundësi për organizimin e ministrive të mëdha që do të mund të mbulonin mbarë botën. Ndërkaq, ndryshe është situata me shtetet e mëdha, ose me ato më të mëdhatë në të cilat një aparat i madh i specializuar përpiket të merret me çështje të llojllojshme dhe gjithpërfshirëse të politikës së jashtme. Ministria e punëve të jashtme i kryen të gjitha kontaktet me misionet në botën e jashtme, e kontakton edhe me misionet e jashtme diplomatike të arritura në vend. Nga ana tjetër, ministria e punëve të jashtme vepron si burim i përhershëm i rekomandimeve për organet përkatëse ekzekutive. Duke pasur parasysh se të gjitha informatat e karakterit të politikës së jashtme vijnë së pari në ministri dhe se në të punojnë specialistët, është e kuptueshme që ministria e punëve të jashtme është qendër shumë e rëndësishme. Në interpretimet dhe sugjerimet që jep kjo ministri nvarret drejtimi i aksionit që do të merret si në situatën përkatëse, ashtu edhe në planifikimin e politikës së gjitmarshme të jashtme. Pushteti legjislativ (parlamentet, kuvendet), edhe pse shumë më oq ndjehet në fushën e politikës së jashtme sesa në politikën e brendshme, megjithatë ka vendin e vet në krijimin e politikës së jashtme. Për shkak të sistemeve të ndryshme politike, edhe në këtë fushë dallohen rolet e organeve përkatëse përfaqësuese. Sipas karakterit të organit përfaqësues mund të konstatohet lehtë edhe vendi real i tij në marrjen e vendimeve të caktuara në plan të politikës së brendshme dhe asaj të jashtme. Në vendin me system një partiak midis pushtetit përfaqësues dhe ekzekutivit do të ekzistoj, harmonizimi i aksioneve, dhe nuk ka mundësi që organi përfaqësues të krijoj pengesa në realizimin e politikës së caktuar ose të programit politik të aksionit. Mirëpo, kur është fjala për sistemin dypartiak ose shumë partiak, mund të pritët kontrolli i vazhdueshëm i pushtetit ekzekutiv, sidomos nga rradhët e opozitës, e në disa situata kjo mund të shpie edhe në shprehjen e mosbesimit ndaj politikës që e udhëheq pushteti ekzekutiv. Pothuaj se çdo organ ka këshillin ose komitetin special për çështje të politikës së jashtme, antarët e të cilave janë ata parlamentar që janë veçanarisht të interesuar për çështje të politikës së jashtme. Edhe pse as ky organ nuk merr pjesë drejtpërdrejtë në krijimin e politikës së jashtme, ai megjithatë, është më afër me kreatorët e politikës së jashtme sepse mund të inicioj

debate të caktuara paraprake, të kërkoj analiza të masave të parapara të politikës së jashtme, të inicioj shqyrtimin e aspekteve të caktuara të politikës së jashtme të vendit të tij. Veprimtaria e tillë veçmas ka gjetur shprehje në shtetet e bashkuara, ku për shembull këshilli për politikë të jashtme i Senatit është bërë organ i rëndësishëm për krijimin e politikës së jashtme. Si aktor i fundit dhe tejet i rëndësishëm i politikës së jashtme, paraqitet shërbimi diplomatik i cili mundëson mbajtjen e rregullt të kontakteve midis shteteve, qoftë kur është fjala për komunikim me përfaqësuesit diplomatik të vendit të vet në botën e jashtme, qoftë për komunikimin midis ministrive të punëve të jashtme dhe të përfaqësive të jashtme diplomatike të akredituara në vend.

Në krye të çdo misioni diplomatik që verpon në botën e jashtme është shefi i misionit, në rrethanat e sotme, më së shpeshti është ambasadori. Detyrat e tij janë: prezantimi i shtetit të vet, negociimi, informimi i ministrisë së vet të punëve të jashtme, dhe mbrojtja e interesave dhe e të drejtave të qytetarëve të vet. Duke pasur parasysh ndryshimet që i ka përjetuar diplomacia bashkëkohore dhe shpejtësinë e komunikimeve të sotme ndërkombëtare, roli i dikurshëm i ambasadorit është reduktuar dukshëm. Kjo veçmas pasqyrohet në fushën e zhvillimit të negociatave ndërkombëtare, ku për çështje më të rëndësishme dërgohen të dërguarit special ose ekspertët nga fushat përkatëse për të cilat negociohet. Kontributin maksimal ambasadori mund ta jap në kultivimin e marrëdhënieve miqësore dhe në informimin e hollësishëm dhe me kohë të qeverisë së vet mbi zhvillimin e raporteve në vendin në të cilin është akredituar. Ambasadori duhet gjithëherë të jetë i gatshëm të jap të dhëna precise dhe analizën e vet mbi situatën e caktuar. Mendimi i tij mund të merret si informatë nga “vendi i ngjarjes” dhe si i tillë mund të jetë i vlefshëm për ministrinë e punëve të jashtme. Mirëpo, nga ana tjetër, ambasadori duhet të jetë i njoftuar mirë edhe me zhvillimin e marrëdhënieve në vendin e vet në mënyrë që në çdo rrethahë të mund të plotësojë interesat e bashkëbiseduesve të ndryshëm në shtetin në të cilin është akredituar.

Organizimi i brendshëm i ambasadave dhe numri i zyrtarëve të punësuar është i llojlojshëm. Ndarja e funksioneve në ambasada gjithashtu është e ndryshme, e më e shpeshta është ndarja në punët politike, ekonomike dhe konsullore. Mirëpo, nëse midis dy vendeve janë të zhvilluara marrëdhëniet, atëherë ekziston edhe një varg repartesh dhe atashesh që kujdesen për zhvillimin e lidhjeve specifike. Përfaqësuesit diplomatik në misionet në botën e jashtme qëndrojnë prej dy deri në kater vite, por kjo nuk është një rregull e përcaktuar. Ambasadorët ndonjëherë mbesin shumë më gjatë, në disa situata është e dukshme perpjekja që në kryeqendrën e caktuar të

sigurohet vendi i doajenit të tubimit diplomatic. Rotacioni i personelit diplomatik zbatohet në mënyra të ndryshme. Disa vende përpiqen që përfaqësuesit e vet diplomatik të specializojnë për fusha përkatëse, gjë që është përparësi e madhe duke pasur parasysh njohjen e gjuhës, njohjen e cultures, të zakoneve dhe të traditave të jetës politike të regjionit.

Nëse ambasada e caktuar në botën e jashtme nuk funksionon, ose raporteve të saj nuk u kushtohet kujdes i duhur, mund të krijohen ngecje serioze, e shpesh herë pasoj e kësaj mund të jetë marrja e vendimeve joadekuate në politikën e jashtme.

## **2.2. Roli i presidentit në politikën e jashtme**

Sot në botë egzistojnë shumë forma të qeverisjes demokratike. Megjithatë, në të gjitha format e demokracive është vetëm një person që drejton këtë qeverisje. Ky drejtues mund të jetë Mbreti ose Mbretëresha, në një sistem monarkie kushtetuese, Kryeministri, në një sistem parlamentar, ose Presidenti, në një sistem presidencial. Egziston mundësia që një shtet të ketë një sistem hibrid, ku për shembull, kompetencat ekzekutive ndahen midis presidentit dhe kryeministrit.

Qëllimi i këtij nënkapitulli është të jep një kontribut modest në çështjen për kompetencat kushtetuese të Presidentit në përgjithësi dhe veçanërisht me rastin e rolit të Presidentit në politikën e jashtme.

Në kontekstin e ndarjes kushtetuese të kompetencave të degëve të qeverisjes, Kushtetuta ka përcaktuar Presidentin që të jetë përfaqësues i unitetit të popullit, të përfaqësojë vendin brenda dhe jashtë dhe të garantojë funksionimin demokratik të institucioneve.

Së bashku me problemin e përzgjedhjes së kandidaturës ose zgjedhjes së presidentit, merret në konsideratë edhe afati i mandatit presidencial dhe fakti nëse presidenti mund të rizgjidhet. Afati i mandatit presidencial varion nga një shtet në tjetrin ( për shembull, mandati i presidentit në Shtetet e Bashkuara është katër vjet, në Shqipëri pesë vjet, në bazë të Ligjit për Dispozitat Kryesore Kushtetuese, ndërsa në Francë shtatë vjet). Megjithatë, në ndryshim nga afati i mandatit të kryeministrit i cili mund të rezultojë shumë i shkurtër, sidomos në rastin kur ai drejton një qeveri koalicioni dhe humbet mbështetjen e partnerëve të tij, afati i mandatit të presidentit është i përcaktuar. Në përgjithësi, presidenti mund të shkarkohet nga detyra vetëm nëpërmjet një procesi specifik (si akuzimi për një krim, në Shtetet e Bashkuara) ose nëpërmjet dorëheqjes.<sup>57</sup> Së bashku me afatin e mandatit presidencial, duhet marrë në konsideratë edhe çështja e numrit të mandateve gjatë të cilave presidenti mund të kryejë këtë detyrë. Kushtetutat e disa vendeve e kufizojnë numrin e mandateve gjatë të cilave një person mund të zgjidhet president (për shembull, Kushtetuta e Shteteve të Bashkuara e kufizon numrin e mandateve në dy, pra tetë vjet, ndërsa Ligji për Dispozitat Kryesore Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë kufizon zgjedhjen në postin e presidentit për dy afate të njëpasnjëshme, pra për 10 vjet, por nuk

---

<sup>57</sup> Nenin 27 të Ligjit për Dispozitat Kryesore Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë

kufizon numrin e mandateve presidenciale për të cilat një person mund të zgjidhet në postin e presidentit.

Përgjegjësitë e një presidenti mund të variojnë në një shkallë të gjërë në varësi të kushtetutës që është adoptuar. Për shembull, në bazë të disa kushtetutave roli i presidentit është pak më tepër se ceremonial (si në Irlandë dhe Gjermani). Nga ana tjetër, në disa vende, të tilla si Shtetet e Bashkuara, presidenti është përgjegjës për funksionet e ekzekutivit dhe ushtron kompetenca dhe influence të jashtëzakonshme. Ndërmjet përgjegjësive të presidentit të Shteteve të Bashkuara, të përcaktuara në kushtetutë, mund të përmendim:

1. Kompetencën për të nënshkruar traktate dhe marrëveshje ndërkombëtare.
2. Kompetencën për të emëruar ambasadorët, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë dhe gjykatavetëtjerafederaledheministrat.
3. Pozicioni ne komandantit të përgjithshëm të forcave të armatosura.

Megjithatë, ka mundësi të egzistojë një sistem hibrid që kombinon sistemin presidencial me atë parlamentar.

Në bazë të Ligjit për Dispozitat Kryesore Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë, roli i Presidentit, në dukje, është i dorës së dytë në krahasim me atë të Kryeministrit. Disa nga kompetencat që Ligji për Dispozitat Kryesore Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë i ka deleguar Presidentit janë:

1. Emërimi dhe pranimi i dorëheqjes së kryeministrit.
2. Emërimi, shkarkimi dhe pezullimi me dekret presidencial i ministrave dhe anëtarëve të tjerë të Këshillit të Ministrave, në bazë të propozimit të Kryeministrit.
3. Emërimi dhe shkarkimi i përfaqësuesve diplomatikë, në bazë të propozimit të Kryeministrit.
4. Përgatitja e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ratifikimi ose refuzimi i atyre që nuk janë egzaminuar nga Kuvendi Popullor.
5. Presidenti është Komandant i Forcave të Armatosura dhe Kryetar i Këshillit të Mbrojtjes.

Duke patur parasysh përgjegjësitë e mëdha të një presidenti veçanërisht në një sistem të pastër presidencial, zakonisht është e këshillueshme të zgjerohen disa privilegje dhe imuniteti i presidentit në kryerjen e detyrës së tij. Ndërkohë që kushtetuta e sistemit presidencial më të fuqishëm në botë nuk i përcakton shprehimisht imunitetin dhe privilegjet e presidentit, por ato i

njihen këtij të fundit. Parimet e imunitetit dhe privilegjeve të presidentit, bazohen në doktrinën e ndarjes së pushteteve në tre degë të veçanta: ekzekutivi, gjyqësori dhe legjislativi. Imuniteti i presidentit shtrihet në veprimet që ai ndërmerr në bazë të pozicionit të tij zyrtar. Shtrirja e këtij imuniteti nuk është përcaktuar në mënyrë të qartë. Megjithatë, rreziku i akuzave për kryerje krimesh ka aftësinë të parandalojë gabimet e presidentit.<sup>58</sup>

---

<sup>58</sup> <http://pbosnia.kentlae.edu/services/albania/legal/conceptalb/exec8.htm>

### **2.3. Raporti i politikës së jashtme dhe politikës së brendshme**

Politika e jashtme e shtetit është pjesë e superstrukturës së tij dhe për këtë arsye në qëllimet, karakteristikat dhe metodat e veprimit të politikës së jashtme shprehet në mënyrë të qartë roli vendimtar i marrëdhënjëve shoqërore dhe ekonomike, të cilave ai aktivitetet u shërben gjithëherë. Për këtë arsye, në veshtrimin e politikës së jashtme si veprimtari e shtetit, e orientuar në krijimin e kushteve më të përshtatshme për paraqitjen e shtetit në skenën ndërkombëtare, duhet nisur nga koncepcionet e qëndrueshme metodologjike që mundësojnë shikimin e tërësisë dhe të ligjshmërive dialektike të zhvillimit.

Me rastin e hulumtimit të veprimtarisë së politikës së jashtme dhe të sjelljes të shtetit përkatës nuk bën të ndahet politika e brendshme nga politika e jashtme, por të dy aktivitetet duhet të vështrohen në tërësinë e tyre burimore. Në baze të analizës së politikës së brendshme dhe të raporteve të përgjithshme që ekzistojnë në shoqërinë përkatëse, mund të krijohen kritere për caktimin e vijës së përgjithshme të politikës së jashtme të shtetit konkret. Nga parashtrimi i këtij problemi del qartë kërkesa të cilën teoria e politikës së jashtme duhet ta parashtroj në vend të parë, për analizën e raporteve midis politikës së brendshme dhe të jashtme. Me rastin e këtij përcaktimi shumë të rëndësishëm të politikës së brendshme dhe të jashtme, duhet gjithsesi të nisemi nga nevoja e definimit të tërësisë së vetë politikës, që do të mund ta karakterizojmë si fushë të veçantë të raporteve të grupeve shoqërore.

Nuk duhet asesi të harohet karakteri i dyanshëm i politikës, mirëpo një pjesë e madhe autorësh ende refuzojnë vendosshmërisht çfarëdo lidhje midis politikës së brendshme dhe të jashtme, duke pohuar se fjala është për dy linja të ndryshme politike. Politika e brendshme dhe e jashtme sillen në struktura të ndryshme: në të brendshmen, shumë të organizuar dhe të centralizuar, dhe në atë ndërkombëtare, shumë heterogjene dhe të dezorganizuar.

Politika e brendshme dhe e jashtme e çdo shteti ka bazën unike shoqërore, domethënë, sistemin ekonomik dhe strukturën e saj shoqërore. Për këtë arsye nuk ka ndonjë politikë të panvarur, dhe çdo shtet zbaton vetëm një politikë, e cila shpreh intereset themelore të grupit të vet sundues. Pikërisht, për këtë arsye politikën e brendshme dhe të jashtme duhet kuptuar si dy anë të një politike të njëjtë, me çrast politika e brendshme shpreh më tepër dhe në mënyrë më të drejtpërdrejtë strukturën ekonomike dhe politike të shoqërisë, kurse karakterin klasor të politikës së jashtme e cakton esenca e politikës së brendshme. Duke cekur se në politikëne jashtme shteti



vepron dhe përgjigjet në veprimet nga jashtë, ndonjëherë pohoet se politika e jashtme është I ashtuquajtur i aktiviteti I skajshëm. Kjo do të thotë se ajo zhvillohet në dy hapësira të ndryshme: në të brendshmen ose vendore, përkatësisht në hapësirën e jashtme ose globale. Për këtë arsye edhe aktorët e politikës së jashtme, të ballafaquar me një dysi të tillë, kërkojnë mundësinë e akcionit që do të kujdeset për të dyja mjediset.

Hapësira e brendshme vendore është hapësirë në të cilën krijohet politika dhe në të vepron një varg I tërë faktorësh të ndryshëm. Ndër ta theksohet baza natyrore, pozita gjeografike, natyra dhe niveli I zhvillimit ekonomik të shtetit, struktura demografike, ideologjia dhe të gjitha vlerat e tjera fundamentale që e krijojnë politikën e mirrëfilltë vendore. Hapësira ndërkombëtare ose e jashtme është hapësir e madhe në të cilën politika e jashtme vepron dhe kun ë kontakt me aktorët e tjerë zbaton efektet e veta ndërkombëtare.

Në përpjekje të ndarjes së politikës së jashtme nga ajo e brendshme, përkatësisht të theksimit të diferencave që ekzistojnë midis tyre, menjëherë mund të përmendet se kjo çështje është trajtuar që më herët në veprat e shumta filozofike-politike.

Në mësimin marksist ishte pranuar se politika e brendshme dhe e jashtme paraqiten si dy anë të veprimit të përbashkët shoqërorë-historik dhe se ato nuk mund të jenë të izoluara sepse janë në raport të përhershëm reciprok. Nga kjo pasojnë edhe hulumtimet e marrëdhënieve ndërkombëtare që insistonin në mënyrë konsekuente në unitetin e politikës së brendshme dhe të jashtme që klasës sunduese duhet ti siguronte në planin e brendshëm dhe të jashtëm realizimin e interesave të saja.<sup>59</sup>

Zhvillimi bashkëkohorë I marrëdhënieve ndërkombëtare dhe globalizimi I shpejtuar në të gjitha fushat shoqërore – ekonomike, verifikojnë në mënyrë të qartë se po paraqiten lidhje dhe raporte të reja midis antarëve të bashkësisë ndërkombëtare. Plotsimi I funksionit të brendshëm dhe të jashtëm të shtetit është gjithnjë e më tepër reciprokisht I kushtëzuar dhe I ndërlidhur, e me internacionalizmin gjithnjë e më të madh të jetës, bëhet gjithnjë e më tepër bartja e problemeve të brendshme në sferëne marrëdhënieve ndërkombëtare, domethënë veprimtarinë e politikës së jashtme. Autori Stanley Hoffman në veprën e tij *Contemporary Theory in International Relations* pohon se është paradoksale që në politikën bashkëkohore politika e brendshme është e kushtëzuar me problemet botërore, më tepër se kurë ndonjëherë më parë, kurse, nga ana tjetër,

---

<sup>59</sup> Radovan Vukadinović, *Teoritë e politikës së jashtme*, Prishtinë, 2008, fq.27

politika e jashtme mbetet edhe më tej kryesisht nën ndikimin e perceptimeve dhe bindjeve kombëtare që I ka ndonjë popull për veten.

Parashtrohet pyetja se deri në cilën shkallë është e mundur të bëhet kufizimi midis politikës së brendshme dhe asaj të jashtme. Pasi që një varg I tërë I problemeve vijuese politike është I lidhur me aspektin e brendshëm dhe të jashtëm domethënë, me aspektin ndërkombëtarë, është e qartë se është vështirë të flitet për ndonjë kufizim të prerë. Në çështjen e kufizimit të politikës së brendshme dhe të jashtme disa autorë zgjerojnë hulumtimin e vet dhe shqyrtojnë paradigmen e raporteve midis politikës së brendshme dhe asaj të jashtme, siç janë: përgaditja e politikës vetanake të jashtme në raport me politikën e tjera nga jashtë, përpjekja e legalizimit të përgjithshëm të politikës së jashtme, kufizimet e politikës së brendshme në procesin e integritit, me çka në një masë të madhe hyhet në një sferë tjetër të hulumtimit, e cila më tepër mund të ketë të bëjë me problemin e marrëdhënieve midis politikës së brendshme dhe marrëdhënieve ndërkombëtare. Duke hulumtuar problemet e raporteve midis politikës së jashtme të një shteti dhe asaj të brendshme të shtetit tjetër, autori Holst në veprën e tij *International Politics*, i kërkon ato kushte specifike që do të duhej të sqaronin se çka i shtyn shtetet drejt agresionit.

Në shqyrtimin e problematikës së lidhjeve mes dy politikave, të brendshmes dhe të jashtmes, shpeshherë hasen të grupuara dy lloje kuptimesh.

Grupi I parë prej tyre vështron teorinë e politikës së jashtme si funksion të raporteve të brendshme të shteteve, ku në plan të parë theksohet teza mbi politikën e jashtme si një nga nivelet në të cilin realizohen interesat e grupit sundues. Në të njëjtën kategori gjendet edhe teza mbi politikën e jashtme si instrument i politikës së brendshme që vepron aktivisht në raportet ekonomike në shtetin e caktuar.

Në grupin e dytë të pohimeve gjenden ato që caktojnë raportin midis individualitetit, sjelljes dhe kulturës së aktorit.

Pikëpamjet teorike të parashtruara rreth përcaktimeve themelore të raporteve midis politikës së brendshme dhe të jashtme theksojnë: se politika e jashtme është e lidhur fuqishëm me nevojat shoqërore që paraqiten në suazat e mekanizmave të politikës së brendshme. Në botën e sotme globale pothuaj gjithnjë e më tepër po dëshmohet se politika e brendshme nuk mund të kënaq të gjitha aspiratat, nevojat dhe interesat e shoqërisë, pa marrë parasysh se për çfarë shteti të fuqishëm dhe të madh bëhet fjalë. Një pjesë të atyre synimeve I plotëson politika e jashtme e cila, natyrisht, në esencën e vet ka politikën e brendshme e cila shpesh here është e detyruar të

veproj politikisht jasht kufive të shtetit të vet. Qysh në vitet e shtatëdhjeta Rossenau thekson se politika e jashtme nuk është “seri e përgjigjeve në impulse ndërkombëtare”, por në masë të madhe për politikën e jashtme vendosin burimet e brendshme politike. Kjo do të thotë se në situatat ndërkombëtare mund të shihen qartë ndikimet e jetës së brendshme politike.

Procesi I realizimit të politikës së jashtme nvalet nga përmbajtja dhe kualiteti I politikës së brendshme. Burimet dhe mjetete ekzistuese caktojnë realitete dhe mundësite e plotësimit të parashikimeve që janë parashtruar në politikën e jashtme. Këtu gjithsesi është I qenësishëm raporti midis nivelit të zhvillimit të brendshëm dhe shkallës së bashkëpjesmarjes në transferet ndërkombëtare. Vetëm në fazën e arritjes së zhvillimit të caktuar shoqërorë-ekonomik është I mundur inkuadrimi në shkëmbimin ndërkombëtarë që në atë mënyrë fillon të marrë domethënien e brendshme politike.

Në politikën e jashtme të çdo vendi pasqyrohen elementet karakteristike të politikës së brendshme të sistemit të caktuar shoqëror politik.

Duke e vështruar grupin e dytë të analizave teorike të raporteve politika e brendshme-e jashtme, mund të theksohet: kundërthëniet më të mëdha midis dy politikave, e brendshme dhe e jashtme, paraqiten në situatat kur ekziston kriza e caktuar në plan të jashtëm. Raportet me botën e jashtme mund të shfrytëzohen për krijimin e barspeshës së brendshme në shtet ose raportet e brendshme mund të parashtrohen ashtu që të shprehin barspeshën e jashtme. Fjala është gjithsesi për barspeshën funksionale që ka parashtruar grupi sundues dhe asaj I shërben drejtpërdrejtë në realizimin e qëllimeve dhe të interesave që ajo i ka parashtruar. Mirëpo, përpyekjet e krijimit të asaj barspeshë të raporteve, ose të bartjes së qëllimeve të brendshme politike në qëllime të jashtme politike kërkon fuqinë e caktuar të shtetit që, vetëm me mjete të veta të organizuara dhe të fuqishme, mund të zbatoj një politik të tillë. Shembujt e vendeve të shumta në zhvillim, përkatësisht të vendeve të pa inkuadruara, pasqyrojnë qartë mos harmoninë midis politikës së jashtme kinse të angazhuar dhe të politikës së jashtme dinamike dhe të problemeve që ekzistojnë në hapësirën e politikës së brendshme. Politika e jashtme mund të shfrytëzohet si instrument i liderizmit politik në shtet. Varësisht nga ecuritë e gjera ndërkombëtare, në situatë përkatëse ndryshohet, gjithsesi, roli I partive përkatëse politike. Në kohën e situatave ndërkombëtare të krizës ose të marrëdhënieve të ndara ndërkombëtare, politika e jashtme ndikon vendosshmërisht në politikën e brendshme. Në situatat e tilla, veçmas në rast të luftës, politika e jashtme ndikon në drejtimin e politikës së brendshme: duke caktuar tempon

dhe vëllimin e përgaditjeve ushtarake (ndërtimi I forcave ushtarake, armatimi I tyre), duke diktuar përgaditjet ekonomike (sigurimin e lëndëve të para strategjike, orientimin e industrisë në prodhimtarinë ushtarake), duke ndikuar në tendencat e forcimit të masave reaksionare në jetën e brendshme politike të vendit, dhe duke u dhënë ton përgaditjeve ideologjike të shtetit.<sup>60</sup> Uniteti I politikës së brendshme dhe të jashtme sot është gjithnjë e më vështirë të mohohet dhe është simptomatike që edhe në teorinë e marrëdhënieve ndërkombëtare në përfundim pohohet gjithnjë e më shpesh, parasegjithash për arsye se politika e jashtme është bërë më e arritshme për masat e gjera që kur ekziston uniteti I politikës. Mirëpo, përkundër kësaj, disa teoricienë e përjashtojnë krejtësisht karakterin klasor të politikës dhe e parashtrajnë si diçka e përgjithshme popullore, mbiklasore dhe jashtklasore, gjë që, realizohet në bazë të interesave të përgjithshme në dobi të të gjithë qytetarëve.

Tashmë kemi theksuar se politika e jashtme, përkatësisht paraqitja e shtetit në planin ndërkombëtarë, realizohet gjithashtu në pajtim me interesat e grupit sundues dhe me ndihmën e shtetit si instrument i aksionit politik. Por ky raport midis politikës së brendshme dhe të jashtme megjithatë nuk bën të thjeshtësohet në atë kuptim që të kuptohet si gjendje në të cilën grupi sundues në të gjitha shtetet mund të caktoj politikën e jashtme panvarësisht nga shtresat e tjera brenda kufijve shtetërorë. Nga vetë karakteri dhe baza e politikës, në të cilën paraqiten grupe të mëdha shoqërore, del se edhe sunduesit duhet të kujdesen për grupet e tjera, për interesat e tyre dhe mundësitë e aksionit. Për këtë arsye edhe politika e jashtme në një shkallë të qëndrueshme shpreh edhe tërë ndërlikueshmërinë të zhvillimit të politikës së brendshme dhe raportet që ekzistojnë midis grupit në pushtet dhe grupeve tjera. Së këndejmi mund të thuhet se në vështirimin e tillë politika e jashtme është objekt i përhershëm dhe, deri diku, sidomos në vendet dhe situatat e caktuara, rezultat i luftës së ashpër të forcave të kundërta. Pikërisht ky konflikt, si në përmasat e politikës së brendshme, ashtu edhe në përmasat ndërkombëtare, i jep dinamikë shtesë zhvillimit të politikës së jashtme dhe të marrëdhënieve ndërkombëtare shumë më të gjera dhe më komplekse.

---

<sup>60</sup> Radovan Vukadinović, *Teoritë e politikës së jashtme*, Prishtinë, 2008, fq.31

## **2.4. Diplomacia publike dhe digjitalizimi**

Marrëdhëniet ndërkombëtare historikisht janë bazuar në komunikimin diplomatik ndërmjet shteteve por sot jetojmë në një botë globale dhe informacioni qarkullon me “shpejtësinë e zërit”, prandaj me daljen në skenë të internetit dhe teknologjisë së informacionit gjithçka ka ndryshuar edhe në këtë drejtim. Kryeministri dhe Sekretari i Jashtëm Britanik, Lordi Palmerston kur mori mesazhin e pare telegrafik në vitin 1850 reagoi duke thënë: “O zot, ky është fundi i diplomacisë!”.<sup>61</sup>

Kur dëgjojmë terma si diplomaci digjitale, e-diplomaci, diplomaci kibernetike, normalisht se mendja na shkon tek interneti, media sociale, teknologjia, inovacioni por gjithmonë në drejtim të politikës së jashtme, krijohet një lidhje e drejtëpërdrejtë me Facebook, Tëitter, Facebook, Youtube, Flickr, LinkedIn, Instagram, Blog, Google + dhe Selfies që sot gjejnë një përdorim të gjërë në mesin e Presidentëve, Kryeministrave dhe Ministrave sidomos atyre të Jashtëm të të gjithë botës. Diplomacia ende kryhet kryesisht në formën tradicionale midis qeverive dhe shteteve sepse ato kanë përgjegjësitë ligjore dhe kanë pushtetin për të mundur realizimin në praktikë të politikave të jashtme të shtetit dhe në këtë mënyrë realizojnë objektivat, prandaj është shumë e rëndësishme diplomacia ballë për ballë sepse rrit nivelin e besimit dhe lejon vendim-marrjet, por gjithmonë në përshtatje me zhvillimet e fundit moderne që ndikojnë në politikë dhe ekonomi si rasti i Diplomacisë Digjitale.

Çfarë është Diplomacia Digjitale? Nëse e analizojmë kemi dy shkolla mendimi në lidhje me Diplomacinë Digjitale, nga njëra anë shihet si mjet për zhvillimin e Diplomacisë Publike dhe nga ana tjetër shihet si element që rrit aftësinë për të bashkëvepruar me publikun e huaj. Zyra e Jashtme dhe Komonuelthit në Britaninë e Madhe e përkufizon diplomacinë digjitale si “zgjidhje e problemeve të politikës së jashtme duke përdorur internetin”, ndërsa Departamenti i Shtetit të SH.B.A përdor termin “Arti i qeverisjes së shekullit të 21”. Përkufizimi më i saktë mbetet se, Diplomacia Digjitale është përdorimi në rritje i Teknologjisë së Informacionit dhe Mediave Sociale nga një vend për të arritur qëllimet dhe realizimin në praktikë të politikës së jashtme dhe Diplomacisë Publike. Diplomacia dixhitale është veçanërisht e dobishme në diplomacinë publike në fushën e mbledhjes dhe përpunimit të informacionit, në fushën e aktiviteteve konsullore dhe

---

<sup>61</sup> <https://ëëë.botasot.info/opinione/786956/diplomacia-dixhitale-si-mjet-i-realizmit-te-politikes-se-jashtme-dhe-diplomacise-publike/>

për komunikimin gjatë emergjencave dhe fatkeqësive. Sot mediat sociale e kanë ndryshuar krejtësisht mënyrën se si individët komunikojnë me njëri-tjetrin, kjo ka ndikuar edhe në mënyrën se si zyrtarët shtetëror komunikojnë me qytetarët. Përdorimi i internetit dhe i teknologjive të reja të komunikimit të informacionit për të arritur qëllimet diplomatike mbi konceptin shtet me shtet por duke futur edhe marrëdhënien shtet dhe shoqëri civile. Ky fakt bën të mundur që qytatarët e një shteti të komunikojnë, shkëmbejnë mendime, drejtojnë pyetje ose të shprehin kërkesa drejtëpërsëdrejti tek ministritë, ambasadat dhe diplomatët. Një shtet pavarësisht fuqisë, madhësisë apo rëndësisë në arenën ndërkombëtare nëse përdor Diplomacinë Digjitale me anë të platformave dhe mediave sociale mund të arrijë objektivat e politikës së jashtme por edhe të menaxhojë në mënyrë të sukseshme imazhin dhe reputacionin e vendit. Konkretisht me këtë punë brenda shtetit merret Ministria e Jashtme ndërsa jashtë merren Ambasadat e akredituara në shtetet e caktuar, në këtë mënyrë realizohet edhe politika e jashtme e shtetit por njëkohësisht promovohet dhe imazhi i vendit në drejtim të historisë, kulturës, vlerave, traditave.

Ndryshimet rrënjësore teknologjike dhe sociale natyrisht se impaktojnë edhe ndërveprimin mes shteteve, pra edhe diplomacinë. Në këtë nën kapitull do të zërthejmë binomin diplomaci-kulturë digjitale.

Sot Ministritë e Jashtme, Ambasadat dhe Diplomatët janë pjesë e rrjeteve sociale, kjo është një mënyrë efektive e komunikimit ndërmjet politikbërësve dhe qytetarëve, kjo të jep mundësinë e një qasje të drejtëpërdrejtë me qytetarët brenda dhe jashtë vendeve të tyre. Si çdo gjë tjetër edhe kjo ka anët e saj pozitive dhe negative, ku pozitiv është fakti se qeveritë dhe diplomatët mund të komunikojnë shpejt në të gjithë botën, problemet mund të zgjidhen më shpejt, qytetarët mund të komunikojnë drejtëpërdrejtë pa censura, por sidoqoftë komunikimi online mund edhe të përdoret për veprime negative të cilat mund të jenë të rrezikshme, prandaj duhet të jemi gjithmonë vigjilent. Gjeneratat e reja të zyrtarëve, diplomatëve dhe qytetarëve duhet të praktikohen dhe zhvillohen në përdorimin e mediave sociale sepse ne jetojmë në epokën e internetit dhe teknologjisë së informacionit që duhet të shërbejë si urë lidhëse ndërmjet qeverive dhe qytetarëve.

Diplomacia digjitale, e mbiquajtur edhe *e-diplomacy*, nënkupton shfrytëzimin gjithnjë e më të madh të teknologjive informative dhe të komunikimit (ICTs) si dhe të medias sociale për të arritur qëllime të caktuara në politikën e jashtme dhe në sferën e diplomacisë apo të diplomacisë publike. Egziston poashtu, diplomacia e *cyber-aktivizmit*, shtetndërtimit online (online

statecraft), e marrjes së monopolit nga diplomatët, kur diplomat mund të bëhet çdokush që ka kompjuter e vegël tjetër të IT-së dhe internet. Diplomacia digjitale për dallim nga diplomacia tradicionale ndërtohet nga të mësuarit, ndërveprimi dhe komunikimi digjital. Kjo është faza e tretë e diplomacisë, pas asaj klasike (negociatat, pushteti i fortë, hegjemonia, marrëdhëniet hierarkike, protokoli) dhe publike (komunikimi strategjik ve fuqia e butë). Është diplomaci e botës kibernetike, e jetës digjitale, e veglave mobile, e medias dhe rrjeteve sociale, të një sistemi ku mbizotërojnë sensorët dhe algoritmat, diplomaci e ubernetit.

Disa e kanë quajtur edhe *tëiplomacy*. Në Britani quhet diplomaci e zgjidhjes së çështjeve diplomatike klasike përmes internetit. Diplomacia digjitale i shmang kufijt, e shpërfill protokolin. Zyrat shtetërore mund të mbyllen por interneti, laboratorët e inovacioneve digjitale dhe diplomacia digjitale punon 24 orë. Themelues të diplomacisë digjitale janë SHBA-të dhe Franca, ndërsa investime të mëdha bëjnë edhe Franca, India, Izraeli.

Në diplomacinë publike përdoren edhe lojërat digjitale, si Trace Effects e ministrisë amerikane të punëve jashtme.

Sot në shekullin XXI dhe në epokën digjitale diplomacia nuk varet vetëm nga diplomatët e emëruar/zyrtarë dhe profesionalë/të karrierës por edhe nga çdo aktor apo qytetar i një shoqërie apo shteti, nga mënyra se si ai frymon në rrjetet sociale, çfarë imazhi prodhon për segmentin digjital, si e përfaqëson shtetin e vet në sferën virtuale. Prapambetja në këto përmasa na bën analfabetë të kohës dhe na lë në marginat e botës.

Por ama në dekadën e fundit diplomacia digjitale është zhvilluar në Shqipëri më një shpejtësi dhe kualitet të jashtëzakonshëm, aq sa Shqipëria është rankuar 31 mes realitetit dixhital të më se 200 Ministrive të Jashtme dhe më shumë se 400 udhëheqësve të vendeve të ndryshme. Renditja e vitit 2017 është 12 vende më e mirë se ajo e një viti më parë. Arsytet i sqaron në një interviste ekskluzive, Drejtoresha e Diplomacisë Ekonomike, Publike dhe Diasporës në ministrinë e jashtme Donika Hoxha.<sup>62</sup>

Në një botë digjitale, ku më shumë se 200 Ministri të Punëve të Jashtme dhe më shumë se 400 udhëheqës të vendeve të ndryshme kanë llogaritë e tyre në mediat sociale, të cilat i përdorin për të diktuar politikën e jashtme të vendeve të tyre, si dhe ku shumë vende po krijojnë aplikacione

---

<sup>62</sup> <https://ëëë.rtsh.al/lajme/diplomacia-dixhitale-shqiperia-permireson-pozicionin/>

për qytetarët e tyre që jetojnë ose udhëtojnë jashtë vendit, nuk mungon Shqipëria. Për t'u veçuar janë llogaritë në rrjetet sociale të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme dhe ministrit Ditmir Bushati, por edhe aplikacioni i posaçëm “E-Konsullata”, i cili ofron informacion konsullor për të gjithë qytetarët shqiptarë që udhëtojnë në vende të ndryshme. Metodologjia e renditjes së sivjetshme “DDR17” bazohet në një qasje të re të diplomacisë, duke identifikuar 5 nevoja kryesore të diplomacisë dixhitale, të përshkruara si nivele hierarkike brenda një piramide. Ato përfaqësojnë gjithashtu fazat e progresit, nga fillestar në shkallën e avancuar të praktikës së diplomacisë dixhitale, e janë: prania në mediet sociale, përshtatshmëria, përditësimi, angazhimi dhe diplomacia dixhitale. Këto nivele të performancës së diplomacisë dixhitale shqyrtohen mbi bazën e treguesve të tjerë cilësorë, si kreativiteti dhe autenticiteti, transparenca, menaxhimi i përmbajtjes, siguria, hapja, ndikimi, lloji i audiencës, profesionalizmi dhe fushatat shkatërruese/inovative.



## **2.5. Diplomacia dhe globalizimi**

Me zhvillimin e studimeve të politikave publike, e sidomos politikave publike krahasuese, morri hov edhe interesimi për politikat publike globale. Kjo çoi në kalimin nga aspektet ‘organizative’ të strukturave të organizatave në fokusimin se si institucionet ndërkombëtare koordinohen, formohen dhe operojnë në aspekte të çështjeve globale që lidhen me sistemin botëror dhe problemet me të cilat ballafaqohet mbarë njerëzimi. Edhe pse disa autorë besojnë se bashkërendimi i mekanizmave ndërkombëtarë ka një historik të mëhershëm e sidomos prej fundit të viteve të 1970-ta, çështjet e politikave publike ndërkombëtare zunë fill dhe u bënë objekt i disa studimeve vetëm në dy dekadat e fundit. Në të shumtën e rasteve, këto studime ishin brenda disiplinave tjera, sidomos të fushës së Marrëdhënieve Ndërkombëtare apo Politikës Krahasuese, dhe kryesisht të bazuara në çështje tematike si p.sh., politikat energjetike, financat etj. Disa nga këto studime përfshijnë ato nga Robert Keohane dhe Joseph Nye “Poëer and Interdependence: Eëorld Politics in Transition” (1977), pastaj nga autorë të spikatur si Marvin Soroos (1986) Eëolfgang Reinecke (1997) Stuart Nagel (1999). Në kuadër të Asociacionit Ndërkombëtarë të Shkencës Politike (IPSA) me 1988 formohet seksioni apo grupi punues i ri për studime të ‘Politikave Publike Globale’ (Global Policy Studies).<sup>63</sup>

Një përkufizim i ngushtë të asaj se çka nënkuptojnë Politikat Publike Globale vështirë se mund të ofrohet, pasi përdoren terme të ndryshme për të përshkruar këtë fushë si Politika Publike Ndërkombëtare, Trans-kombëtare, Arena globale, Rrjetëzime globale etj. Emëruesi i përbashkët, megjithatë, mbeten politika të caktuara dhe të zbatuara jo vetëm nga qeveritë e shteteve, por mbi të gjitha nga aktorët tjerë botëror.<sup>64</sup>

Globalizimi shihet si fenomen botërorë, I cili mund të ndikojë në ndryshimin e sistemit politik nëpër vende të caktuara, por mund të ndikojë edhe në krijimin e një rendi të ri botëror. Kjo nënkupton se shtetet-kombe nuk mund të shihen më si aktorë të pavarur në skenën botërore.<sup>65</sup>

Me paraqitjen e globalizimit në skenën politike botërore ndodhin ndryshime radikale, siç është humbja e statusit të privilegjuar të shtetit-komb, d.m.th. në skenën politike botërore, përveç

---

<sup>63</sup> Bekim Baliqi, *Politikat Publike dhe Qeverisja, Fondacioni Konrad Adenauer*, Prishtinë, 2017, fq.252

<sup>64</sup> Bekim Baliqi, *Politikat Publike dhe Qeverisja, Fondacioni Konrad Adenauer*, Prishtinë, 2017, fq.253

<sup>65</sup> Andreë Heyëood, *Politika*, Prishtinë, 2018, fq.161

shtetit partaqiten edhe subjekte tjera në procesin e politikbërjes. Rasti i Bashkimit Sovjetik dhe i Shqipërisë janë një shembull që tregon se ndryshimet globale reflektohen edhe në vendet më të centralizuara dhe pothuajse hermetikisht të mbyllura. Nga kjo mund të konstatjmë se askush nuk është imun nga ndryshimet shoqërore-politike pa marrë parasysh se ku ato ndodhin.<sup>66</sup>

Sikurse me politikat publike vendore dhe ato globale, sfida mbeten krijimi i konsensusit apo çështjet e mospajtimeve dhe konflikteve mes qeverive dhe aktorëve tjerë, sidomos zbatimi i politikave është i vështirë, pasi detyrimi apo sanksionimi në raste të mos respektimit dhe zbatimit të vendimeve dhe rregullave mund të mungoj. Në sfondin e politikave publike globale, vlen të shtjellohet edhe dukuria e transferimit të politikave (policy-transfer), për të cilën aspekt në dekadën e fundit ka një interesim të shtuar të studiuesve të shumtë.<sup>67</sup>

**Shembull:** Disa prej aktorëve të rëndësishëm global në Politikat Publike Globale<sup>68</sup>

*International Civil Aviation Organization (ICAO)* që krijon dhe mbikëqyrë standardet e sigurisë dhe të shërbimeve si për aviokompanitë ashtu edhe për aeroportet.

*Internet Corporation for Assigned Names and Numbers (ICANN)* me seli në ShBA është organizatë jo-fitimprurëse që menaxhon dhe rregullon domenet e ueb-faqeve dhe regjistrat që lidhen me internet.

*World Intellectual Property Organization (ËIPO)* dhe marrëveshja që del nga ajo si Agreement on Trade-Related Aspects of Intellectual Property Rights (TRIPS) që rregullon politikat rreth patentimit dhe pronës intelektuale.

*The Basel Committee on Banking Supervision*, e rregullon dhe mbikëqyrë sektorin bankar në aspektin e rrjedhes së kapitalit dhe vendosjen e standardeve.

Globalizimi luan rol pozitiv në vendet e zhvilluara dhe të pazhvilluara. Vendet e varfra si Shqipëria do të përfitonin shumë nga tregtia e lirë e globalizimit, pasi do të sillte rritje të

<sup>66</sup> Jonuz Abdullahi, *Politika dhe Politikat Publike*, Arbëria Design, Tetovë, 2010, fq.155

<sup>67</sup> Lütz, Susanne. "Policy-Transfer und Policy-Diffusion", Handbuch Governance, 2007, fq.132,144

<sup>68</sup> Bekim Baliqi, *Politikat Publike dhe Qeverisja*, Fondacioni Konrad Adenauer, Prishtinë, 2017, fq.257

konkurencës, uljen e çmimeve dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Sipas parimeve bazë të saj ajo ka disa avantazhe: hapja e tregjeve në mallra, shërbime në sfera të ndryshme dhe zhvillimin e bujqësisë. Vende që kanë mungesë në resurse apo të mira dhe shërbime janë duke përmirësuar standartin e tyre të jetesës, për shkak të globalizimit. Shqipëria është cilësuar si minierë nëntokësore. Terreni i saj është kryesisht fushor dhe ka premisa shumë të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.

Shikuar në aspektin negativ globalizimi synon t'i bëjë kufijtë kombëtare të parëndësishëm. Pra, ç'do vend i botes do të mund të shkëmbejë mallra e shërbime me të gjithë botën pa pengesa të tipit: taksa mbi importet, kuota mbi sasinë që mund të importohet etj. Gjithashtu synohet që t'i jepet fund ndihmës financiare që një shtet mund t'i jap industrive të caktuara vendase.

Diplomatët që përfaqësojnë shtetet e tyre në vende të ndryshme, janë të angazhuar tërësisht për përmirësimin dhe ngritjen e diplomacisë, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe politikës së jashtme shtet më shtet në nivele të reja. Arsyeja se përse në të ardhmen do të ndodhin këto ndryshime, janë si pasojë e zhvillimit supersonik të teknologjisë së komunikimit. Zhvillimi dhe globalizimi botëror do të ketë edhe komponentë që nuk do të ndryshojnë si gjuha, që do të jetë kjo që është edhe sot për secilin shtet, me gjithë evolucionin gjuhësorë përkatës, pra në të ardhmen nuk do të kemi një gjuhë botërore të vetme. Ky fakt lidhet me identitetin, patriotizmin, nacionalizmin kombëtar të shteteve dhe kombeve. Kultura, tradita, monedhat e shteteve sado të zhvillohen dhe përafrohen ose të universalizohen, ato kurrë nuk do të mund të zhduken. Individit që nga lashtësia është i lidhur ngushtë me identitetin, gjuhën, origjinën, flamurin, kulturën, traditën të cilat janë të pazëvendësueshme për këdo.

Pra mund të themi që globalizimi nuk është as gogol, as diçka që duhet përqaftuar si shpëtimtari i botës. Pra, është një dukuri për të cilën duhet të jemi mirë të informuar dhe duhet ta trajtojmë me një skepticizëm.

### **3.Historiku i Marrëdhënieve ndërkombëtare mes Republikës së Italisë dhe Republikës së Shqipërisë**

Qëllimi i këtij punimi përqëndrohet në analizën e politikës së jashtme dhe marrëdhënieve ndërkombëtare mes Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë, dhe në krahasimin e dy politikave dhe qasjet e tyre drejt një politikbërjeje diplomatike. Tema bosht e kësaj teze është trajtimi i Marrëdhënieve Ndërkombëtare mes dy republikave, duke përfshirë të gjitha specifikat empirike, teorike dhe metodologjike të saj. Nuk është e mundur të futemi në analiza plotësuese, pa mos e shtjelluar më detajisht historikun e marrëdhënieve dypalëshe, bashkëpunimet e tyre, misionet, negociatat, traktatet dhe përfitimet në fusha të ndryshme.

Nënkapitujut në vijim do të jenë elaborime ekzakte për politikat e jashtme të dy shteteve veçmas, që nga historia e deri në aktualitet.

Marrëdhëniet shqiptaro-italiane, janë po aq të lashta sa edhe historia e këtyre dy shteteve. Historia është dëshmitare e një binomi të qëndrueshëm interesash. Roma dhe Venediku i dhanë, por edhe përfituan shumë nga zhvillimi ekonomik, politik dhe kulturorë i Ilirisë. Nuk është rastësi që në fronet perandorake janë ulur figura me origjinë ilire; ashtu siç nuk është rastësi bashkëpunimi ndërmjet Skënderbeut dhe Alfonsit të V-të të Napolit; nuk është rastësi që dokumenti i parë i gjuhës të shkruar shqipe, "Formula e Pagëzimit" u zbulua në bibliotekën e Milanos; ashtu siç nuk është rastësi që qindra e mijëra arbëreshë të përndjekur nga pushtuesit osman pas vdekjes së Skënderbeut gjetën strehim në tokën Italiane; gjithashtu nuk është rastësi që në repartet e Garibaldit luftuan e derdhën gjak për lirinë dhe bashkimin e Italisë me qindra arbëreshë. Dihet kontributi i Italisë për panvarësinë e Shqipërisë, dhe sidomos përpjekjet e saj në Konferencën e Londrës (1912-1913), krahas Austrisë për krijimin e një shteti të panvarur shqiptarë. Por padyshim mun te konstatojm se kulminacioni i bashkëpunimit të sukseshëm mes dy shteteve mun ta hasim gjate periudhes që shkon prej rrënjes së regjimit dictatorial deri ne ditët e sotme.

### **3.1. Politika e jashtme e Shqipërisë**

Politika e jashtme e Shqipërisë që nga pavarësia e saj ka mbajtur një politikë të plotësueshmërisë duke u përpjekur që të ketë marrëdhënie miqësore me të gjitha shtetet.

Faktorët kryesorë që përcaktojnë politikën e jashtme shqiptare përbëhet nga lokacioni gjeopolitik, popullsia, kriza ekonomike, dhe lidhjet me diasporën shqiptare nëpër të gjithë botën. Shqipëria është koncentruar në mbajtjen e marrëdhënieve të mira me fqinjët e saj, të pasur qasje në institucionet e sigurisë Evro-Atlantike, dhe sigurimin e lidhje të ngushta me Shtetet e Bashkuara.

E kaluara variable e politikës së jashtme të Shqipërisë është mjaft e pasur me ngjarje që datojnë që nga krijimi i shtetit shqiptarë e deri në kohën e sotme të globalizimit modern, andaj nuk mund të qasemi drejtpërsëdrejti në sqarimin e çështjes së politikës së jashtme pa mos e pasqyruar kronologjikisht funksionin e saj në tërësi dhe rolin në politikë. Krijimi i Institucionit të Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ) të shtetit modern shqiptar pason me krijimin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës më 4 dhjetor 1912, pak ditë pas deklarimit të shkëputjes së Shqipërisë nga Perandoria Osmane. Kryeministri i Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemali, mbajti edhe postin e ministrit të punëve të jashtme deri në qershorë të vitit 1913.

Më pas ky funksion i kaloi Myfit Bej Libohovës i cili e ushtroi atë deri në fund të janarit të vitit 1914. MPJ në këtë periudhë funksion si një seksion i qeverisë së përkohshme, me objektiv kryesorë sigurimin e njohjes së panvarësisë së Shqipërisë nga fuqitë e mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Për të realizuar këtë objektiv u kryen edhe shërbimet e para diplomatike sic ishte dërgata diplomatike e Qeverisë së Vlorës në konferencën e ambasadorëve, e kryesuar nga diplomati personal i kryeministrit Rasih Dino.

Me vendimin e 29 korrikut 1913, Konferenca e Ambasadorëve të 6 Fuqive të Mëdha në Londër, vendosi që Shqipëria e kufijve që përcaktoi kjo Konferencë, të formohej si principatë autonome, sovrane dhe trashëgimore, nën garancinë e të 6 Fuqive. Princi do të caktohej nga të 6 Fuqitë dhe cdo lidhje sovraniteti midis Turqisë dhe Shqipërisë do të përjashtohej. Kontrolli i administratës civile dhe i financave të Shqipërisë i besohet një Komisioni Ndërkombëtar të përbërë nga

delegatët e të 6 Fuqive dhe nga një delegat i Shqipërisë. Deri në mbërritjen e princit, çdo gjë do të nënshtrohej kontrollit të Komisionit Ndërkombëtar. Në rrethanat e një situatë të vështirë të krijuar brenda dhe jashtë vendit, më 15 janar 1914, Ismail Qemali u detyrua ta kalonte pushtetin në duart e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Ky Komision u ngarkua nga Konferenca e Ambasadorëve që të përpunonte një projekt për organizimin e hollësishëm të administratës shqiptare. Më 7 mars të vitit 1914 mbërrin në Durrës princi gjerman Eilhem Eieddi. Princi i Shqipërisë emëroi më 17 mars 1914 “Qeverinë definitive”. Kryeministri i parë dhe Ministër i Punëve të Jashtme i shtetit të ri shqiptar të njohur zyrtarisht, ishte Turhan Pashë Përmeti, ish-ambasador i Perandorisë Osmane në San Petersburg. Turhan Pasha qëndroi si ministër i jashtëm deri më 28 maj 1914, më pas u zëvendësua nga Prenk Bibë Doda dhe ky i fundit, mbas korrikut u pasua nga Mehmed Konica. Meqenëse Italia dhe Austro-Hungaria ishin autorët e formulës për njohjen e pavarësisë së Shqipërisë, kapiten Castoldi, oficer Italian, ishte “i komanduar” pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme për misionet diplomatike. Ai bashkë me diplomatin austriak Buchberger formuan kabinetin politik të princit. Përfaqësimi i parë diplomatik zyrtar shqiptar u vendos në Vjenë, përfaqësuar nga Syrja bej Vlora, dhe në Romë, përfaqësuar nga Myfid bej Libohova. Qeveria dhe Ministria e Punëve të Jashtme të Shqipërisë funksionuan deri në prag të fillimit të Luftës së Parë Botërore shtator 1914. Më 3 shtator Princ Eieddi u largua nga Shqipëria dhe vendi u kthye në një teatër lufte të shteteve ballkanike dhe të Fuqive të Mëdha

Mbarimi i luftës rishtroi përpara popullit shqiptar problemin e ekzistencës së shtetit të pavarur shqiptar. Në këto rrethana lindi nevoja e krijimit të një qeverie kombëtare shqiptare që të shprehte interesat e shqiptarëve dhe t’i mbronte ato në Konferencën e Paqes në Paris që do të fillonte punimet në janar të vitit 1919. Për këtë qëllim, pas një pune përgatitore intensive, u vendos që të mblidhej një kongres në ish-kryeqytetin e Shqipërisë, në Durrës, në dhjetor të vitit 1918. Duke shpresuar tek mbështetja e Italisë për ruajtjen e pavarësisë së Shqipërisë, u kërkua ndihma italiane për organizimin e këtij Kongresi. Qeveria e Përkohshme e dalë nga Kongresi i Durrësit përbëhej nga 14 anëtarë. Ajo kryesohej nga Turhan Pashë Përmeti dhe Ministër i Punëve të Jashtme u emërua Myfit bej Libohova. Një delegacion i përbërë nga disa anëtarë të qeverisë dhe i kryesuar nga Turhan Pashë Përmeti u caktua t’i paraqiste Konferencës së Paqes kërkesat kombëtare shqiptare dhe t’i mbronte ato. Meqenëse në qëndrimet e saj Qeveria e Durrësit demonstroi se kishte rënë pre e interesave italiane në Shqipëri dhe nuk po përfaqësonte

interesat kombëtare shqiptare, lindi nevoja e zëvendësimit të saj me një qeveri kombëtare shqiptare.

Në janar të vitit 1920, në Lushnjë, me iniciativën e patriotëve dhe intelektualëve shqiptarë të kohës, u mbledh një Kongres me përfaqësues nga të gjitha krahinat e çliruara të Shqipërisë, që do të zgjidhte qeverinë kombëtare shqiptare larg influencës italiane. Më 30 janar 1920 u krijua qeveria kombëtare shqiptare, me një bazë të gjerë mbështetëse. Kryeministër i saj ishte Sulejman Delvina dhe Ministër i Punëve të Jashtme Mehmet Konica. Meqenëse Konferenca e Paqes në Paris e la të pazgjidhur çështjen shqiptare, njohjen e pavarësisë dhe kufijve të saj të përcaktuara në vitin 1913, Ministri i Jashtëm Konica u nis menjëherë në kancelaritë kryesore të Evropës të kohës për të siguruar përkrahjen e tyre në arritjen e një vendimmarrjeje për Shqipërinë.

Për të ndërtuar një shërbim të jashtëm profesionist, me një vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave, në tetor të vitit 1920, Ministri i Punëve të Jashtme, M.Konica, ngarkohej të gjente një konsull nga konsujt e vjetër të Austrisë që të punësohej për një periudhë 2-vjeçare për organizimin e konsullatave shqiptare e të shërbente si mësues për ato që dëshironin të hynin në shërbimin konsullor të Shqipërisë. Më pas, në gusht të vitit 1921, Këshilli Kombëtar (parlamenti) me propozimin e Komisionit për Politikën e Jashtme vendosi që të hapen konsullatat shqiptare në Brindizi, Trieste dhe Firenze.

Pas pranimit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve me 17 dhjetor 1920 dhe Vendimit të 9 nëntorit 1921 të Konferencës së Ambasadorëve në Paris, që risanksionuan pavarësinë e shtetit shqiptar dhe kufijtë e përcaktuar në vitin 1913, shumë shtete e njohën qeverinë shqiptare dhe filluan të vendosnin marrëdhënie diplomatike me shtetin shqiptar. Në vitet 1922-1923 u hapën legatat shqiptare në Londër, Paris, Romë, Beograd, Sofje, Athinë, Bukuresht, përfaqësia shqiptare në Lidhjen e Kombeve, si dhe konsullata të përgjithshme në Aleksandri, Bukuresht, Luksemburg, Stokholm, Trieste, dhe konsullata në Bari, Konstandinopojë, Konstancë, Hamburg, Neë York, Selanik, Korfuz, Vienë, Mynih, Brindizi, ndërkohë që shumë të huaj në këtë periudhë i drejtohen me kërkesa qeverisë shqiptare që të emërohen si konsuj nderi të Shqipërisë në vende të tjera.

Në fillim të vitit 1922, në prag të hapjes së legatave të huaja në Shqipëri, Këshilli i Ministrave i propozoi Këshillit Kombëtar që të krijohet pranë Këshillit të Lartë (Regjenca) një strukturë e veçantë për ceremonitë e pritjes së përfaqësuesve të huaj. Ky propozim nuk u miratua. Këshilli

Kombëtar vendosi që detyrat e kësaj strukture t'i kryente një punonjës i MPJ-se, fakt që shënon dhe fillimet e Protokollit të Shtetit pranë MPJ-së.

Nga fundi i vitit 1922, Këshilli Kombëtar i kërkoi MPJ që përfaqësitë shqiptare jashtë vendit të vinin në dijeni të gjitha kolonitë shqiptare në shtetet ku këto përfaqësi ishin akredituar për aktivitetin dhe bisedimet në Këshillin Kombëtar për problemet e kolonive shqiptare, një akt që përbën fillimet e punës së shtetit shqiptar me diasporën shqiptare në botë.

Për herë të parë MPJ krijoi strukturën e vet organizative, pra ndarjen zyrtare të punëve, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.70, datë 6 shkurt 1923, i cili miratoi propozimin e MPJ-së për organizimin e këtij institucioni dhe emrat e personelit që do të mbulonte çdo pozicion të parashikuar pune. Në këtë organikë u shfaqën për herë të parë edhe gradat diplomatike si pozicion pune në MPJ, të marra kryesisht nga modeli turk i hierarkisë diplomatike.

Pas krijimit të Republikës së parë të Shqipërisë, janar 1925, Presidenti i Republikës së Shqipërisë Ahmet Zogu, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme Hysen Vrioni, miratoi ndarjen e punëve politike nga ato konsullore-administrative dhe krijimin e një Drejtorie Politike në MPJ. Argumentet kryesore ishin rritja e aktivitetit të MPJ, nevoja për të hyrë në marrëdhënie më të drejtpërdrejta me trupin diplomatik të huaj të akredituar në Shqipëri dhe përfaqësitë shqiptare jashtë vendit, si dhe për të ndjekur me seriozitet çështjet e ndryshme që diskutoheshin në Lidhjen e Kombeve, e cila dita - ditës po merrte një rëndësi të veçantë. Tani MPJ ka dy drejtori, atë politike dhe atë konsullore-administrative.

Një ndër aktet e para që ndërmori kryesia e Republikës së Shqipërisë ishte thirrja që iu bë të gjitha institucioneve të larta shtetërore për përgatitjen e projekt-ligjeve organike të tyre lidhur me organizimin e këtyre institucioneve dhe ndarjet administrative të detyrave. Njëkohësisht, nisur nga modelet e institucioneve homologe jashtë vendit, MPJ i propozoi Këshillit të Ministrave fillimin e aplikimit të sistemit të gradave diplomatike gjatë karrierës diplomatike të çdo nëpunësi.

Në prill të vitit 1927, strukturës së MPJ-së iu shtua edhe Zyra e Shtypit, zyrë që u transferua në MPJ nga Ministria e Brendshme. Arsyet që u përdoren si argument për këtë transferim ishin rëndësia që i jepet shtypit dhe influencës së tij në të zgjidhurit e çështjeve politike-diplomatike në të gjithë botën e qytetëruar.



Formën e organizimit dhe të paraqitjes së këtij institucioni e përcaktonte Ligji Organik i MPJ-së, hartimi i të cilit filloi që në vitin 1925, por arriti të finalizohet në vitin 1929, nën kujdesin e veçantë të Ministrit të Punëve të Jashtme Rauf Fico. Ligji organik i MPJ-së u konsiderua si shtylla vertebrale e dikasterit. Në ligj përcaktohej që administrata qendrore në MPJ do të ndahej në këto zyra kryesore:

- Sekretariati i Përgjithshëm
- Drejtoria Politike
- Drejtoria Konsullore, Administrative, e Kontabilitetit dhe e Personelit
- Zyra e Shtypit i kaloi përsëri Ministrisë së Brendshme, ndërsa Protokolli i Shtetit u atashua pranë Drejtorisë Konsullore, Administrative, të Kontabilitetit dhe të Personelit.

Ky ligj rregullonte funksionimin e të gjithë shërbimit të jashtëm, duke përcaktuar detyrat e çdo pjese të strukturës së institucionit, nivelin e diplomatëve që duhet të punonin në këtë strukturë, nivelin e përfaqësimit të Mbretërisë Shqiptare (1 shtator 1928) në botë. Emërtesat e çdo lloji në MPJ do të propozoheshin nga MPJ, do të miratoheshin në Këshillin e Ministrave, në Këshillin Kombëtar e më pas dekretoheshin nga Mbreti, Zogu I.

Në janar të vitit 1932, me Urdhër Mbretëror pranë MPJ-së u krijua Biblioteka e institucionit që do të mbante në fondet e saj të gjitha shtypshkrimet e çdo veprimtarie që i përkiste Lidhjes së Kombeve. Për hapjen e kësaj Biblioteke u dërguan nga Gjeneva 171 libra të të gjitha akteve të miratuara nga kjo organizatë.

Në janar të vitit 1936, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme Fuat Asllani, në strukturën e MPJ-së u shtua edhe Drejtoria për Lidhjen e Kombeve, e cila konsiderohej si organizata më e rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave ndërkombëtare të shqiptarëve në ato vite. Kjo drejtori do të merrej edhe me problemet e diasporës shqiptare jashtë vendit, si dhe të mbante statistikat mbi numrin dhe gjendjen e tyre. Po në këtë vit u rihap në strukturë edhe Drejtoria e Shtypit e cila u shkëput përsëri nga Ministria e Brendshme. Kjo drejtori u ngarkua edhe me detyrën e kontrollit të librave që hynin në Shqipëri.

Ndërkohë vazhdoi hapja intensive e konsullatave të nderit për të bërë të njohura vlerat e Shqipërisë në Evropë e më gjerë në pamundësi për të hapur përfaqësi konsullore shqiptare në

këto shtete. Pas pushtimit të Shqipërisë më 7 prill 1939, qeveria e re e krijuar më 12 prill 1939 dhe e kryesuar nga Shefqet Verlaci, ngarkoi Dr. Xhemil Dino-Ministër i Punëve të Jashtme, që të hynte në marrëveshje me Ministrin e Jashtëm Italian, Kontin Cianno, për arritjen e një akordi, në bazë të të cilit të unifikoheshin shërbimet diplomatike dhe konsullore të të dy mbretërive shqiptare dhe atë italiane dhe që marrëdhëniet ndërkombëtare të të dy shteteve të përqendroheshin në Romë pranë Ministrisë Mbretërore të Punëve të Jashtme. Në atë kohë MPJ Shqiptare kishte një personel të përbërë nga një drejtor protokolli, një drejtor politik të përkohshëm, një drejtor ad interim për punët me Lidhjen e Kombeve, një shef të shifrës, 4 sekretarë të dytë dhe të tretë, dhe 10 atashe. Ndërsa qeveria vazhdoi punën e saj për më shumë se dy vite, deri në 4 dhjetor 1941, veprimtaria e MPJ nuk u zgjat as edhe tre muaj. Më 3 qershor 1939, Dino dhe Ciano nënshkruan akordin në fjalë. Pasi u miratua nga Këshilli i Ministrave, akordi iu kalua me 5 qershor 1939 Mëkëmbësit të Përgjithshëm në Shqipëri Francesco Jacomoni për dekretim. Po më 5 qershor 1939, akordi u dekretua. Në këtë akord parashikohej gjithashtu edhe “krijimi përkohësisht i një Zyre në varësi të Kryesisë së Këshillit të Ministrave e cila ngarkohej me trajtimin dhe likuidimin e çdo çështjeje me karakter administrativ e mbetur e patrajtuar deri më 3 qershor 1939 nga MPJ tashmë e suprimuar.” Pas kësaj date të gjitha aktet zyrtare i drejtoheshin Kryesisë së Këshillit të Ministrave për zgjidhje. Shërbimi diplomatik e konsullor shqiptar u suprimua nga shërbimi diplomatik e konsullor Italian. Ndërkohe pranë MPJ italiane u krijua nënsekretariati i shtetit për punët e Shqipërisë, ose siç njihesh me emrin “ Zyra Shqiptare”. Në vitin 1940, Mëkëmbësia e Përgjithshme Mbretërore u ndodh përballë një numri të madh ankesash të shumë familjeve shqiptare të shqetësuara se nuk kishin marrë lajme prej të afërmeve të tyre që ndodheshin në shtetet që ishin në konflikt. Në këto kushte MPJ Mbretërore vendosi krijimin e një shërbimi informatash mbi shqiptarët që banonin ndër vendet e pushtuara ose armike si dhe të kolonive. Ky shërbim shkonte paralel me atë që ekzistonte për italianët në ato vende. Pas likuidimit të atributëve të MPJ-së Shqiptare, në janar 1941 një pjesë e personelit diplomatik shqiptar me bindje fashiste, që aktualisht ishin të papunë, u pranuan në rolin e nëpunësit për çështjet shqiptare pranë MPJ-së së Romës ose u bënë pjesë e listës së pritjes së këtij institucioni. Nga qershori i vitit 1939 dhe deri në tetor të vitit 1943, Shqipëria nuk kishte Ministri të Punëve të Jashtme për rrjedhojë nuk ekzistonte as shërbimi diplomatik shqiptar.

Pas kapitullimit të Italisë fashiste, më 14 shtator 1943, politikanët e mbetur nga administrata e vjetër krijuan një Kuvend Kombëtar të përbërë prej 22 vetave, të kryesuar nga Pejani, si edhe një Komitet Ekzekutiv të Përkohshëm të përbërë prej 6 vetave, të kryesuar nga Ibrahim Biçakçiu, komitet i cili funksiononte si qeveri e përkohshme. Detyra e parë e këtij Kuvendi ishte të shpallte fundin e zgjedhës italiane në Shqipëri dhe të bënte thirrje për krijimin e një qeverie përfaqësuese. Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm mori në dorëzim drejtimin e punëve të shtetit deri në formimin e qeverisë. Pjesë e këtij Komiteti ishte edhe “Zyra e ngarkuar për Punët e Jashtme”. Me vendimin nr.61, datë 21 shtator 1943, Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm shfuqizoi akordin e lidhur me 3 qershor 1939 midis Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Italiane mbi unifikimin e shërbimeve diplomatike dhe konsullore. Zyra e ngarkuar për Punët e Jashtme, dhe më vonë MPJ, gjatë kohës së pushtimit gjerman ishte ngarkuar të kryente funksionet ndërlidhëse ndërmjet Administratës Shqiptare dhe autoriteteve ushtarake gjermane. Çdo dikaster që ndeshte pengesa në punën e tij nga veprimtaria e Administratës Ushtarake gjermane në Shqipëri i drejtohej Zyrës së ngarkuar me Punët e Jashtme dhe më vonë MPJ-së. Me Vendimin nr.68, datë 13 tetor 1943, Komiteti Ekzekutiv i Përkohshëm i Shqipërisë nën kryesinë e Ibrahim Biçakçiu, vendosi që në situatën e re të krijuar Shqipëria duhej të dilte si subjekt i pavarur në arenën e marrëdhënieve diplomatike ndërkombëtare. Organ i përshtatshëm për të përfaqësuar Shqipërinë do të ishte Ministria e Punëve të Jashtme e cila do të bënte hapat e duhura për rinjohjen e Shqipërisë si shtet i pavarur në radhën e shteteve të tjera.

Më 5 nëntor 1943 u krijua qeveria me Kryeministër Rexhep Mitrovicën. Posti i Ministrit të Punëve të Jashtme iu ngarkua Z. Mehmet Konica ndërsa posti i Nënministrit të Punëve të Jashtme z. Vehbi Frashëri. Z. Mehmet Konica nuk mori pjesë në betimin e kabinetit të ri qeveritar dhe nuk e ushtroi këtë detyrë deri në 6 shkurt 1944 ku Ministër i Punëve të Jashtme emërohet z. Bahri Omari. Gjatë kësaj kohe z. Rexhep Mitrovica, Kryetari i Kabinetit Qeveritar ushtroi edhe detyrën e Ministrit të Punëve të Jashtme. Më 17 korrik posti i Ministrit të Jashtme i kaloi z. Ekrem Vlora.

Pas çlirimit të vendit, Qeveria Demokratike e Përkohshme punoi për krijimin dhe konsolidimin e institucioneve të saj si dhe për njohjen e saj nga ndërkombëtarët.

Në strukturën e MPJ-së në dhjetor 1944 u krijua Sekretaria.

Aleatët e mëdhenj antifashistë ngarkuan Qeverinë Demokratike të Përkohshme si forcë politike për të organizuar zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese. Asambleja Kushtetuese e dalë nga zgjedhjet e 2 dhjetorit 1945 shpalli Shqipërinë Republikë Popullore dhe zgjodhi qeverinë e re të kryesuar nga Enver Hoxha. Ky i fundit mori edhe funksionet e Ministrit të Punëve të Jashtme. Dr. Omer Nishani shkarkohet nga detyra e Ministrit të Punëve të Jashtme më 9 shkurt 1946 pasi u zgjodh nga Asambleja Kushtetuese si Kryetar i Presidiumit të saj.

Jugosllavia ishte shteti i pare që njohu qeverinë e re në maj 1945 dhe në korrik u hap legata shqiptare në Beograd. Më pas vazhduan vendet e tjera të Evropës Lindore dhe Franca.

Në mars 1946 në strukturën e MPJ u krijua Ekonomati, një muaj më pas në prill 1946 u krijua Zyra e Shtypit dhe u hap Legata në Moskë. Në qershor 1946 Drejtoria e Protokollit kthehet në Shërbim Protokollit. Po në qershor 1946 hapet legata në Sofie dhe në korrik 1946 u hap legata në Paris.

Zyrat vareshin nga Sekretari i Përgjithshëm. Drejtoritë vareshin nga Drejtorët ndërsa Sekretari i Përgjithshëm koordinonte punën ndërmjet tyre dhe ka përgjegjësinë e administrimit të të gjithë dikasterit nën drejtimin e Ministrit.

Për vitet 1945-1946 vazhdoi sistemi i vjetër i emërtesave me gradë dhe jo me pozicion pune.

Në mars 1946, MPJ bëri një deklaratë zyrtare se ai dikaster nuk njihete asnjë përfaqësi shqiptare jashtë qoftë diplomatike apo konsullore, përveç atyre të qeverisë së RP të Shqipërisë.

Organika e parë e plotë dhe e përgatitur në përputhje me hapësirat dhe orientimet e politikës së jashtme shqiptare të asaj kohe konsiderohet ajo e vitit 1947, vit kur edhe sistemi politik i shtetit monist u instalua plotësisht. U aprovua e para Rregullore mbi Organizimin e MPJ të RP të Shqipërisë, e cila u miratua nga Këshilli i Ministrave më 7 korrik 1947.

Me kalimin e viteve, edhe struktura e MPJ-së pësoi ndryshime, bëhet më e përqendruar politikisht dhe më e përshtatur ndaj politikave të brendshme dhe të jashtme të sistemit komunist.

Në vitin 1948 u krijua edhe Biblioteka e MPJ-së si pjesë e Degës së Studimeve. Që nga viti 1950 sistemi i gradave diplomatike i trashëguar nga shteti shqiptar i paraluftës nuk figuronte më, që do të thoshte që punonjësit e MPJ-së paguheshin sipas punës që bënin dhe jo sipas gradës së tyre

diplomatike. Kjo i dha një goditje të rëndë ngritjes së një shërbimi të jashtëm profesional mbi bazën e karrierës diplomatike.

Në vitin 1950, për herë të parë u shfaq pozicioni i Këshilltarit Juridik pranë Ministrisë të Punëve të Jashtme.

Duke demonstruar ndarjen e madhe Lindje-Perëndim në marrëdhëniet Ndërkombëtare në kuadrin e Luftës së Ftohtë, në vitin 1951 Drejtoria Politike u nda në:

- Dega I Politike që përfshinte vendet e kampit socialist të lindjes, dhe
- Dega II Politike që përfshinte vendet kapitaliste perëndimore, ku pas zhvillimeve të vitit 1948, bënë pjesë edhe Jugosllavia. Në këtë degë përfshiheshin edhe vendet e Lindjes së Afërt.
- U krijua edhe Dega e Organizatave Ndërkombëtare
- Në vitin 1954, doli më vete Seksioni Sekret dhe Arkiva.

Në vitet '70-të kishte 4 drejtori politike që mbulonin rajone të ndryshme gjeografike. Në këto vite në strukturën e MPJ-së u formua edhe Komiteti i Marrëdhënieve Kulturore me Botën e Jashtme, nga ku varej edhe Redaksia e Revistës dhe gazetës “Shqipëria e Re” si pjesë e propagandës së sistemit. Kjo shtonte karakterin politik të institucionit.

Në vitin 1985 u krijua Byroja Juridike, si pjesë e strukturës së MPJ-së që deri në këtë vit përfaqësohej vetëm nga një jurist. Tani degët u kthyen në drejtori dhe seksionet në degë. MPJ kishte 7 drejtori dhe 5 degë, 2 sektorë dhe Byronë Juridike në përbërjen e vet.

Në vitin 1982 u krijua edhe Instituti për Studimin e Marrëdhënieve të Sotme Ndërkombëtare me një organike me 25 veta e në varësi të Ministrisë të Punëve të Jashtme. Në vitin 1989, organika e aparatit të MPJ-së kishte 123 punonjës.

Duke analizuar gjendjen politike të Shqipërisë që pas periudhës së komunizmit e këtëj dhe duke paraparë strategjitë që ka luajtur në sferat gjithpërfshirëse politike, mund të konstatojmë se politika e jashtme e Shqipërisë është në tranzicion. Sipas autorit Lisen Bashkurti në librin e tij, *Diplomacia shqiptare ndërmjet të kaluarës dhe të ardhmes*, trajton problematikat e diplomacisë shqiptare në një kontekst bashkohor, sipas këndvështrimit të tij, vonesa e integritit të popujve të Ballkanit, në vëçanti të Shqipërisë në rrjedhat evropiane, ka shkaqe të thella historike, politike

dhe ekonomike. Gjate faqeve që vijojnë, do të kemi mundësin të konstatojmë se kishte të drejtë, sepse ishin pikërisht ngjarjet historike, mosfunksionimi I politikës së brendshme dhe kriza ekonomike faktorët kryesorë që ngadalsuan procesin e antarsimit të Shqipërisë në sferat ndërkombëtare. Transformimi i Shqipërisë pas rënies së komunizmit u mbështet gjerësisht të politika e jashtme. Në fakt, ka pasur një vizion strategjik për ta nxjerrë vendin nga një izolim ekstrem dhe për të ndihmuar rindërtimin e shtetit dhe të ekonomisë. Me një orientim pro-perëndimor të palëkundur, vendi u anëtarësua në NATO dhe bëri hapa të rëndësishme në procesin e integritit evropian. Në nivelin rajonal, administrata e re shpalli si prioritete *zero probleme me fqinjët*. Kjo ishte thjesht një tezë e pavend për rastin e Shqipërisë sepse në mënyrë paradoksale, Shqipëria ka probleme pothuajse me çdo fqinj, ndërsa në nivelin ndërkombëtar mungon realizmi dhe modestia. Her pas here, Shqipëria, një mikro shtet, sillet si një gjigant në punët e jashtme. Kjo ishte thjesht një tezë e pavend për rastin e Shqipërisë sepse në mënyrë paradoksale, Shqipëria ka probleme pothuajse me çdo fqinj, ndërsa në nivelin ndërkombëtar mungon realizmi dhe modestia. Her pas here, Shqipëria, një mikro shtet, sillet si një gjigant në punët e jashtme. Ndoshta kjo vin nga trashëgimia komuniste, nga marrëdhënjet kryesisht asimetrike (me fuqitë e mëdha apo superfuqitë), kur Shqipëria komuniste sillej si qendra e botës. Në traditën e marrëdhënjeve të mbi 20 viteve të fundit të Shqipërisë me shtetet e jashtme, zakonisht si partner strategjik të saj janë konsideruar Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Italia dhe Greqia. Qeveria e re shqiptare, listës së këtyre vendeve u shtoi edhe Bashkimin Evropian dhe Turqinë.

Synimi nuk është të nënvizohen përparësitë në marrëdhëniet me disa vende e për të lënë në hije ato me shtetet e tjera, shqetësimi është si të zhvillohet sa më tepër mirëkuptimi e bashkëpunimi me fqinjët, si të tejkalohen e të zgjidhen mosmarrëveshjet, kontestimet e grindjet e së kaluarës për të arritur nëse do të ishte e mundur në atë dëshirë e synim të shprehur nga qeveria e re shqiptare, në “zero probleme në marrëdhënie me fqinjët”. Raporti fqinjësor ndërmjet shtetit Shqiptar dhe Italian dallonte shumë nga bashkëpunimi I Shqipërisë me shtetet tjera, sepse u bë shumë-dimënsional dhe shumëplanësh. Mbështetja italiane u bë prezente pothuaj në të gjitha fushat e Shqipërisë, duke rikonfirmuar faktin se Italia ishte donatori dypalësh kryesor i vendit, si në aspektin e financimeve, ashtu edhe në gjërësinë e spektrit të ndërhyrjeve. Ky intensifikim u evidentua më tej në aspektin e takimeve të ndërsjellta në nivele të larta dhe shumë të larta, por edhe në kontaktet e shpeshta në nivele të tjera, duke

bërë që marrëdhëniet midis dy vendeve të marrin përmbajtje më konkrete dhe më efektive. Aktualisht në opinionin publik shqiptar, pas konsensusit thuajse unanim për konsiderimin e SHBA si partner i parë strategjik i Shqipërisë, vendi që gjen më tepër miratim për këtë status është Italia. Në shkurt 2010 midis të dy vendeve është nënshkruar Deklarata e Partneritetit Strategjik, dokument që simbolizon nivelin e lartë të marrëdhënieve të gjithanshme midis dy shteteve. Pas vitit 1990 Italia ka qenë mbështetëse e fuqishme për stabilizimin dhe demokratizimin e Shqipërisë, për kapërcimin e krizave të rënda, politike, ekonomike e sociale të saj. Qeveritë italiane e kanë përkrahur që në fillim e në vijimësi aspiratën e shqiptarëve për integrimin euroatlantik. Italia ndihmoi nga afër në hapat e parë e të ndrojtur të Shqipërisë në rrugën jo të lehtë të përmbushjes graduale, plot dhimbje, me kthesa e me ngecje të standardeve të BE, për të ardhur në propozimin e Komisionit Europian të para disa ditëve për t'i dhënë asaj statusin e vendit kandidat. Shqipëria ka ambicien legjitime që të vazhdojë më tej, të hapë edhe negociatat vitin e ardhshëm për anëtarësimin e plotë në familjen e madhe europiane. Qeveria e re shqiptare ka shprehur vullnetin për të ecur në traditën më të mirë të këtyre marrëdhënieve e t'u japë atyre dimensione më të gjëra e më të shumanshme, në bashkëpunimin e ngushtë politik, në thellimin e kooperimit ekonomik përmes shtimit të investimeve e tërheqjes së investitorëve të mëdhenj italianë, zgjerimit të mëtejshëm të tregtisë, të lidhjeve kulturore, arsimore e shkencore. Më 14 janar 2011, Shqipëria nënshkroi një marrëveshje me Italinë për një strategji të jashtme të përbashkët. Për të pasqyruar një dimension të ri të diplomacisë shqiptare, atë të diplomacisë ekonomike dhe kulturore, u krijua Drejtoria e Promovimit Ekonomik dhe Kulturor. Në strukturën e re u shkri Drejtoria e Përgjithshme Rajonale dhe u krijua Drejtoria e Marrëdhënieve me Vendet fqinjë, e përbërë nga Sektori i Kosovës, Sektori i Marrëdhënieve me Ballkanin Perëndimor dhe Sektori i Marrëdhënieve me Italinë, Greqinë dhe Turqinë. U shkri gjithashtu Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve si dhe Drejtoria e Arkiv-Dokumentacionit dhe u krijua Drejtoria e Personelit dhe Arkiv-Dokumentacionit dhe Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve. Për një koordinim më të mirë të punëve dhe shkëmbim të informacionit ndërmjet MPJ dhe përfaqësive dhe midis vetë përfaqësive, në MPJ u krijua Njësia e Ndërlidhjes, Koordinimit të Përfaqësive dhe Sekretaria Qendrore.

Kjo mënyrë organizimi strukturor vazhdoi deri në qershor 2008. Në përputhje me dinamizmin e politikës së jashtme shqiptare, struktura e MPJ ka pësuar disa ndryshime.

Në funksion të një ndjekie më të mirë të problemeve të integritit euro-atlantik të vendit, u krijua Drejtoria e Përgjithshme e Integritit Euroatlantik dhe Marrëdhënieve Shumëpalëshe.

Duke i dhënë prioritet dimensionit rajonal të diplomacisë shqiptare u ri-krijua Drejtoria e Përgjithshme Rajonale, por me një organizim tjetër. Ajo përbëhej nga Drejtoria e Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, Drejtoria e Italisë, Greqisë dhe Turqisë (Malta e Qipro), Drejtoria e Europës Juglindore (Serbi, Bosnjë-Hercegovinë, Kroaci, Bullgari, Rumani, Slloveni), Drejtoria e Nismave Rajonale.

Po në këtë strukturë u krijua edhe Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Imazhit, Diplomacisë Publike dhe Diasporës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse.

Integrimi evropian i Shqipërisë konsiderohet objektiv strategjik, dhe garanci për paqen, stabilitetin dhe prosperitetin në rajon e më gjerë. Shqipëria mbështet fuqimisht politikën e jashtme të sigurisë dhe mbrojtjes së BE-së, e cila synon forcimin e rolit të Bashkimit Evropian si një entitet me influencë politike gjithnjë në rritje në politikën ndërkombëtare. Shqipëria, ka një dialog politik të ngushtë me Bashkimin Evropian dhe vendet anëtare të tij, dialog i cili me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (MSA), zhvillohet në kuadër të kësaj Marrëveshjeje në Këshillin e Stabilizim Asociimit dhe strukturave të tjera të përbashkëta. Objektiv i strategjik i Shqipërisë është që përmes një angazhimi aktiv në të gjitha forumet dhe nismat rajonale të kontribuojë me qëndrimet parimore e të balancuara në trajtimin e çështjeve të ndryshme sensitive të rajonit. Nëpërmjet aktivitetit të saj në këto forume rajonale, Shqipëria synon që të nxisë zhvillimin ekonomik rajonal nëpërmjet projekteve të përbashkëta, në fusha të tilla si energjia dhe transporti.

Shteti shqiptar synon forcimin e bashkëpunimit me organizatat ndërkombëtare, ku ajo është palë, dhe pjesëmarrjen aktive të saj në veprimtaritë e tyre në fushat që ato mbulojnë. Në këtë kuadër, qeveria shqiptare ka vullnet të plotë për të ndërmarrë të gjitha reformat e duhura në kuadër të procesit të integritit evropian.

Republika e Shqipërisë mbështet fuqimisht politikën e jashtme, sigurisë dhe mbrojtjes së BE-së, e cila synon forcimin e rolit të Bashkimit Evropian në politikën ndërkombëtare. Në kuadër të procesit të anëtarësimit, Shqipëria përafron politikën e saj të jashtme me atë të Bashkimit Evropian. Shqipëria zbaton masa shtrënguese të ndërmarra nga BE drejt vendeve të treta. Të



gjitha qëndrimet, të cilave vendi ynë u bashkohet, sipas Kushtetutës bëhen pjesë e legjislacionit të brendshëm dhe janë të zbatueshme për të gjitha institucionet.

Qëllimi kryesor i kësaj fushë është përafrimi i politikës së jashtme dhe sigurisë të Shqipërisë me atë të Bashkimit Evropian. Republika e Shqipërisë ka vullnet të plotë për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme institucionale dhe organizative për të qenë në gjendje, që me aderimin e saj në BE të marrë pjesë aktive dhe të plotë në CFSP/CSDP.

Duke iu referuar në veçanti dimensionit ushtarak, Republika e Shqipërisë i bashkohet përpjekjeve të BE-së për rritjen e kapaciteteve ushtarake dhe krijimin e një bashkëpunimi strukturor permanent në këtë fushë. Republika e Shqipërisë mbështet fuqimisht të gjitha politikat në fushën e CFSP/CSDP të identifikuar në strategjinë e Sigurisë Evropiane, të cilat përkohësisht dhe me objektivat e saj strategjike të sigurisë.

Kur flitet për shpejtësi në rastin e integritimit evropian mjafton të bëhet një krahasim me vendet e tjera të rajonit për të kuptuar që shpejtësia jonë lë shumë për të dëshiruar. Gjithsesi zhvillimet që lidhen me integrimin Euro-Atlantik tanimë nuk mund të konsiderohen më pjesë të politikës së jashtme por të gjithë politikës shqiptare në përgjithësi pasi këto janë procese shumë sektoriale e nuk prekin thjesht ministrinë e jashtme. Roli i ministrisë së jashtme është minimale në këto procese kur këto dy organizata, BE dhe NATO kanë misionet e tyre monitoruese në Shqipëri dhe për integrimin evropian ka madje një ministri të posaçme .

Për të peshuar cilësinë e punës së ministrisë së punëve të jashtme duhet parë trajtimi që iu bëhet qytetarëve shqiptarë jashtë vendit duke patur parasysh në mënyrë të veçantë shërbimin konsullor. Konsullatat shqiptare fatkeqësisht ende mund të konsiderohen si simotra të kalbura të gjendjeve civile të rretheve dhe si zyra punësimi për militantët pasi puna e tyre edhe me qeverinë e re nuk ka shënuar ndonjë përmirësim. Madje emigrantët shqiptarë në Greqi dhe Itali dëshmojnë haptazi që në përpjekjet e tyre për të rinovuar dokumentet më shumë abuzohen dhe nëpërkëmben nga funksionarët e konsullatave shqiptare sesa nga zyrtarët grekë apo italianë. Shtetasit shqiptarë ngelen jetim jashtë vendit ndërkohë që mundësitë për të mbrojtur të drejtat e tyre në vendet pritëse ku ata janë shpesh si emigrant janë shtuar falë mundësive të ofruara nga avancimi në të drejtën ndërkombëtare, në të drejtën evropiane dhe në legjislacionin vendor të vetë vendeve pritëse. Pra edhe pse Shqipëria nuk është shtet i fuqishëm për t'u imponuar, për konsullatat

shqiptare janë shtuar mundësitë dhe hapësirat ligjore për të ndihmuar shtetasit shqiptarë jashtë vendit.

Megjithatë dështimi më i madh i politikës së jashtme shqiptare ka të bëjë me paaftësinë për të eliminuar izolimin e thellë ku na zhyti komunizmi. Një plagë e thellë kjo mjekimi i së cilës meritonte të ishte një ndër prioritetet kryesore të qeverive post-komuniste. Ne vazhdojmë të jemi një ndër vendet më të izoluara në botë pasi shqiptarët mund të hyjnë pa viza vetëm në një numër shumë të kufizuar vendesh të cilët mund të numërohen me gishtat e dorës. Pasaporta shqiptare duhet t'i nënshtrohet vizave për pothuaj çdo vend në botë sikur të vazhdonte sot autarkia enveriste. Shteti shqiptar duke u marrë vetëm me gjënë më joshëse dhe njëherazi më të vështirë, liberalizimin e vizave të BE-së, ka anashkaluar faktin që për pasaportën shqiptare kërkohen viza edhe nga vende shumë të varfra që në përgjithësi nuk vendosin viza për të huajt. Janë të shumta vendet e Afrikës apo Azisë Qendrore apo Juglindore që me pak më shumë përpjekje të ministrisë së jashtme shqiptare, duke patur parasysh pozitën e tanishme ekonomike dhe politike të Shqipërisë, do të pranonin që të hiqnin vizat për shtetasit shqiptarë pa kërkuar parimin e reciprocitetit, pra pa kërkuar që ne t'i heqim për ta. Këtë gjë e kanë bërë tashmë me vende të Evropës Lindore që nuk dallojnë shumë nga ne për sa i përket gjendjes ekonomike apo pozitës gjeostrategjike. Në përpjekje për të zbuluar si mund të marrësh një vizë si shtetas shqiptar mjafton të shohësh faqet zyrtare të internetit të disa vendeve të humbura si Tajlanda, Mongolia apo Nepali për të parë që këto shtete i referohen vendit tonë hera herës ende si republika popullore dhe socialiste e Shqipërisë për të kuptuar që ne ende trashëgojmë pozitën e izoluar enveriste dhe se me këto vende ekziston ai nivel marrëdhëniesh i përcaktuar dekada më parë. Më pak viza do të thotë më shumë dinjitet e vlerë për pasaportën shqiptare, më shumë liri lëvizje për shtetasit shqiptarë, më shumë shkëmbime kulturore, turizëm dhe biznes, më shumë konkurrencë në një treg gjithnjë e më global.

Si pjesë e procesit të përafimit me Bashkimin Evropian do të ishte shumë e arsyeshme që ministria e jashtme të merrej gjithashtu me eliminimin e ndërsjellë të vizave me ato shtete që janë tashmë jashtë listës së zezë të shengenit në të ashtuquajturin Aneks 2 të Shengenit, pra bëhet fjalë për ato kombësi që nuk kanë nevojë për viza shengen për të hyrë në vendet e BE-së. Në këtë mënyrë nuk do na duhej që kur të futeshim në BE në një kohë të dytë t'iu vendosnim këtyre shteteve viza sikurse kërkohet prej kushteve të anëtarësimit që të përdoret e njëjta listë e zezë e

shengenit. Këtu bëhet fjalë për një numër të madh shtetesh të Amerikës Latine si Argjentina, Meksika, Uruguai, Paraguai, Salvadori, Panamaja, Kota Rika, Kili, Brazili, Guatemala, Nikaragua, Venezuela apo shtete të tjera të zhvilluara ekonomikisht si Singapori, Brunei apo Koreja e Jugut. Po kështu do të ishte e arsyeshme që qeveria shqiptare të negocionte me vendet që kanë viza për shtetasit shqiptarë që shërbimet e tyre konsullore që mbulojnë Shqipërinë në pamundësi për tu vendosur në Tiranë të mbahen të paktën në ambasadat e tyre në ato vende ku shtetasit shqiptarë do mund të udhëtonin pa viza si për shembull Ankaraja apo Shkupi. Kështu shpesh ambasadat e huaja që mbulojnë shërbimet konsullore për Shqipërinë gjenden në vende si Roma, Londra apo Bukureshti duke bërë që shtetasit shqiptarë të kenë nevojë për një vizë të dytë që të mund të marrin vizën për destinacionin e tyre të preferuar. Dhe shpesh është më e vështirë për të marrë një vizë italiane për të vajtur në Romë sesa të marrësh vetë vizën braziliane apo argjentinase.

Megjithatë dihet që këto probleme të mprehta që kanë shqiptarët me vizat dhe shërbimet konsullore vështirë se mund të kuptohen nga politikanë që kanë një kohë të gjatë me pasaporta diplomatike e nuk kanë hasur vetë ndonjëherë probleme me vizat, dhe aq me pak mund të kuptohen nga një ministër i jashtëm që zotëron një pasaportë holandeze ndërkohë që ka për detyrë të mbrojë interesat e pasaportës shqiptare. Prandaj me sa duket kalvari i pasaportës shqiptare nëpër sportele ambasadash ka për të vazhduar gjatë.

Orientimi Euro-Atlantik ka qënë, është dhe do të jetë një nga kollonat kryesore të politikës së jashtme të Shqipërisë që në gjenezën e sajë. Sot Shqipëria është anëtare me të drejta të plota në NATO. Marrëdhëniet e ngushta diplomatike me partnerin tonë strategjik, me SHBA dhe me partnerët e tjerë Evropian janë kyçe për zhvillimet e mëtejshme dhe përmirësimin e jetës së Shqiptarëve.

### **3.2. Politika e jashtme e Italisë dhe Marrëdhënjet bilatërale pas anëtarimit të Shqipërisë në NATO**

Në fillim të viteve '90, Italia nuk arriti të njoh në mënyrë të menjëhershme ndryshimet që ndodhën në anën tjetër të Adriatikut. Ministria e Jashtme italiane kishte projektuar një politikë e cila shpesh ishte e paqartë në lidhje me shtetet që sapo kishin dalë nga regjimet komuniste.

Politika e jashtme e Italisë, e cila do të identifikonte objektivat dhe prioritetet kryesore përmes një procesi të gjatë, u formua gradualisht. Përveç rikonfirmimit jo vetëm të lidhjeve formale me Atlantikun dhe Evropën, Italia bëri zgjedhje në lidhje me politikën rajonale, e cila do të përqëndrohej në zonën e Ballkanit.

Pas ardhjes në pushtet të Enver Hoxhës, marrëdhënjet dypalëshe midis dy vendeve fqinjë u keqësuan. Edhe pas rivendosjes së marrëdhënjeve diplomatike midis Romës dhe Tiranës, kontrolli politik, struktura e shoqërisë dhe e ekonomisë shqiptare kishte përjashtuar mundësinë që midis dy brigjeve të Adriatikut të vendoseshin kontakte jashtë kanaleve zyrtare. Pavarësisht përpjekjeve për të rritur këtë nivel marrëdhënesh ai mbeti pothuajse i pandryshuar deri pas rënjes së komunizmit.

Nëse do të përpiqemi që të evidentojmë fazat e angazhimit të Italisë në bashkëpunimin për zhvillimin e Shqipërisë, mund të ndajmë tre faza të karakterizuara me zhvillimin dhe zbatimin e marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit.

Faza e parë ndryshe mund ta quajmë faza e emergjencave të viteve '90, dhe karakterizohet me bashkëpunimin Italian për zhvillimin dhe përballjen e emergjencave humanitare, që ndodhi si pasojë e regjimit komunist në Shqipëri. Faza e dytë është faza e progresit dhe zhvillimit ekonomik ndërsa faza e tretë do ta quajmë si faza e stabilitetit dhe rrugës drejt anëtarimit të Shqipërisë në NATO.

Fundi I regjimit komunist në Shqipëri, përcolli shqetsime me natyr të ndryshme për vendin fqinjë. Një nga problemet e shumta që lindën gjate viteve të para të '90 ishte emigracioni I paligjshëm, kjo si pasojë e krizez së madhe ekonomike edhe si fakt se qytëtarët shqiptar ndiheshin disi më të lidhur me Ialinë sesa me vendet tjera të Evropës Perendimore, por nuk mund të mohojmë se midis dy vendeve kishte jo vetëm lidhje gjeografike por edhe historike.

Këto marrëdhënie kan pasur periudha me “ndërprerje”, ku Italia ka treguar ftohtësi ndaj Shqipërisë edhe pse në periudha kohore jo shumë te gjata, ky distancim ndaj Shqipërisë u thellua më tepër gjatë periudhes së diktaturës komuniste.

Raportet mes dy shteteve përmirësohen dukshëm pas vdekjes së Enver Hoxhës.

Heqja e barrierave kufitare në fund të viteve '80 dhe fillimin e '90 e zbuloj rajonin Ballkanik përpara ndërkombëtarëve. Politika e jashtme e Italisë në Shqipëri nuk lind vetëm nga dëshira për të riformësuar marrëdhënjet, por ky orientim I Italisë ishte pjesë e traditës që ishte ruajtur në forma me ndryshimet e mëdha që kishin ndodhur përgjatë shekujve.

Italia pas përfundimit të luftës së ftohtë përballët me dy kriza të mëdha ajo e vendeve Ballkanike dhe ajo e Lindjes së Mesme, kështu që filloj të shfaq një ambicie në rritje për të marrë rolin e një fuqie të madhe. Ndërkoh gjatë kalimit në sistemin demokratik dhe në ekonominë e tregut, qeveria e Shqipërisë u gjend përballë detyrave qe nuk mund ti trajtonte më vetëm. Për këtë motiv shpresat e qeverisë por edhe e qytëtarëve u drejtuan drejt perendimit. Përshkak të afërsisë gjeografike, vendi I parë I cili dha kontributin e tij për këto transformime të mëdha, ishte Italia.

Interesat ekonomike të Italisë drejt Shqipërisë, ishin një prej elementeve më të rëndësishëm të politikavë të ndërmarra nga Italia, për të cilën vendi fqinië ishte një mundësi për të zhvilluar bizneset. Zhvillimi ekonomik dhe hapja e mundësive të reja për prodhimin Italian, ishin të lidhura direct me seriozitetin institucional të vendit. Italisë I duhej të ndërmernte një veprim strategjik për të forcuar institucionet, vecanarisht në fushat e qeverisjes ekonomike, funksionimin e drejtësisë dhe luftën kundër korrupsionit.

Për këto arsye, Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë dhe Ministria e Tregëtisë, kan shfaqur orientime të diskutueshme. Fillimisht kanë ndjekur një politik asistence, dhe më vonë janë orientuar me programe koordinimi dhe mbështetje kombëtare për ndërkombëtarizimin e ndërmarjeve italiane në Shqipëri.

Politika e jashtme e Italisë në rajon dhe me theks të vacant në Shqipëri është e lidhur ngushtë me atë të integritit evropian, politik, ekonomik dhe social. Mund të themi se Shqipëria përmbledh të gjitha ato elemente që e bëjnë vendin të ketë përparësi në sytë e shtetit Italian, nën dy drejtime, atë politik dhe ekonomik.

Rënja e sistemit komunist solli në Shqipëri ndryshime të mëdha, në sferen politike dhe ekonomike. Në këtë kontekst Italia ka luajtur një rol shumë të rëndësishëm.

Pavarësisht ngadalësimit të marrëdhënjeve midis dy vendeve gjat regjimit komunist, Shqipëria menjëherë pas ndryshimeve politike u përfshi në rafshin e politikës së jashtme italiane. Intensifikimi i marrëdhënjeve Italo-Shqiptare është rezultat i procesit të ndryshimeve të prioriteteve të politikës së jashtme italiane, të nisur prej fillimit të viteve '90 dhe është ende në vazhdim.

Në 12 gusht 1991 u nënshkrua marrëveshja për mbrojtjen e investimeve ndërmjet Qeverisë Italiane dhe Qeverisë Shqiptare, edhe pse marrëveshja hyri në fuqi në vitin 1996. Në bazë të marrëveshjes të nënshkruar, Italia u angazhua për të siguruar ndihmë ekonomike nga shtatori deri me 31 dhjetor të vitit 1991. Përveç ndihmës ekonomike, prioritet i Politikës së Jashtme Italiane ishte që të gjej një strategji politike për të menaxhuar konkretisht rastin emergjent të refugjatëve shqiptar në brigjet italiane.

Organizatat joqeveritare italiane filluan të ushtrijn aktivitetin e tyre kur filloj procesi i transformimit institucional në Shqipëri. Çështja e emigracionit të paligjshëm dhe e numrit të madh të qytetarëve shiptar që i shtoheshin Italisë, ishte object i takimeve të përfaqësuesve të lartë të të dy vendeve. Këtë e vërejmë edhe gjatë takimit që pati Kryeministri Italian Gianni De Michelis me Kryeministrin shqiptar Ylli Bufi më datë 13 qershor 1991. Orientimi i De Michelis ishte i dyzuar, ai premtoi marrjen e masave konkrete për të ndaluar këtë fenomen, ndërsa nga ana tjetër qëndrimi që mbajti për shqiptarët që kishin hyrë në territorin Italian, ishte shpresëplotë, ai premtoi jo vetëm ndihmë financiare por edhe mundësi punësimi.<sup>69</sup>

Si konsekuencë të kësaj situatë jo komode për shtetin Italian, në vitin 1991, dy shtetet bënë marrëveshjen për liberalizimin e vizave, fillimisht për pasaportat e atyre që ishin pjesë e shërbimit diplomatik. Mirëpo këto manovra nuk ishin të mjaftueshme, sepse përshkak të veshtirësive në politikën e brendshme italiane nuk përcaktohet një projekt strategjik afatgjatë dhe

---

<sup>69</sup> Ylli Bufi, *Vitet e tranzicionit. Qeveria e stabilitetit njw marrëveshje politike apo njw kompromis i heshtur*, Shtwipia botuese Uet Press, Tiranw 2016, fq 93

në mënyrë të menjëhershme. Si pasojë e kësaj gjendjeje emergjence u pa e nevojshme një qasje me radikale e Italisë ndaj problemit e cila u konkretizua me Operacionin Pelican.<sup>70</sup>

Qeveria italiane frikësohej se i njëjti fenomen do të ripërsëritej por këtë radhë nga brigjet e Jugosllavisë dhe në këto kushte qeveria italiane duhej të merte masa ma konkrete për të përballuar situatën.

Më 28 shkurt të vitit 1990 Parlamenti Italian miratoi projektligjin e datës 30 dhjetor 1998 n. 416, ky ligj i njohur ndryshe si "ligji Martelli".<sup>71</sup> Ky ligj regullon emigracionin dhe azilin, por nuk parashikonte një mbrojtje të veçantë, më përjashtim të personave që përndiqeshin për arsye politike, për shkak të racës, së fesë, etj siç parashikonte edhe Konventa e Gjinevrës.

Megjithatë fluksi emigrator nuk kishte të ndalur sepse populli shqiptar gjendej në një situatë ekonomike dhe politike të pashpresë.

Për këtë arsye u pa e nevojshme edhe ndërhyrja e shteteve të treat në ndihmë të Italisë, si vend anëtar i Komunitetit Evropian. Qeveria italiane filloj të ndryshoj qëndrimin e saj dhe ndërmori politik të ashpër kundër emigranteve, filloj kështu manovra e riatdhesimit që vinte Italinë në një pozit kontradiktorë.

Qeveria Italiane vendosi një politikë të bazuar në katër pika kryesore:

1. përfshirja e Komunitetit Evropian për zgjedhjen e krizës shqiptare
2. dërgesa të reja të menjëhershme për ndihma ushqimore në Shqipëri
3. riatdhesimi i menjëhershëm i refugjatëve
4. kontrolli i ngushtë të bregdetit

E njëjta situatë u përsërit përgjat vitit 1997, Shqipëria pesoi një krizë të madhe ekonomike përshkak të falimentimit të firmave piramidale që shkaktoj humbjen e të ardhurave të 70% të familjeve shqiptare. Kjo situatë kaosi shkaktoj një fluks të madh emigrantësh drejt gadishullit italik. Për të ndaluar sërisht fenomenin migrator Qeveria italiane ndërmori nisma dypalëshe. U intensifikua bashkëpunimi midis policisë shqiptare dhe asaj italiane, për të parandaluar aktivitete kriminale, vecanarisht ato në fushën e emigracionit të paligjshëm, poashtu ndalimi në ujërat territoriale të shqipërisë të anijeve që kryejnë transportin e shtetasve shqiptar. Megjithatë edhe pas

---

<sup>70</sup> Operacioni Pelikan filloi me 1 shtator 1991 dhe përfundoi me 20 shtator të vitit 1992. Pelikani ishte një mision humanitar, i projektuar për të ofruar ndihmë për popullsinë shqiptare. Italia dërgoi një kontingjent ushtarak mbi bazën e një memorandumit bashkëpunimi të nënshkruar midis Qeverisë italiane dhe asaj shqiptare.

<sup>71</sup> Ligji Martelli, mori fuqinë e ligjit në 28 shkurt 1990 dhe regullonte situatën e emigracionit klandestin dhe statusin e refugjatit.

stabilizimit të situatës politike në Shqipëri fluksi emigrator nuk kishte të ndalur deri në fund të viteve '90.

Siç cekëm më lart, faktori kyç që e solli Shqipërinë në gjendjen kaotike dhe pa shpresë ishte mbi të gjitha kriza ekonomike. Shteti italian u përpoq të gjej një zgjidhje të mundshme për krizën e brendshme dhe ekonomike të shtetit fqinjë, edhe për ta parandaluar emigrimin emorrargjik të viteve '90.

Sipas analistëve ndërkombëtare, pushteti i ri shqipëtar, i cili u deklarua për kalimin në demokraci dhe në ekonominë e tregut, arriti me sukses të bëjë hapa konkrete, vetëm në drejtim të një privatizimi dhe një politike liberale, por u zvarrit në proceset transformuese.

Në mbledhjen e parë të Komisionit të Përbashkët për bashkëpunim italo-shqiptarë, të kryesuar nga ministritë e punëve të jashtme të të dyja vendeve u pa i nevojshëm formimi i një programi më të plotësuar bashkëpunimi.<sup>72</sup>

Në proces verbalin e mbledhjes së Komisionit Dypalësh të mbajtur në Romë, delegatët e dy vendeve ranë dakord për një Plan Zhvillimor tre vjeçar (1992-1995) me qëllim kalimin nga ndihma emergjente në "ndërrhyrje për nxitjen e një zhvillimi ekonomik të pavarur të bazuar në ekonominë e tregut të lirë."<sup>73</sup> Ky program përfshinte iniciativë zhvillimore kryesisht në infrastrukturë, bujqësi, ndërtim, zhvillim institucional me një vlerë të përgjithshme prej 218,5 milion lira.

Gjatë dy vjetorit 1996-1998, Qeveria Prodi dhe më konkretisht Ministri i Punëve të Jashtme, Lamberto Dini, nisi një sërë iniciativash që synonin ta bonin Italinë, partnerin e përzgjedhur të rajonit të Ballkanit dhe sponzorin kryesor i tyre në Evropë. Gjatë kësaj periudhe Italia kishte si prioritet të Politikës së Jashtme të saj, rikthimin e Stabilitetit në Shqipëri.

Politika e Jashtme italiane ka luajtur një rol të rëndësishëm në vendet e Ballkanit Perëndimor, duke dhënë kontributin e saj në ndërmarjen e iniciativës së aktorëve ndërkombëtar dhe Bashkimit Evropian. Ndër marrëdhënjet më të rëndësishme dallon Pakti i Stabilitetit për Evropën Lindore i vitit 1999, i cili thekson nevojën për të arritur një bashkëpunim të ndërsjellë në nivel bilateral dhe rajonal midis Italisë dhe Shqipërisë, për të siguruar marrëdhënie positive midis vendeve fqinje dhe koordinimit të planeve dhe programeve për mbështetje financiare.

---

<sup>72</sup> Mbledhja e përbashkët Italo-Shqiptare është mbajtur në Romë më 17-18 nëntor 1992

<sup>73</sup> Processo verbale della Grande Commissione Mista per la cooperazione italo-albanese, Roma 17-18 Nov.1992



Sipas Institutit Italian të Statistikave (INSTAT) që prej vitit 1996, numri I ndërmarrjeve italiane në Shqipëri ka qenë gjithmonë në rritje, me përjashtim të vitit 1997, kjo si shkak I krizës së shkaktuar nga falimentimi I firmave piramidale. Gjatë përmirësimit të marrëdhënjeve midis dy vendeve, disa sipërmarrës Italian të shtyrë nga kostoja e ulët e punës, vendosen të themelonin shoqëritë e tyre në Shqipëri. Ne vitin 1996 në Shqipëri operonin 500 sipërmarrës Italian të cilët përbënin 68% të investimeve të huaja në Shqipëri.

Gjatë fillimit të viteve 2000, Italia mbetet partneri I parë tregtar I Shqipërisë pasi ajo tërheq rreth 75% të eksporteve shqiptare, ndërsa 30% e importeve përbëhet nga mallra Italiane, dhe bilansi tregëtar vazhdon të jetë aktiv në favor të Italisë: në vitin 2002, importet italiane nga Shqipëria arritën në 339 milion euro, ndërsa eksportet në 584 milion euro.

Zhvillimi I marrëdhënjeve dypalëshe, forcon më tepër qasjen shumëpalëshe të politikës italiane në rajon, e cila sheh anëtarësimin e vendeve të Ballkanit, ne veqanti te Shqipërisë në Bashkimin European si factor përcaktues për stabilizimin e tyre.

Në zhvillimin e stabilitetit politik dhe ekonomik të Shqipërisë post komuniste, nuk mund të anashkalojmë rëndësinë e pakontesueshme të aktiviteteve cooperative italiane në vend.

Për shkak të destabilitetit politik, ekonomik dhe social të viteve '90 në Shqipëri, kooperacioni Italian është ndarë në disa faza dhe vazhdon të jetë ende present. Projektet për zhvillim arrijn vlerën prej 300 milion euro, fakt ky që e bën Italinë të njihet si një nga donatorët kryesorë në vend.

Bazuar në fjalimin e Ministrit Lamberto Dini në Komisionin e përbashkët Italo-Shqiptar të vitit 2002, mund të konkludojmë së ekonomia shqiptare ka pësuar rritje progressive duke bërë hapa drejt stabilizimit makroekonomik.<sup>74</sup>

Sektorët kryesorë të projekteve të finansuara nga kooperacioni Italian jane bujqësia dhe zhvillimi rural, shëndetsia, transporti dhe infrastruktura, mbështetja e shtresave të dobta dhe promovimi I modelit të ndërmarrjes sociale. Këto projekte kan si qëllim kryesore përmirësimin e kushteve të jetesës ne Shqipëri. Situata emergjente e viteve '90 detyroi Italinë për angazhim financiar në Shqipëri në më shumë se 700 milion euro. Këto financa I drejtoheshin mbështetjes dhe modernizimit të infrastrukturës publike, promovimin e demokratizimit, forcimit dhe ndërtimit të

---

<sup>74</sup> Komisioni I pwrbashkwt wshtw mbajtur mw 2-3 Korrik tw vitit 2000.

kapaciteteve institucionale, rritjen dhe qëndrueshmërinë ekonomiko-sociale, dhe më të rëndësishmen promovimin e iniciativave drejt Bashkimit European.<sup>75</sup>

Italia është partneri kryesor tregtar me numrin më të madh të ndërmarrjeve të përbashkëta dhe kompanive italiane në Shqipëri, të përfaqësuar kryesisht nga ndërmarrjet të vogla dhe të mesme. Bashkëpunimi Italian përmes Programit Italo-Shiptar për Zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, lehtëson qasjen në sistemin e kredive.<sup>76</sup>

Në kuadër të këtij bashkëpunimi qeveritë kanë rënë dakord për një Protokol të ri për Bashkëpunim për Zhvillim për periudhën 2014-2016, Protokoli synonte krijimin e një pasurie dhe mirqenje më të madhe për Shqipërinë. Qëndrueshmëria e dialogut midis dy vendeve është bërë gjithmon më efikase me anë të marrëdhëneve të thella bilaterale në sektor dhe fusha të ndryshme. Për të argumentuar më tepër bashkëpunimin dypalësh, po I baskangjis disa nga shumë marrëveshje bilaterale qe datojnë nga viti 1991 e këtej.

- Marrëveshja për heqjen e vizave për Pasaportat e Shërbimit dhe Diplomatike. (1991)
- Marrëveshja për Luftën kundër Krimin të Organizuar dhe Drogës (1991)
- Marrëveshja për Mbrojtjen dhe Nxitjen e Investimeve (1991)
- Marrëveshja për Bashkëpunimin Ekonomik Industrial dhe Tregtar (1992)
- Marrëveshja për Transportin Detar- Ajror (1994)
- Marrëveshja për Bashkëpunimin Kulturor (1994)
- Marrëveshja për Bashkëpunimin Ushtarak (1995)
- Marrëveshja midis Arkivave të Shqipërisë dhe Italisë (2000).
- Marrëveshja për Bashkëpunim ne Fushën e Turizmit ( 2004)
- Marrëveshja për financimin prej 25 milionë euro të një projekti në mbështetje të sipërmarrjeve të mesme e të vogla, në kuadër të programit të Kooperacionit për Zhvillim të Ministrisë së Punëve të Jashtme italiane, 27.10.2008;
- Marrëveshja për konvertimin dhe njohjen reciproke të patentave, 27.10.2008 (ratifikuar dhe hyrë në fuqi më 15.08.2009);
- Marrëveshja për integrimin e sistemeve të prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike dhe të gazit natyror (mars 2009);

---

<sup>75</sup> <http://www.cooperazioneallosviluppo.esteri.it>

<sup>76</sup> <http://prodhuesit.org/?p=3485>

• Marrëveshja e Bashkëpunimit mes Postave shqiptare dhe Postave italiane ( shtator 2009).<sup>77</sup>

Mund të konstatojmë se që nga periudha post komuniste e deri me ditët e sotme, përmes prezencës të një numër të madh të programeve bashkëpunimi, Italia ka mbështetur Shqipërinë drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik-social duke vënë bazën për rrugëtimin e saj drejt Bashkimit Evropian.

Në vazhdimi do të përqendrohemi tek dy etapat shumë të rëndësishme të bashkëpunimit italo-shqiptarë: mbështetjen e Italisë për prospektivën evropiane të Shqipërisë, dhe marrëdhëniet në mes dy shteteve pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.

Kontaktet e para të Shqipërisë me institucionet ndërkombëtare, konkretisht me Komitetin Evropian pas rënies të regjimit komunist, kishin për qëllim ndryshimin e linjave të saj politike dhe orientimin e Shqipërisë drejt perëndimit. Gjatë kësaj periudhe, klasa politike shqiptare kishte si objektiv primar integrimin e Shqipërisë në strukturat e BE-së. Shqipëria e viteve '90, si shumë vende tjera të rajonit e shihte demokratizimin e vendit, kalimin nga një ekonomi e centralizuar në ekonomi tregu dhe reformimin e institucioneve të vendit me përpjekjet për tu antarësuar në Bashkimin Evropian. Për gjatë gjithë kësaj periudhe Italia u paraqit si partner kryesor i qeverive shqiptare, duke dhënë kontributin e saj për stabilizimin e institucioneve, ekonomisë së tregut e tjetër. Për të dëshmuar këtë lidhje, dhe për të sanksionuar gati 20 vite bashkëpunimi dhe takime bilaterale, më 12 shkurt 2010 në Romë u nënshkrua “ Deklarata për themelimin e një partneriteti strategjik “ midis dy vendeve.<sup>78</sup>

Kjo marrëveshje fokusohej në shtatë aspekte të rëndësishme të bashkëpunimit mes Italisë dhe Shqipërisë, dhe pika kyçe i referohej mbështetjes që Italia i ka dhënë Shqipërisë për procesin e integritimit evropian, antarsimi në NATO në vitin 2009, dhe liberalizimin e vizave në dhjetor 2010.<sup>79</sup>

Vizitat zyrtare gjatë dekadës së fundit dëshmojnë mbështetjen e Italisë për shtetin Shqiptar.

Diplomacia Italiane vazhdon të jetë e përqendruar në procesin e konvergencës të Bashkimit Evropian kundrejt gjithë rajonit në veçanti të Shqipërisë.

Këtë lini të qendrimit që mban Italia mund ta vërejmë edhe gjatë një takimi të mbajtur, më 15 Shtator 2015, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Shqipërisë midis Ministrit të Punëve të

---

<sup>77</sup> <http://www.ambasadat.gov.al/italy/sq/marr%C3%ABveshje-dypal%C3%ABshe-nga-viti-1991>

<sup>78</sup> <http://www.ambtirana.esteri.it>

<sup>79</sup> <http://www.ambtirana.esteri.it>

Jashtme të Republikës Italiane, Paolo Gentiloni dhe Homologut të tij, Dimitri Bushati. Gjatë konferencës Ministri u shpreh se: “Italia është angazhuar për të dhënë ndihmesë e për të kontribuar sa më shumë që të jetë e mundur një ecuri positive, dhe nëse është e mundur në përshpejtimin e rrugëtimit të çeljes së negociatave për sa I përket antarsimit të Shqipërisë në BE.”<sup>80</sup>

Në raportet për vitin 2014-2015 Komisioni ka paraqitur konkluzione për Shqipërinë, sipas të cilave Shqipëria ka shënuar progres dhe janë ndërmarë hapa në drejtim të reformës dhe gjyqsorit, qeveria ka treguar poashtu vullnet për të vepruar në parandalimin e luftës kundër korupcionit. Korniza legislative është forcuar dhe politikat në nivel qendrorë janë përmirësuar, ndërkohë që ka pasur ende fusha ku vendi duhet të bëjë përpjekje për të bërë ndryshimet e pritshme pa të cilat rrugëtimi evropian do të jetë I pamundur. Dialogu politik dhe ekonomik ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë ka vazhduar nëpërmjet strukturave përkatëse në kuadër të marrëveshjes së Stabilizim Asociimit (MSA). Shqipëria duhet të angazhohet në reformat lidhura ngushtë me pesë kushtet kryesore të domosdoshme për hapjen e negociatave për antarësim.

---

<sup>80</sup> <http://www.punetejashtme.gov.al/al/zyra-e-shtypit>

### **3.3. Politika e jashtme shqiptaro-italiane nga epoka e Skënderbeut deri në shekullin XXI**

Politikën e Jashtme të Skënderbeut mund ta definojmë si një politikë të aleancave. Me krijimin me sukses të shtetit të Arbërit fillojnë hapat e parë të veprimit në politikën e jashtme. Statusi i banorëve, flamuri dhe administrata shtetërore ndryshojnë. Me këtë ndryshojnë edhe parakushtet për marrëdhënie me mbretëritë, principatat dhe shtetet e tjera. Mbështetja që Skënderbeu gjen te udhëheqësit e principatave përreth Krujës dhe sukseset e para në marrjen nën administrim, kryesisht me marrëveshje të principatave shqiptare, dëshmojnë se një aktor i ri dhe i rëndësishëm po etablohej në rajon.

Në fakt politika e aleancave të Skënderbeut fillon ende pa hyrë në Krujë, përmes bashkëpunimit me Janosh Huniadin, vazhdon përmes pjesëmarrjes së përfaqësuesve të Venedikut gjatë mbajtjes së punimeve të Lidhjes së Lezhës dhe forcohet nëpër vite me lidhjet e ngushta me Vatikanin dhe Mbretërinë e Napolit. Ai luan me mjeshtëri në politikën e tij të jashtme në të pesë këto drejtime, duke pasur për bazë mbrojtjen e vendit nga pushtimi osman dhe mbrojtjen e interesave ekonomike të vendit.<sup>81</sup>

*Aleanca me Napolin.* Raporti i Skënderbeut me Mbretërinë e Napolit ka qenë më shumë një marrëdhënie partneriteti, se sa raport vasaliteti. Fan Noli madje e mohon edhe të dhënë se Skënderbeu ka qenë vasal i Mbretit të Napolit. Edhe Frazee shkruan se përmes Traktatit të Gaetas, Skenderbeu e njohu de facto kurorën e Mbretit të Napolit si aleancë mbrojtëse, por mbeti vazhdimisht një sundimtar i pavarur. Madje Skënderbeu shkon në Itali për ta mbështetur Mbretin

---

<sup>81</sup> Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare*, Vëllimi I Parë, Geer, Tiranë, 2005, fq.43-52

Ferdinand nga mësytyet e fisnikëve fqinjë kundër tij. Aleanca me Napolin i siguroi Skënderbeut mbështetje të vazhdueshme në ushtri, financa, mallra dhe teknikë.

*Aleanca me Selinë e Shenjtë.* Aleanca e Gjergj Kastriotit me Selinë e Shenjtë ishte e veçantë dhe permanente. Të katër udhëheqësit e Selisë së Shenjtë gjatë kohës së Skënderbeut (Papa Nikolas V, Calixtus III, Piu II dhe Paul II) e kanë mbështetur Skënderbeun me mijëra dukat të artë në të holla dhe kjo shumë ishte më e madhe se i kanë dhënë secilit shtet tjetër. Më 23 dhjetor 1457 Papa Calixtus III e shpall Skënderbeun Kapiten-Gjeneral të Selisë së Shenjtë. Papa i jep atij titullin Atlet i Krishtit ose Kampon i Krishtit.

Në nëntor 1463 Papa Piu II inicicion të organizojë një fushatë lufte kundër osmanëve. Venediku dhe shteti i Arbërit i përgjigjen pozitivisht ftesës. Skënderbeu i shpall luftë Perandorisë Osmane më 27 nëntor 1463. Piu vdiq në gusht 1464 në momentin kyç, kur ushtria ishte mbledhur në Ankonë dhe përgatitur për të marshuar në Shqipëri dhe kështu Skënderbeu u la sërish i vetëm. Ishte planifikuar që nga Papa Piu II Skënderbeu të shpallej edhe solemnisht mbret i Shqipërisë dhe udhëheqës i koalicionit të gjithë krishterë kundër osmanëve. Ai kishte shpresë se një koalicion i tillë do të pengonte pushtimin e Evropës nga Perandoria Osmane.

*Aleanca me Venedikun.* Raportet e Skënderbeut me Venedikun kanë qenë jostabile: raporte aleance e bashkëpunimi, por edhe raporte konfliktesh e mashtrimesh. Në vitet 1446 dhe 1447 Republika e Venedikut e mbështet Skënderbeun përmes ndërmjetësimit diplomatik dhe me armë. Por, sukseset e Skënderbeut e shqetësonin Venedikun, të cilët zhvillonin një tregti stabile me Perandorinë Osmane. Në Betejën e 23 korrikut 1448 para dyerve të Shkodrës Skënderbeu detyrohet të luftojë kundër Venedikut dhe e fiton betejën.

Kjo betejë do të ndikonte që raportet e Skënderbeut me Venedikun të mbeteshin të vagëta. Me rastin e rrethimit të Krujës nga osmanët, Skënderbeu i drejtohet Venedikut për ndihmë më 14 tetor 1450. Venediku nuk e pranon ofertën e Skënderbeut, për të mos i prishur marrëdhëniet tregtare me Perandorinë Osmane. Pozicioni i Venedikut ndryshon, pasi që fillon Lufta e tyre kundër osmanëve. Së bashku me Venedikun Skënderbeu luftoi kundër Perandorisë Osmane në vitet 1463-1468 derisa vdiq.<sup>82</sup>

Gjergj Kastrioti-Skënderbeu vdiq në një kohë kur Shqipëria ndodhej përballë vështirësive të mëdha ekonomike të papara ndonjëherë. Luftimet e ashpra të viteve 1466-1467 dhe prania për dy vjet radhazi e trupave të shumta osmane në tokat e lira shqiptare, rrënuan shumë ekonominë e

---

<sup>82</sup> <http://www.ambasadat.gov.al/italy/>

vendit dhe nuk lejuan të mbillej drithi e kulturat e tjera bujqësore. Masakrat e padëgjuaara dhe uria detyruan me mijëra shqiptarë të linin atdheun dhe të emigronin. Një pjesë e rajoneve lindore, si ato të Tetovës, Kërçovës, Ohrit e të Elbasanit iu shkëputën viseve të lira dhe kaluan nën pushtimin osman.

Vdekja e Skënderbeut i tronditi thellë shqiptarët dhe ndikoi shumë në jetën politike të vendit. Disa javë pas vdekjes së tij, e shoqja, Donika, dhe i biri Gjoni, u përfshinë në eksodin e madh shqiptar dhe u vendosën në pronat që kishin në Itali.

Humbja e Skënderbeut, i hoqi botës shqiptare udhëheqësin e jashtëzakonshëm, që kishte ndikuar fuqishëm në tërë veprimtarinë politike të vendit. Familjet e mëdha aristokrate dolën përsëri si zotër më vete dhe disa prej tyre filluan të mbështeteshin te Republika e Venedikut, që, me vdekjen e Skënderbeut, veptoi energjikisht për të vënë nën kontroll jetën politike të Shqipërisë.

Senati i Venedikut vendosi që të dërgonte në Shqipëri Pal Engjëllin, i cili prej shumë vitesh qëndronte atje si përfaqësues i Skënderbeut. Sapo erdhi në Shqipëri, Pal Engjëlli bisedoi me të afërm të familjes së Kastriotëve dhe u kërkoi atyre që t'i dorëzonin Venedikut Krujën dhe zotërimet e tjera. Kur gruaja dhe djali i Skënderbeut u larguan nga Shqipëria, Kruja kaloi në duart e Venedikut. Vëmendje u kushtoi Republika e Venedikut edhe marrëdhënieve me fisnikët e tjerë shqiptarë, që i kishin zotërimet në kufi me të dhe me Krujën. Prandaj më 1469 i dërguari i posaçëm i Venedikut në Shqipëri, vizitoi fisnikë të tjerë që i kishin zotërimet në afërsi të Krujës.<sup>83</sup>

Ndërkohë disa nga fisnikët shqiptarë ishin kundër forcimit të pozitave të Venedikut në Shqipëri dhe marrëdhëniet u acaruan aq shumë, saqë u ndërmorën edhe masa ndëshkimore. Më 1469 Senati i Republikës vendosi që, në qoftë se i biri i Mamicë Kastriotit nuk do t'i bindej Venedikut, nëna e tij të dëbohej nga qyteti i Durrësit, ku ajo banonte. Edhe më të acaruar u bënë marrëdhëniet e Venedikut me Lekë Dukagjinin. Për të ruajtur zotërimet e veta nga sulmet osmane, Leka hyri në bisedime me osmanët, gjë që e shqetësoi shumë Republikën e Venedikut. Prandaj më 1469 Senati i saj vendosi të mos lejohej Lekë Dukagjini që të merrte pasuritë që kishte në Shkodër, duke shpresuar se me një masë të tillë do ta largonte atë nga bisedimet me osmanët. Por ky sanksion i acaroi edhe më tej marrëdhëniet ndërmjet tyre dhe e detyroi Lekë Dukagjinin të përdorte armët kundër Venedikut.

---

<sup>83</sup> <https://www.shqiperia.com/kategori/kat/knr/88/Shqiperia-ne-vitet-1468---1479>

Pas marrjes së Krujës, në duart e Republikës së Venedikut kishin kaluar të gjitha kështjellat e rëndësishme të viseve të Shqipërisë Qendrore e të Sipërme, që ende ishin të papushtuara prej osmanëve. Edhe pse këto kështjella mbroheshin kryesisht nga luftëtarë shqiptarë, ruajtja e tyre varej shumë tani nga qëndrimi që do të mbante Venediku ndaj pushtuesve osmanë.<sup>84</sup>

Raportet mes Italisë dhe Shqipërisë gjatë shekujve në vijim pësuan shumë batica dhe zbatice, dhe në këtë klimë u vazhdua për një periudhë të gjatë kohore, deri diku katër shekuj. Ndiheza reciproke, ekuilibri në mes shteteve fqinje, por në disa raste edhe mos marrëveshjet vazhduan të jenë prezente në çdo kontekst gjeopolitik, deri në shekullin XVIII kur çështja për krijimin e një shteti Sovran dhe shpallja e panvarësisë filluan të jenë temë diskutimi në realitetin evropian.

Ishte Lufta e Parë Botërore ajo që un do ta quaja “mollë sherri” për prishjen e marrëdhënieve miqësore mes Republikës së Shqipërisë dhe Italisë. Pikërisht gjatë viteve 1915–1916 territoret e Shqipërisë u pushtuan nga ushtria italiane, austro–hungareze e franceze. Qeveria italiane, në qershor të vitit 1917 në Gjirokaster, shpalli pavarësinë e Shqipërisë në Traktatin e Londrës gjatë Luftës së Parë Botërore, Antantja Tripale i kishte premtuar Shqipërinë qendrore dhe jugore Italisë, si një shpërblim për të luftuar përkrah Antantës. Në qershor 1917, pasi ushtarët italian morën kontrollin e zonave të konsiderueshme të Shqipërisë, Italia deklaroi zyrtarisht një protektorat mbi Shqipërinë qendrore dhe jugore; megjithatë kjo u përmbys në shtator të vitit 1920 kur Italia u vu nën presion për të hequr ushtrinë e saj nga Shqipëria. Fashistët italianë pohuan se shqiptarët ishin të lidhur etnikisht me italianët nëpërmjet lidhjeve me italianët prehistorikë, popullsitë ilire dhe romake dhe se ndikimi kryesor i ushtruar nga perandoritë romake dhe Veneciane mbi Shqipërinë justifikonte të drejtën e Italisë për ta zotëruar atë. Italia justifikoi edhe aneksimin e Shqipërisë në bazë të faktit se disa qindra mijëra njerëz me origjinë shqiptare tashmë ishin përfshirë në Italinë jugore, që inkorporimi i Shqipërisë ishte një masë e arsyeshme që do të bashkonte njerëzit me prejardhje shqiptare në një shtet.<sup>85</sup>

Para intervenimit të drejtpërdrejtë në Luftën e Parë Botërore, Italia pushtoi portin e Vlorës në Shqipëri në dhjetor 1914. Forcat italiane në vitin 1916 rekrutuan parregullsitë shqiptare për të shërbyer pranë tyre. Italia me lejen e komandës së aleatëve, pushtoi Epirin e Veriut më 23 gusht

---

<sup>84</sup> <https://www.shqiperia.com/Shqiperia-pas-vdekjes-se-Skenderbeut.178/>

<sup>85</sup> Rodogno., Davide (2006). *Fascism's European empire: Italian occupation during the Second World War*. Cambridge University Press. fq. 106.



1916, duke detyruar ushtrinë greke të tërhiqte forcat e saj okupuese nga atje. Në qershor 1917, Italia shpalli Shqipërinë qendrore dhe jugore si një protektorat të Italisë, ndërsa Shqipëria e Veriut u nda në shtetet e Serbisë dhe Malit të Zi. Pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore, Italia tërhoqi forcat e saj ushtarake më 2 shtator 1920 nga Shqipëria si rezultat i presionit dhe humbjes së jashtme në Luftën e Vlorës.

Regjimi fashist italian kishte depërtuar dhe dominuar politikisht dhe ekonomikisht Shqipërinë gjatë sundimit të Zogut dhe po planifikonte aneksimin e Shqipërisë para viteve të ngjarjes. Shqipëria u bë një protektorat de facto i Italisë pas nënshkrimit të Traktateve të Tiranës të vitit 1926 dhe 1927. Sipas Zogut, ekonomia e Shqipërisë ishte e varur nga kreditë e shumta financiare të dhëna nga Italia që nga viti 1931.<sup>86</sup>

Në gusht 1933, Mussolini vendosi kërkesa të rrepta ndaj Zogut në këmbim të mbështetjes së vazhdueshme të Italisë nga Shqipëria, duke përfshirë kërkesat që të gjitha emërimet e reja në pozita udhëheqëse në qeverinë shqiptare duhej të kishin marrë një "arsim italian"; një ekspert italian do të ishte në të ardhmen në të gjitha ministrinë e qeverisë shqiptare; Italia do të marrë kontrollin e ushtrisë shqiptare - duke përfshirë fortifikimet e saj; oficerët britanikë që po stërvitnin xhandarmanin e Shqipërisë u zëvendësuan nga oficerë italianë; Shqipëria duhet të anulohet të gjitha traktatet tregtare ekzistuese me vendet e tjera dhe të mos bëjë marrëveshje të reja pa miratimin e qeverisë italiane; dhe Shqipëria nënshkruan një konventë tregtare që do ta bënte Italinë vendin "më të favorizuar" në Shqipëri. Në vitin 1934, kur Shqipëria nuk dha pagesën e planifikuar të një kredie për në Itali, anijet luftarake italiane arritën në brigjet e Shqipërisë për të frikësuar Shqipërinë që t'i nënshtrohej qëllimeve italiane në rajon, megjithatë britanikët kundërshtuan veprimet e Italisë dhe nën presion, Italia u tërhoq dhe pohoi se ushtrimi detar ishte thjesht një "vizitë miqësore".

Megjithë mbrojtjen e gjatë të Shqipërisë dhe aleancën me Italinë, më 7 prill 1939 trupat italiane pushtuan Shqipërinë, pesë muaj para fillimit të Luftës së Dytë Botërore. Rezistenca e armatosur shqiptare u tregua e paefektshme ndaj italianëve dhe, pas një mbrojtjeje të shkurtër, vendi ishte i pushtuar. Më 9 prill 1939 mbreti shqiptar, Zogu I iku në Greqi. Ndonëse Shqipëria kishte qenë një protektorat de facto italian që nga viti 1927, lideri politik i Italisë, Benito Mussolini kërkoi kontroll të drejtpërdrejtë mbi vendin për të rritur prestigjin e tij dhe për të dhënë një përgjigje ndaj aneksimin të Austrisë dhe okupimit të Çekosllovakis.

<sup>86</sup> [https://sq.wikipedia.org/wiki/Shqip%C3%ABria\\_n%C3%ABn\\_pushtimin\\_italian\\_\(1939%E2%80%931943\)](https://sq.wikipedia.org/wiki/Shqip%C3%ABria_n%C3%ABn_pushtimin_italian_(1939%E2%80%931943))

Shqipëria ishte një protektorat italian i varur nga interesat italiane, në përputhje me Protektoratin gjerman të Bohemisë dhe Moravës, Shqipëria duhej të qeveriset nga një zëvendës-përfaqësues italian që përfaqësonte Mbretin Viktor Emmanuel III, një union doganor u miratua, dhe politika e jashtme shqiptare duhej të trajtohej nga Roma.<sup>87</sup> Forcat e armatosura shqiptare u përfshinë në ushtrinë italiane, këshilltarët italianë u vendosën brenda të gjitha niveleve të administratës shqiptare dhe vendi pranoi krijimin e Partisë Fashiste Shqiptare dhe organizatave të saj, të modeluara sipas prototipit italian. Partia Fashiste Shqiptare ishte një degë e Partisë Fashiste Popullore të Italisë, anëtarët e Partisë Fashiste Shqiptare morën një betim se do t'i bindeshin urdhrave të Duce të Fashizmit, Musolini. Qytetarët italianë filluan të vendoseshin në Shqipëri si koloniste dhe të zotëronin tokën në mënyrë që ta transformonin gradualisht në tokën italiane. Burimet natyrore të vendit gjithashtu dolën nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Italisë. Të gjitha burimet e naftës në Shqipëri shkuan në Agip, kompania italiane e naftës.

Shqipëria ishte e rëndësishme historikisht për qëllimet nacionaliste të fashistëve italianë, pasi që territori i Shqipërisë kishte qenë prej kohësh pjesë e Perandorisë Romake, madje përpara aneksimit të Italisë veriore nga romakët. Më vonë, gjatë Mesjetës së Lartë disa zona bregdetare (si Durazzo) ishin të ndikuara dhe në pronësi të fuqive italiane, kryesisht Mbretërisë së Napolit dhe Republikës së Venecias për shumë vite (Arbëria Venedikase). Regjimi fashist italian legjitimoi kërkesën e tij ndaj Shqipërisë nëpërmjet studimeve që shpallnin afinitetin racial të shqiptarëve dhe italianëve.

Italia gjithashtu u përpoq të legjitimonte dhe të fitonte mbështetjen publike për sundimin e saj mbi Shqipërinë duke mbështetur irredentizmin shqiptar, të drejtuar kundër Kosovës me popullsi kryesisht shqiptare në Mbretërinë e Jugosllavisë dhe Epirit në Greqi, veçanërisht në zonën kufitare të Çamërisë, të banuar nga pakica çame shqiptare. Kështu, një botim italian fashist me emrin Geopolitica pohonte se popullsia e rajonit të Epirit-Acarnania të Greqisë i përkiste Shqipërisë për shkak se ishte racor Dinarik dhe formoi një 'sistem të vetëm gjeografik me zonën e Adriatikut. Megjithë përpjekjet e nënkryetarit italian Francesco Jacomoni, për të nxitur kryengritjet dhe për të krijuar një kolonë të pestë, dhe raportet e favorshme që ai i dërgoi ministrit të jashtëm italian Galeazzo Ciano, ngjarjet dëshmuuan se kishte pak entuziazëm mes shqiptarëve: pas pushtimit italian të Greqisë, shumica e shqiptarëve u braktisën ose u dezertuan.

---

<sup>87</sup> Lisen Bashkurti, *Diplomacia Shqiptare*, GEER, Tiranë, 2005, fq 112

Me pushtimin e Shqipërisë dhe instalimin e një qeverie të re, ekonomitë e Shqipërisë dhe Italisë u lidhën nëpërmjet një bashkimi doganor që rezultoi me heqjen e shumicës së kufizimeve tregtare. Përmes një bashkimi tarifor, sistemi shqiptar i tarifave u vendos në Shqipëri. Për shkak të humbjeve të pritshme ekonomike në Shqipëri nga ndryshimi i politikës tarifore, qeveria italiane i dha Shqipërisë 15 milionë lekë çdo vit në kompensim. Ligjet doganore italiane do të aplikoheshin në Shqipëri dhe vetëm Italia mund të lidhë traktate me palë të treta. Kapitali italian u lejua të dominojë ekonominë shqiptare. Si rezultat, kompanitë italiane u lejuan të mbajnë monopole në shfrytëzimin e burimeve natyrore shqiptare.

Periudha e diktaturave fashiste dhe komuniste në Itali dhe Shqipëri është pjesa më e errët dhe më hidhur e historisë së marrëdhënieve midis dy vendeve tona. Traktati i Paqes me Italinë u nënshkrua në shkurt 1947 në Paris dhe hyri në fuqi më 15 shtator 1947. Në maj 1949 u rivendosën marrëdhëniet diplomatike, pas kërkesave të vazhdueshme nga pala italiane. Me 2 shkurt 1954 i Dërguari i Jashtëzakonshëm dhe Ministri Fuqiplote i Republikës Italiane në Tiranë paraqiti letrat kredenciale. Që në vitet e para pas luftës, Qeveritë italiane në politikën e tyre ndaj Shqipërisë, dënonin agresionin fashist të 7 prillit 1939, duke ia atribuar atë fashizmit dhe duke e konsideruar vetëm një fakt historik. Gjithashtu ato kanë njohur sovranitetin e vendit tonë dhe kufijtë ekzistues.

Pas daljes së Shqipërisë, në vitin 1968, nga Traktati i Varshavës, u bënë demarshe nga pala italiane për t'u afruar me qeverinë shqiptare. Njëfarë zhvillimi të marrëdhënieve me Italinë u pa në vitet '80. Në këtë periudhë pati shkëmbime delegacionesh të ndryshme, vizita anëtarësh qeverie, një rritje të volumit të shkëmbimeve tregtare si dhe atyre kulturore.

Gjatë viteve '90, veçanërisht pas ndryshimeve politike në Shqipëri, marrëdhëniet mes të dy vendeve patën një hov të ndjeshëm. Italia në fillimet e demokracisë u evidentua si një prej partnerëve strategjik më të rëndësishëm të Shqipërisë, duke asistuar dhe kontribuar në reformat e institucioneve, ato ekonomike dhe konsolidimin e Shtetit të së Drejtës. Më tej marrëdhëniet dypalëshe u karakterizuan nga një veprimtari intensive në fushën politiko-diplomatike dhe social-ekonomike.<sup>88</sup>

Bashkëpunimi ndërmjet dy shteteve në këtë fazë të re u bë shumë-dimënsional dhe shumëplanësh. Mbështetja italiane u bë prezente pothuaj në të gjitha fushat e Shqipërisë, duke rikonfirmuar faktin se Italia ishte donatori dypalësh kryesor i vendit, si në aspektin e financimeve, ashtu edhe

---

<sup>88</sup> <http://www.ambasadat.gov.al/italy/sq/historik-i-marr%C3%ABdh%C3%ABnieve-dypal%C3%ABshe>

në gjërësinë e spektrit të ndërhyrjeve. Ky intensifikim u evidentua më tej në aspektin e takimeve të ndërsjellta në nivele të larta dhe shumë të larta, por edhe në kontaktet e shpeshta në nivele të tjera, duke bërë që marrëdhëniet midis dy vendeve të marrin përmbajtje më konkrete dhe më efektive.

Këto marrëdhënie erdhën gjithnjë duke u rritur e thelluar deri në ditët tona, duke u shëndruar në marrëdhënie të mirëfillta partneriteti dhe duke ekuilibruar relativisht dhe raportin e import-eksportit në fushën ekonomiko-tregtare. Kështu ecuria e bashkëpunimit dhe e rolit që ka luajtur Italia ndaj Shqipërisë ka njohur intensitet dhe zhvillime mjaft pozitive.

Në marrëdhëniet midis dy vendeve, përveç anës sasiore, ka edhe elementë cilësorë, të cilët i kanë bërë më të afërta dhe kanë konfirmuar karakterin strategjik të marrëdhënieve Shqiptaro- Italiane. Italia sot ka evidentuar integrimin evropian të vendeve të Ballkanit Perëndimorë, mes tyre dhe Shqipëria, si një prej prioriteteve të politikës së saj të jashtme.

Ky nivel marrëdhëniesh është në përputhje të plotë me orientimin e qeverisë shqiptare, e cila marrëdhëniet me Italinë i konsideron të një rëndësie parësore dhe partneriteti strategjik.

Gjatë këtij kapitulli u bë një pasqyrim marrëdhëniesh dhe bashkëpunimesh mes dy republikave, që do të na shërbejnë për shtjellimin më të detajuar të dukurive në vazhdim.

## **Përfundime**

Disa nga specifikat e politikës së jashtme janë, fokusimi i saj në disa fusha të veçanta, kufizimet gjeografike, interesimi i shtuar për aleanca regjionale dhe integrimin në organizata ndërkombëtare, sidomos në ato të sigurisë. Politika e jashtme është e prirë për të zgjedhur pozicione neutrale në çështje ndërkombëtare që nuk lidhen drejtpërdrejt me interesat vitale të tij dhe në përpjekjet për gjetjen e ndonjë aleati të fuqishëm e të besueshëm.

Marrëdhëniet e mira me shtetet fqinjë ndaj proceseve integruese janë shumë të rëndësishme për politikën e jashtme. Mjetet që përdoren për realizimin e politikës së jashtme nga ana e shteteve të vogla si për shembull Shqipëria janë më të kufizuara. Këto shtete zakonisht mbështeten në përdorimin e diplomacisë si mjetin kryesor për realizimin e politikës së jashtme, posaçërisht disa formave të diplomacies-negociatat, të cilat janë më efektive për politikën e tyre të jashtme.

Njohja e politikës së jashtme në përgjithësi është e një rëndësie të veçantë për njohjen e marrëdhënjeve bilaterale dhe politikat që luajnë shtetet pjesëmarrse për realizimin e qellimeve të tyre, këtu me një theks të veçantë shtjellohet qellimi I shteteve ballkanike, si për shembull Republika e Shqipërisë drejt integritit në Bashkimin Europian.

Në kuadër të politikave të jashtme, pozicioni gjeografik I një vendi luan një rol të veçantë sepse ai shërben si një urë lidhëse në sfera të ndryshme siç janë: zhvillimi ekonomik drejt globalizimit dhe progresit teknologjik, përfitime në çështjet e politikës së jashtme, arritja e sigurisë, stabilitetit dhe mbrojtjes.

Pra, mund të themi se pozicioni gjeografik I Shqipërisë, panvarësisht dimensionit të saj, është mjaft strategjik për ruajtjen e ekuilibrit në rajon, pa marrë parasysh ngjarjet pozitive apo negative

që kanë ndikuar në politikbërjen e jashtme. Pikërisht pozicioni gjeografik i Shqipërisë është po ai faktor që ka bërë të mundshme rruajtjen e marrëdhënieve diplomatike dhe miqësore ndër shekuj me shtetin Italian. Raportet mes Italisë dhe Shqipërisë pësuan shumë batica dhe zbatice, dhe në këtë klimë u vazhdua për një periudhë të gjatë kohore, deri diku katër shekuj. Ndiheza reciproke, ekuilibri në mes shteteve fqinje, por në disa raste edhe mos marrëveshjet vazhduan të jenë prezente në çdo kontekst gjeopolitik, deri në shekullin XIX kur çështja për krijimin e një shteti Sovran dhe shpallja e panvarësisë filluan të jenë temë diskutimi në realitetin evropian. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, qëllimi i Italisë u shndërrua në fushë interesash. Qytetarët italianë filluan të vendoseshin në Shqipëri si koloniste dhe të zotëronin tokën në mënyrë që ta transformonin gradualisht në tokën italiane. Burimet natyrore të vendit gjithashtu dolën nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Italisë. Të gjitha burimet e naftës në Shqipëri shkuan në Agip, kompania italiane e naftës. Periudha e diktaturave fashiste dhe komuniste në Itali dhe Shqipëri është pjesa më e errët dhe më hidhur e historisë së marrëdhënieve midis dy vendeve tona. Traktati i Paqes me Italinë u nënshkrua në shkurt 1947 në Paris dhe hyri në fuqi më 15 shtator 1947. Në 50 vjeçarën pas nënshkrimit të këtij traktati dhe deri në periudhën poskomuniste, marrëdhëniet mes dy shteteve ishin relativisht të mira dhe kanë marrë forma të ndryshme në varësi të politikbërjes të dy shteteve.

Gjatë viteve '90, veçanërisht pas ndryshimeve politike në Shqipëri, marrëdhëniet mes të dy vendeve patën një hov të ndjeshëm. Italia në fillimet e demokracisë u evidentua si një prej partnerëve strategjik më të rëndësishëm të Shqipërisë, duke asistuar dhe kontribuar në reformat e institucioneve, ato ekonomike dhe konsolidimin e Shtetit të së Drejtës. Më tej marrëdhëniet dypalëshe u karakterizuan nga një veprimtari intensive në fushën politiko-diplomatike dhe social-ekonomike. Gjatë kësaj periudhe, kur rajoni ballkanik ishte i përfshirë në gjendje krize, ndihmesa që Italia vazhdimisht i mundësoi shtetit Shqiptar, konvergonte në motivin kryesorë të saj. Synimi i Italisë nuk kishte për qëllim vetëm përfitime ekonomike dhe ruajtjen e stabilitetit, por edhe të ktheheshte në një prej aktorëve më të rëndësishëm në politikën ndërkombëtare. Për Italinë stabilizimi i Shqipërisë është objektiv strategjik për të evituar problematikat e brendshme, për të konsoliduar demokracinë e posalindur të vendit fqinjë dhe integrimin e saj në Europën Perëndimore.

Në nvarësi nga situatat dhe gjendjet që e kanë kapluar shtetin Shqiptarë, Italia ka qenë gjithnjë në gjendje gatishmërie për ti ardhur në ndihmë shtetit, duke përdorur strategji nga më të

ndryshmet dhe njëkohësisht duke mbrojtur interesat e veta. Pas rënies së regjimit komunist, Shqipëria ishte në gjendje mjerimi, ajo përjetoi vështirësitë më të mëdha ekonomike dhe sociale. Në vitin 1991 fluksi I refugjatëve që iu drejtuan shtetit fqinj arriti në 30 000, duke u shndëruar kështu në eksod masiv. Për të mbrojtur interesat e veta, Italia ndërmori masa emergjente për të parandaluar emigrimin e paligjshëm, dhe në të njëjtën kohë do të pengonte edhe krimin e organizuar italo-shqiptar. Pas krizës së brendshme të Shqipërisë, qeveria italiane tentoi të ndërrmer masa preventive për rikonstruim të institucioneve të vendit fqinj, pikërisht me anë të këtij plani, për herë të parë flitet për procese integruese dhe përmbushje të kriterëve të nevojshme për integrimin evropian.

Gjatë viteve 1998-2000, u shënuar faza e tejkalimit të emergjencës, si rrjedhojë e hartimit të planit tre vjeçar që parashihte konsolidimin e institucioneve shqiptare ku duhej ndërhyrë me asistencë teknike dhe zhvillim ekonomik të bazuar në ekonominë e tregut. Për të siguruar stabilitetin në vend dhe zhvillim ekonomik, qeveria italiane propozoi kooperimin mes dy shteteve ku u përfshinë ministria e punëve të jashtme, këshilli I ministrave dhe departamentet tjera ministriale, këto kooperativa u bënë të pranishëm në Shqipëri që prej vitit 1991. Momentalisht, janë aktive një numër I konsiderueshëm projektesh të finansuara nga qeveria italiane, të cilat arrijnë vlerën rreth 300 milion euro, dhe duke e bërë kështu Italin të jetë një nga donatorët më të mëdhej aktiv në vend. Nga fundi I viteve '90 situata e brendshme politike arrin një stabilitet të qëndrueshëm, sfera ekonomike shënoi rritje, institucionet gjyqësore shkuan drejt progresionit duke e arritur besueshmërinë e nevojshme. Këto arritje të shtetit shqiptarë mundësuan hipotezën për hapjen e bisedimeve të para diplomatike për antarësim në bazë të progresit të shfaqur. Gjatë analizës së deri tanishme, mund të konstatojmë se Italia është përpjekur të lehtësojë rrugëtimin e Shqipërisë postkomuniste, duke dhënë kontributin e saj financiar dhe human për të përmbushur kriteret e nevojshme për hapat e negociatave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit. Kjo vërehet në qëndrimin që mbajti Këshilli I Përgjithshëm I BE-së, I cili në mbledhjen e 21 tetorit 2002, vendosi hapjen e negociatave me Shqipërinë, të cilat u zyrtarizuan më 31 janar 2003, dhe nuk është rastësi që aso kohe, në krye të presidencës së Komisionit European qëndronte Romano Prodi. Ky qëndrim I ekzekutivit të BE-së, e bëri më të qartë orientimin e Italisë kundrejt çështjes shqiptare. Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, e cila u nënshkrua në vitin 2006 dhe hyri në fuqi në 2009, u bë baza e marrëdhënieve të Shqipërisë me Bashkimin European si dhe nisja e progresit të Shqipërisë drejt antarsimit. Italia pas nënshkrimit

të marrëveshjes për partner strategjik duket se ka dëshmuar interesin e saj për integrimin e Shqipërisë në BE, sidomos pas marrjes së statusit të vendit kandidat. Pas ndryshimeve politike të këtyre dy dekadave, një nga sfidat kryesore të Shqipërisë është antarsimi në BE, dhe arritja e këtij objektivi kërkon zhvillimi të gjithanshëm në vend, gjithashtu ndërmarjen e reformave të shumta, të cilat do të shërbenin si katalizator për progresin drejt këtij rrugëtimi.

Kuadri european është thelbësor për të ndihmuar Shqipërinë në tejkalimin e përcetimeve jo positive dhe për ti dhënë një shtysë procesit, në këtë kontekst, Italia ka qenë protagonist e bashkëpunimit pozitiv, duke dhënë kontributin e saj të drejtpërdrejt në zgjedhjen e problemeve të ndryshme të vendit fqinj, në të gjitha sferat.

### **Intervista**

Gjatë kësaj interviste, janë marrë në pyetje 5 te punuar diplomatic, të gradacioneve të ndryshme.

#### **Sejdali Saliu**

##### **✓ Cili është roli i faktorit ndërkombëtarë për politikën e jashtme dhe marrëdhënjet ndërkombëtare?**

Një shteti anëtar i Kombeve të Bashkuara, si subjekt ndërkombëtar obligohet dhe merr në përgjegjësi t'i respektojë detyrimet dhe të drejtat, që dalin nga Karta e KB, e miratuar në vitin 1945, pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore e cila, si dokument juridik që është, synon ruajtjen e paqes dhe të sigurisë në botë, mbrojtjen e të drejtave themelore, dinjitetin dhe vlerat njerëzore, barazinë gjinore etj. Po ashtu, shtetet formalisht lidhin marrëdhënie bilaterale midis tyre, duke hapur përfaqësi diplomatike konsullore dhe duke bashkëpunuar në shumë fusha me interes të përbashkët dypalësh dhe shumëpalësh, në respekt të Konventës së Vienës për Marrëdhënie Diplomatike dhe të asaj për Marrëdhënie Konsullore. Si më me ndikim në fushën e politikave të jashtme, gjatë kohë në arenën ndërkombëtare janë prezente BE dhe SHBA, dy qendra këto të pakontestueshme të vendosjes, të cilat një shteti të caktuar i ofrojnë mundësi, mbështetje dhe ndihma të caktuara, logjistike etj. Këto dy qendra të fuqishme, së bashku me Anglinë, Gjermaninë dhe Francën, gjithashtu, shteteve të Ballkanit Perëndimor janë duke u ofruar mbështetje në synimet e tyre në rrugën e integritit në NATO dhe BE, në mbështetje të programeve zhvillimore, të zhvillimit të demokracisë dhe krijimit të kushteve për sundimin e shtetit ligjor, në mirëmbajtjen e sigurisë, si dhe në zgjedhjen e kontesteve, të çështjeve të caktuara dhe të konflikteve me konotacion bilateral, rajonal dhe më të gjerë ndërkombëtar, duke ofruar kështu mundësinë që një shtet të jetë më i besueshëm,



më funksional, më efikas dhe më efektiv në kryerjen e obligimeve nga marrëveshjet ndërkombëtare në raport me shtete dhe subjekte tjera ndërkombëtare, si në aspekt dypalësh ahtu dhe në atë shumëpalësh. Si shembull më të freskët në këtë konotacion duhet përmendur zgjidhjen e konfliktit të gjatë midis Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë me nënshkrimin e Marrëveshjes së Prespës. Kështu, vendi ynë, përveç procedurave për anëtarësim në NATO dhe gatishmërinë për hapjen e negociatave për anëtarësim në BE, ka krijuar besueshmëri dhe raporte më pozitive në marrëdhëniet ndërkombëtare me shtete dhe me asociacione tjera ndërkombëtare dhe rajonale, siç është BE, OSBE, NATO, UNICEF, UNHCR, FAO, IFAD etj. Por, në anën tjetër, në raste nevojë, po ashtu nga qendrat e tilla veprohet me metoda të caktuara politike dhe diplomatike, disa here duke përdorur edhe presione të dozuara për kthimin e demokracisë në ato vende, që drejtohen nga qeveri dhe lidhshipe autoritare, siç ishte qeveria e Nikolla Gruevskit.

✓ **Cili është qëndrimi i ambasadorëve dhe diplomatëve në lidhje me situatat politike?**

Ambasadorët dhe diplomatë të tjerë në vendet e pranimit, si përfaqësues të shteteve të dërgimit, përveç tjerash, kanë për obligim që në respekt të normave ligjore të shtetit të dërgimit dhe të konventave ndërkombëtare, të autorizimeve, të imuniteteve dhe privilegjeve, të mund të ndjekin zhvillimet politike e tj. në vendin e pranimit dhe të mbrojnë interesat e shtetit dhe të shtetasve të tyre në vendin e pranimit. Pra, ata ndjekin me interes dhe i informojnë vendet e tyre lidhur me zhvillimet, ndodhitë e ndryshme, si dhe për ato me potencial për prishjen e rendit dhe të sigurisë në vendin e pranimit, si pasojë e shkeljes së normave ligjore, të parimeve të demokracisë dhe të rregullave etj. Kështu, në shtetet në transicion dhe të trazuara të Ballkanit Perëndimor, paraqiten ndikime të organizuara dhe të mbështetura nga subjekte politike dhe nga grupe personash zyrtarë për të prishur balancat gjeopolitike dhe aspiratat e popujve të tyre për eurointegrim, të sponsorizuar drejtpërdrejt nga segmente qeveritare të Rusisë putiniane. Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mal i Zi nuk janë të përjashtuara nga ndikimet dhe provokimet ruse, me qëllim të pengimit të rrugës së tyre drejt eurointegrimëve. Ambasadorët e shteteve të Perëndimit, si dhe diplomatë të tjerë perëndimorë luajnë rol vendimtar në mbështetjen e këtyre vendeve për të realizuar synimet e tyre, duke u ofruar institucioneve vendore ndihmë profesionale, logjistika të caktuara, ndihmë financiare etj. me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen e nevojshme nga bartësit e veprimeve subversive në institucione ose në media, veprime këto të fshehta ose jo, të sponsorizuara sidomos nga Rusia.

✓ **A mund të kemi komplikime në marrëdhënjet bilaterale mes dy shteteve, nëse ndodhin ndryshime në kushtetutë njerit shtet?**

Nëse në një shtet me kushtetutë demokraike zgjedhjet palamentare i fitojnë forca radikale politike, forca nacionaliste, të cilat e manipulojnë elektoratin me premtime për ndryshime kushtetuese në dëm të ndonjë pakice etnike, të cilën e mbrojnë një shtet fqinj, ose nëse ndryshimet kushtetuese kërkojnë avancimin e të drejtave etnike të një pakice në një shtet fqinj në kundërshtim me legjislacionin e tij, kjo mund të shërbejë si casus belli për prishjen e marrëdhënieve midis dy shteteve deri në ndonjë konflikt etj. Maqedonia e Veriut dhe Greqia vlerësohen si shembull pozitiv, që me dialog zgjidhën konfliktin 30-vjeçar me nëshkrimin e Marrëveshjes së Prespës, i cili përfshinte edhe aspektin e kontestuar të pakicës etnike maqedonase në shtetin fqinj. Pra, bazuar në parimet, vlerat dhe kulturën politike perëndimore, gjithmonë duhet dhënë përparësi dialogut, negociatave, gjegjësisht bisedimeve për zgjidhjen e kontesteve dhe mosmarrëveshjeve midis shteteve, bile dhe me potencial për t'u përdorur për konflikt të mundshëm ndërshtetëror.

✓ **A mund të presim se negociatat të prodhojnë zgjedhje përfundimtare në zgjedhjen e çështjeve ndërkombëtare?**

Natyrisht se po. Shembull i tillë i freskët është zgjidhja e konfliktit 30-vjeçar maqedonas-grek me domethënie rajonale dhe ndërkombëtare, që i paraprijnë ndryshimet në kushtetutën tonë dhe pastaj u nënshkrua Marrëveshja e Prespës, me të cilën R. e Maqedonisë ndryshoi emrin në Maqedona e Veriut, dhe kështu shtetit tonë iu mundësua anëtarësim në NATO dhe hapja e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian. Mund të përmendet këtu edhe Marrëveshja e Dejtonit, e cila detyroi Slobodan Millosheviqin, Franjo Tugjmanin dhe Alija Izetbegoviqin të ndërpresin operacionet e përgjakshme luftarake të ushtrive të tyre dhe t'u jepet fund luftërave të përgjakshme në vitet '90 në ish-Jugosllavi, lufta këto të nxitura nga serbomadhi S.Miloshevq.

✓ **Çka do të përfitoj politika e jashtme e Shqipërisë dhe vendeve tjera të Ballkanit pas integrimimit në Bashkimin Europian?**

Me qenë se, paraprakisht, legjislacioni vendor do të jetë adaptuar atij të Bashkimit Europian, pas integrimimit në BE Politika e jashtme e Shqipërisë dhe e vendeve tjera të Ballkanit do të përfitojnë status të barabarë institucional me vendet tjera anëtare në BE. Është e pritshme që politikat e

jashtme të Ballkant Perëndimor të harmonizohen me legjislacionin dhe të jenë në funksion të plotë me ato të BE, si në aspekt bilateral, ashtu dhe në atë multilateral midis tyre dhe me vende të treta në plan global. Kjo nënkupton investime në burimet njerëzore edhe nga fonde europiane, në ambiente dhe në pajisje të përshtatshme në Dikasterët e Jashtëm për veprimtari të tyre të përbashkët ndaj sfidave dhe rreziqeve të mundshme rajonale dhe globale, të rreshtuar me institucionet kompetente të BE dhe SHBA.

✓ **Sa ka ndikuar Italia në procesin e integritit të Shqipërisë në Unionin Europian?**

Republika Italiane është shtet i madh dhe i zhvilluar europian, fqinje e Republikës së Shqipërisë, anëtare dhe njëra ndër themeluesit e BE. Me të, Shqipëria ka marrëdhënie shumë të mira tradicionale, historike, politike, diplomatike, afariste tregtare, kulturore kulturore e tj. Dëshira dhe gatishmëria e palës italiane që ta shohë fqinjin lindor-Shqipërinë të demokratizuar dhe të zhvilluar në çdo aspekt, ka ndikuar që diplomacia italiane vazdimisht të jetë një zë i sinqertë europian dhe një avokate në ndihmë të Shqipërisë për anëtarim në BE. Në këtë kontekst, janë me rëndësi shumë të madhe ndihmat profesionale, logjistike, teknologjike, financiare e tjera në fusha të ndryshme, me qëllim që ky vend të arrijë t’i përmbushë kushtet e vështira për t’i hapur bisedimet e pritshme për antarim në BE. Italia vazhdon ta ndihmojë Shqipërinë për reformën në drejtësi, në institucionet e mbrojtjes dhe të sigurisë, në përballjen me krimin e organizuar dhe dekanabizimin e vendit me ndihmën direkte edhe të institucioneve italiane Antimafia dhe Guardia di Finanza, në zhvillimin ekonomik etj. Emigracioni i etabluar, i integruar, punëdashës dhe i afirmuar në shumë fusha të jetës i disa qindëra mijë shqiptarësh në Itali, si dhe investimet e mëdha italiane në Shqipëri, kanë përforcuar edhe më shumë besimin dhe bashkëpunimin e ndërsjellë institucional dhe në përgjithësi lidhjet shqiptaro-italiane.

✓ **Çfarë përfitimesh sjellin takimet e diplomatëve me homologët e tyre, por edhe me zyrtar të tjerë, rreth çështjes së sigurisë?**

Së pari, me takimet e ndërsjella jo vetëm zyrtare, bëhet njohja midis diplomatëve, e cila jep mundësi të ndërtohen raporte të dobishme miqësore dhe profesionale, që është një prej parakushteve të nevojshme që një diplomat të jetë i suksesshëm në realizimin e funksionit të tij diplomatik, duke përfshirë këtu kontaktet, komunikimin dhe këmbimin e informacioneve të

dobishme edhe në fushën e sigurisë. Kështu, është praktikë e kahmotshme që në kuadër të marrëveshjeve dypalëshe midis shteteve dhe normativës ndërkombëtare për bashkëpunim në fushën e sigurisë, diplomatë dhe ekspertë të sigurisë takohen, bisedojnë, negciojnë, këbejnë përvoja dhe hartojnë plane masash për parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, të trafikëve të njerëzve, të armëve, të drogërave, larjen e parave brenda dhe jashtë shtetit etj., si dhe parandalimin dhe luftimin e ndërmarrjeve ekstreme dhe të rezikshme nga grupe ekstremiste me qëllime terroriste, kundër vendeve, institucioneve, popullatave, bizneseve të caktuara etj. pa marrë parasysh prejardhjen ideologjike, fetare, racore etj. të grupeve apo personave të tillë me rrezikshmëri të lartë për sigurinë, paqen, jetën dhe mirëqenien e njerëzve, kudo që jetojnë ata.

✓ **A është e mundur situata gjeopolitike të përshpejtojë integrimin e vendeve të Ballkanit në BE?**

Veprimet politike, diplomatike dhe veprime të tjera subversive ruse viteve të fundit në vendet e Ballkanit Perëndimor, të mbështetura nga qeveria serbe e Vuçiqit, nga parti politike dhe grupe proruse sllave në rajon dhe në vendin tonë, e me qëllim të pengimit të rrugës së këtyre vendeve për anëtarësim në NATO dhe BE, sidomos veprimet e tilla antidemokratike, bile të dhunshme dhe destabilizuese, të “provuara” në Mal të Zi (tentimi opozitar serb që me mjete të dhunshme dhe me ndihmën e agjenturave ruso-serbe ta rrëzojnë qeverinë demokratike të Milo Gjukanoviçit) dhe në Maqedoninë e Veriut (rasti i përgjakshëm i 27 prillit 2017 në parlament, kur agjentura ruso-serbe dhe forca institucionale ushtarko-policore proruse në vendin tonë, duhej me çdo kusht të pamundësojnë rrugëtimin e vendit drejt eurointegritimeve), dhe, e gjithë kjo me qëllim të krijimit të gjeopolitikave të reja vendore dhe rajonale nën ndikimin dhe kupolën ruse. Qëllimi rus që përfundimisht përcaktues që të realizohen vizita dhe angazhime direkte të institucioneve dhe të funksionarëve të lartë politikë dhe diplomatikë nga BE dhe SHBA në rajon dhe në vendin tonë, të cilët mundësuan mosrealizimin e projektit të këtyre rus dhe mundësuan anëtarësimin e Malit të Zi dhe të Maqedonisë së Veriut në NATO etj.

✓ **Në cilat sfera të interes të përbashkët, mund të ndikojnë pozitivisht marrëdhënjet bilaterale?**

Në ato fusha ku shtetet kanë interes të përbashkët, ato nënshkruajnë marrëveshje dypalëshe, realizimi me sukses i të cilave krijon mundësi dhe hapësirë për zgjerimin dhe avancimin e

mëtejshëm të marrëdhënieve në kahje pozitive. P.sh., kur një marrëveshje dypalëshe për bashkëpunim në fushën e kulturës nxit bashkëpunim të ndërsjellshëm të institucioneve kulturore, të teatrove, të kineastëve, të shkrimarëve, të piktorëve, të kompozitorëve, të shoqërive kulturore artistike etj., kjo do të thotë se bashkëpunimi i këtillë zhvillohet me vizita dhe prezente programore të ndërsjella, duke afirmuar aspekte të kulturës dhe të traditës vetjake, të veprave të ndryshme kulturore dhe artistike, të artistëve në vendin tjetër e tj. Vizitat e këtilla krijojnë miqësi institucionale dhe private, që sigurisht se reflektohen edhe në marrëdhëniet dypalëshe ndërmjet dy vendeve.

✓ **Çfarë ndikimi ka pasur pozita e volitshme gjeografike e Italisë në raport me vendet tjera?**

Italia shtrihet në Europën Jugore dhe në tri anë është e rrethuar me det. Ka pozitë shumë të volitshme gjeografike dhe kushte shumë të përshtatshme klimatike. Si e tillë, është vend i preferuar dhe tërheqës për dhjetëra milionë turistë të huaj në vit nga Europa dhe e gjithë bota. Mu turizmi, ai malor dhe dimëror në veriun industrial, ai liqenor, ai detar, ai agrar, ai fshatar dhe ai arkeologjik e bëjnë vendin të veçantë dhe të njohur nga e gjithë bota. Pozita e volitshme gjeografike, infrastruktura moderne rrugore, ajo ferroviane, ajo detare dhe ajo ajrore, patjetër që ndikojnë në zvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe industrial, si dhe në rritjen vazhdimisht të interesit të investitorët e huaj për investime të mëdha në sektorë të ndryshëm në këtë vend. Si vend i zhvilluar industrial, Italia ka qenë dhe mbetet destinacion i preferuar emigrimi për motive ekonomike i qindëra mijë emigrantësh nga vende të Europës Lindore, nga Ballkani Perëndimor dhe nga vende e kontinente tjera, të cilët ndihmojnë familjet dhe zhvillimin e vendeve të tyre nga fitimet në këtë shtet. Gjithashtu, emigracioni ka ndikuar në përmirësimin e raporteve bilateale të shteteve të origjinës së emigratnëve me shtetin italian. Këtu, sigurisht se duhet përmendur edhe pelegrinazhin (turizmin fetar) nga besimtarë të shumtë katolikë gjatë gjithë vitit nga e gjithë bota, të cilët vizitojnë Vatikanin, si qendrën botërore të besimit katolik, vizitojnë kisha, objekte dhe monumente të tjera të njohura fetare në Romë, Firenze, Veneci etj.

✓ **Çfar duhet të bëj dhe ku duhet të punoj Qeveria e Shqipërisë për të siguruar antarësimin e vendit në BE?**

Që Shqipërisë t'i hapen negociatat për anëtarësim në BE gjatë periudhës së ardhshme, qeveria dhe institucionet tjera relevante duhet të kryejnë detyra konkrete dhe shumë të vështira institucionale në vend, me qëllim që ta reformojnë drejtësinë, sistemin zgjedhor, ta luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar, ashtu që para drejtësisë të dërgohen bandat kriminale dhe krerët e tyre, dhe të shkëputen dhe sanksionohen lidhjet politike me krimin e organizuar, ta përfundojnë dekanabizimin e vendit dhe ta luftojnë trafikun me lëndë narkotike dhe me qenie njerëzore, si dhe të gjejnë zgjidhje për t'i tejkaluar rivalitetet politike pozitive-opozitive, të cilat e kanë çuar opozitën e bashkuar në protesta të mëdha të shpeshta në Tiranë dhe qytete tjera, në djegien e mandateve të tyre në parlamentin shqiptar, me kërkesën kryesore që të dorëhiqet qeveria dhe të shpallen zgjedhje të parakohshme parlamentare me qeveri kalimtare, por pa kryeministrin Edi Rama në të etj. Por, kërkesat e opozitës së bashkuar shqiptare, deri tani janë të papranueshme si për qeverinë, ashtu dhe për faktorin ndërkombëtar.

✓ **Sipas jush, ku mendoni se ka nevojë diplomacia Shqiptare dhe Italiane për tu rregulluar ose reformuar tërësisht?**

Sa i përket pyetjes së dejtperdrejte se ku ka nevojë për t'u rregulluar dhe reformuar tërësisht diplomacia italiane dhe ajo shqiptare, mendoj se diplomacia italiane ka konsistencë në veprimtarinë e saj, bazuar në normativën ligjore vendore dhe të asaj të BE, me vërejtje se mund të bëjë më shumë në bashkëpunim me vendet e origjinës së flukseve të përditshme të emigrantëve drejt këtij vendi në rrugë detare, me qëllim të investimeve nga Italia dhe BE në ato vende afro-aziatike, gjë që do ta zvogëlonte dukshëm numrin e madh të emigrantëve të cilët, për shkaqe ekonomike, politike dhe të sigurisë, synojnë këtë vend dhe vende tjera të BE. Kurse, lidhur me nevojën për rregullimin dhe reformimin e tërësishëm të diplomacisë shqiptare, do të thoja se një reformë e nevojshme me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit në veprimtarinë e përgjithshme të diplomacisë shqiptare brenda dhe jashtë vendit, mund të kishte të bëjë me stafin e politizuar diplomatik dhe me rrjetin e gjerë të përfaqësive diplomatike konsullore në botë. Pra, në kontekstin e pyetjes, reformimi i diplomacisë shqiptare do të nënkuptonte depolitizimin, departizimin, profesionalizimin e vazhdueshëm dhe luftën kundër korrupsionit në strukturën diplomatike shqiptare.

✓ **A mendoni se kriza e emigrantëve mund të ngadalësoj procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Be?**

Mendoj se Shqipëria arrin me sukses të parandalojë hyrjen në territor të grupeve të vogla emigrantësh dhe, aktualisht, nuk është vend i rrezikuar nga kriza e emigrantëve, ashtu sikur Malta, Italia, Spanja dhe Franca.

✓ **Çfarë pasojash praktike mund të sjellë partneriteti strategjik mes dy shteteve?**

Me sintagmën partneritet strategjik midis dy vendeve nënkuptohet që midis tyre ka të nënshkruar marrëveshje domethënëse strategjike në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë. Marrëveshja e tillë rregullon dhe precizon bashkëpunimin e ndërsjellshëm në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë, çështje të aftësisë të kuadrove të fushave respektive në njërin ose në vendin tjetër, çështje dhe nevoja të armatimit, të teknologjive ushtarake etj. P.sh., nëse njërit vend i cenohet tërësia territoriale, siguria e brendshme nga grupe ekstremiste dhe terroriste nga brenda ose nga jashtë, vendi tjetër obligohet që partneritet strategjik t'i ofrojë ndihma në ekspertë të caktuar dhe në mjete të nevojshme për t'i luftuar rastet dhe dukuritë e tilla terroriste, me qëllim të mbrojtjes dhe ruajtjes së sigurisë të popullatës vendase e tj. Por, nëse ndodh që një vend lidh partneritet strategjik me një vend me qeveri të papërgjegjshme, siç është Rusia e Vlladimir Putinit, mund të rasisë që në vend të një partneri strategjik, të fitohet një gllabërues i vlerave të mëdha pasurore të shtetit partner dhe dominues në ekonominë e tij, ashtu siç e gjeti Serbinë ku, midis tjerash, Rusia tanimë ka futur në dorë kompani të mëdha publike të Elektroenergjisë, të Ferrovisë etj.

***Muhamed Rakipi***

- ✓ **Cili është roli I faktorit ndërkombëtarë për politikën e jashtme dhe marrëdhënjet ndërkombëtare?**

Ndikon ne stabilizimin e shteteve, politikave ekonomike, pengimin e konflikteve, avancimin e mardhenieve bilateral dhe multilateral, mbrojtjen e ambientit jetsor, respektimin dhe permbushjen e marveshvjeve nderkombatare etj.

- ✓ **Cili është qëndrimi I ambasadorëve dhe diplomatëve në lidhje me situatat politike?**

Ketu duhet pasur parasysh nje ndarje shume thelbesore ndermjet aspektit “legjislative” dhe ati “ekzekutive”. Politika e jashtme ne shtetet demokratike formulohet nga qeveria me pajtimin e perfaqsesve te zgjedhur nga populli (parlamenti), ndersa ekzekutimi u lihet profesionistve si dhe nje nivel I caktuar I diskrecioni ne lidhje me ate. Ne fazen “legjislative” politika formsohet dhe vendoset ndersa ne fazen “ekzekutive” ajo implementohet. Ambasadoret dhe perfaqsesit e tjere diplomatic u permbahen instruksioneve te dhena nga ministria e puneve te jashtme dhe akteve nderkombtare qe regullojn kete fushe si Vienna Convention on Diplomatic Relations, Vienna conventions on Consular Relations. Neni 3 I konventes se vjenes I numeron funksionet e missionit diplomatik dhe pergjithsisht diplomatet u permbahen ketyre dhe nuk duhet ti tejkalojn, per shkak se mund te shpallen persona non grata dhe ti veshtirsojn mardheniet ndermejt shteteve.

- ✓ **A mund të kemi komplikime në marrëdhënjet bilaterale mes dy shteteve, nëse ndodhin ndryshime në kushtetutëne njerit shtet?**



Sigurisht se po dhe kjo varet nese me ato ndryshime cenohet interesat e pales tjeter si teresia teritoriale apo identiteti dhe kultura qe jane ceshtje shume te ndjeshme. Keto ndryshime zakonisht kundërshtohen nga pala tjeter dhe si rezultat kemi komplikime ne mes mardhenieve bilateral. Keto jane edhe me te theksuara kur shtetet gjeografikisht ndodhen afer njeri tjetrit.

✓ **A mund të presim se negociatat të prodhojnë zgjedhje përfundimtare në zgjedhjen e çështjeve ndërkombëtare?**

Negociatat jane vetem nje nga taknikat te cilat shtet kane dispozicion per zgjedhjen paqesore te mosmarveshjeve ne mes tyre dhe jo cdo here edhe sjellin zgjedhje perfundimtare te ceshtjeve. Palet mund te jene ne nje pozite jot e barabarte edhe pse de jure UN Charter 1(2) de facto nuk jane dhe njera pale mund te vendoset ne nje pozite te pafavorshme sidomos ne ato raste kur pala eshte e perjashtuar apo nuk eshte perfaqsuar ne nje menyre te duhur, vlera e marveshjes zvoglohet duke bere object I mundshem mosmarveshje ne te ardhmen. Megjithate u sherbejn paleve qe te mos eskaloj mosmarveshja dhe te shmanget perdorimi i forces. Zgjedhja paqesore e mosmarveshjeve nderkombtare eshte nje nga principet fundamentale te se drejtes nderkombtare me nje karakter te detyrueshem (ius cogens).

✓ **Çka do të përfitoj politika e jashtme e Shqipërisë dhe vendeve tjera të Ballkanit pas integrimimit në Bashkimin European?**

Kjo do te jete dicka qe do te shihet pas integrimit te ketyre shteteve dhe harmonizimin e politikës se jashtme me politikat e shtetet anetare.

✓ **Sa ka ndikuar Italia në procesin e integrimit të Shqipërisë ne Unionin European?**

Italia eshte nje nga shtet themeluese te BEE-se dhe luan nje rol mjaft te theksuar ne politiken e UE-se. Duke pasur parasysh edhe mardheniet e shkelqyra ndermjet te 2 vendeve dhe shkembimin e pervojave dhe lobimin Italian, ne shtetet tjera qe kane rezerva per reformat te cilat jane duke ndodhur ne shqiperi, vetingu I gjyqtareve dhe prokuroreve, lufta kunder narkotikve, bashkpunim ne sferen e sigurise, reformat ne polici, ushtri, ne legjislaturen.etj.

- ✓ **Çfarë përfitimesh sjellin takimet e diplomatëve me homologët e tyre, por edhe me zyrtar të tjerë, rreth çështjes së sigurisë?**

Me takime të shpeshta mund të shkëmbehen përvoja, informacione lidhje me të ngushta dhe mund të gjenden zgjidhje të përbashkta për çështje të sigurisë.

- ✓ **A është e mundur situata gjeopolitike të përshpejtojë integrimin e vendeve të Ballkanit në BE?**

Sigurisht se po gjeopolitika gjithmonë ka luajtur një rol të rëndësishëm në marrëdhëniet ndërkombëtare që nga koha e antikitetit (shih *History of the Peloponnesian War* by Thucydides) dhe vazhdon të luajë edhe sot një rol gati dominues. Në lidhje me integrimin në bashkimin Europian mund kjo të përshpejtojë procesin e integrimit: PO! Integrimi i Bullgarisë dhe i Romanisë në bashkimin europian u realizua duke pasur parasysh konsideratat gjeopolitike dhe jo plotësimin e kriterëve për antarsim në këtë Union. Edhe antarsimi eventual i Serbisë është i kushtëzuar me një marrëveshje me Kosovën.

- ✓ **Në cilat sfera të interesit të përbashkët, mund të ndikojnë pozitivisht marrëdhënjet bilaterale?**

Mund të ndikojnë në të gjitha sferat duke filluar nga siguria, ekonomia, kultura, arsimit, mbrojtjen e ambientit jetësor etj.

- ✓ **Çfarë ndikimi ka pasur pozita e volitshme gjeografike e Italisë në raport me vendet tjera?**

Ashtu si me çdo qytetërim, vendndodhja dhe burimet në dispozicion luajnë një rol të madh në suksesin e atij civilizimit. Italia ka pasur shumë përparësi në respekt të gjeografisë dhe burimeve që kishte në dispozicion. Ka male, tokë pjellore, lumenj, gadishuj dhe rrafshinat që ndihmuan në mbrojtjen dhe rritjen e këtij qytetërimit.

- ✓ **Çfarë duhet të bëjë dhe ku duhet të punoj Qeveria e Shqipërisë për të siguruar antarësimin e vendit në BE?**

Të reformoj administratën publike me qëllim që të rrisë profesionalizmin dhe depolitizimin e saj  
Të forcojë pavarësinë, efikasitetin dhe përgjegjësinë e institucioneve gjyqësore

Te luftoje korupsionin

Te luftoje krimin e organizuar sidomos prezenca e theksuar ne Itali

Te avancoje lirite dhe te drejtat e njeriut

- ✓ **Sipas jush, ku mendoni se ka nevojë diplomacia Shqiptare dhe Italiane për tu regulluar ose reformuar tërësisht?**

Si diplomat I Republikës së Maqedonisë është vështirë për tu përgjigjur

- ✓ **A mendoni se kriza e emigrantëve mund të ngadalësoj procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE?**

Po mund të ketë pasoja për shkak të prioritetizimit të BE-së në lidhje me këtë por në mënyrë indirekte mund të ketë pasoja edhe me të theksuara në shtetet anëtare në lidhje rritje e nazionalizmit dhe urrejtjes ndaj të huajve.

- ✓ **Çfarë pasojash praktike mund të sjellë partneriteti strategjik mes dy shteteve?**

Mund të ketë pasoja praktike në sigurinë, stabilitetin dhe zhvillimin ekonomik

### *Refet Emini*

- ✓ **Cili është roli I faktorit ndërkombëtarë për politikën e jashtme dhe marrëdhënjet ndërkombëtare?**

Faktorit ndërkombëtar për politikën e jashtme dhe marrëdhënjet ndërkombëtare, vecanarisht ne periudhen bashkekohore, ka rol shumë të rëndësishëm (sidomos për vendet e Ballkanit) për shkak se është thellë i kycur në ndërtimin e politikës së jashtme dhe zhvillimin e reformave drejt integritimit euroatlantike.

- ✓ **Cili është qëndrimi i ambasadorëve dhe diplomatëve në lidhje me situatat politike?**

Qëndrimi i ambasadorëve dhe diplomatëve në lidhje me situatat politike kryesisht është në drejtim të gjetjes së zgjedhjeve nepermjet negociatave me mjete diplomatike, duke u munduar të evitohet thellimi i krizave dhe situatave konfliktuale.

- ✓ **A mund të kemi komplikime në marrëdhënjet bilaterale mes dy shteteve, nëse ndodhin ndryshime në kushtetutën e njerit shtet?**

Nese ndryshimet kushtetuese prekin interesin e shtetit tjetër mund të vijë deri të komplikime në marrëdhënjet bilaterale.

- ✓ **A mund të presim se negociatat të prodhojnë zgjedhje përfundimtare në zgjedhjen e çështjeve ndërkombëtare?**

Zgjedhja përfundimtare në radhë të parë mvaret nga fakti sa është komplekse çështja dhe sa janë realisht të interesuara palët për zgjedhje. Historikisht jemi dëshmitar se disa çështje ndërkombetare janë zgjedhur përmes negociatave. Nga ana tjetër ka çështje për të cilat për një periudhë të gjatë kohore nuk arrihet deri tek zgjedhja përfundimtare. Disa zgjasin dhe me decenje të tëra (si p.sh problemi i Palestines etj).

✓ **Çka do të përfitoj politika e jashtme e Shqipërisë dhe vendeve tjera të Ballkanit pas integrimimit në Bashkimin Europian?**

Pas integrimimit në Bashkimin Europian politika e jashtme e Shqipërisë dhe vendeve tjera të Ballkanit në radhë të parë do të jetë e harmonizuar me politikat e përbashkëta të BE-së, që do të thotë dhe pozicionim më të favorshëm dhe ndikim më të madh në vendimë marrje rreth shumë çështjeve të rëndësishme ndërkombëtare, së pari në interes të vetë Shqipërisë.

✓ **Sa ka ndikuar Italia në procesin e integrimimit të Shqipërisë në Unionin Europian?**

Sfidat e integrimimit të Shqipërisë në BE janë të ndryshme dhe jo dornosdoshmërisht kanë të bëjnë vetëm me përparimin e vendit në konsolidimin e demokracisë, sundimin e ligjit dhe të ekonomisë së tregut. Italia në këtë drejtim mendoj që ka ndikuar dukshëm, në radhë të parë për shkak të marrëdhënjëve të ngushta mes dy vendeve respektive, si në fushën politike, ekonomike, kulturorë-arsimore etj. Padyshim që rol të vecantë ka dhe pozicionimi dhe afërsia gjeografike mes dy shteteve. Shqipëria në BE gjithësesi është dhe interes i Italisë.

✓ **Çfarë përfitimesh sjellin takimet e diplomatëve me homologët e tyre, por edhe me zyrtarë të tjerë, rreth çështjes së sigurisë?**

Keto takime janë shumë të rëndësishme në diplomacinë ndërkombëtare, qofshin bilaterale apo në rrafsh multilateral sepse mundesojnë në radhë të parë një preventive ndërkombëtare në fushën e sigurisë globale. Sidomos në kohë kur situata e sigurisë është shumë fragjile dhe kanë rrethëzime nga me të ndryshmet, si sulme terroriste etj.

✓ **A është e mundur situata gjeopolitike të përshpejtojë integrimin e vendeve të Ballkanit në BE?**

Ka mundësi reale, sidomos duke patur parasysh interesin e rritur/ringjallur të Rusisë për rajonin.

✓ **Në cilat sfera të interes të përbashkët, mund të ndikojnë pozitivisht marrëdhënjet bilaterale?**

Marrëdhënjet bilaterale padyshim që kanë impakt pozitiv në sfera të interes të përbashkët, si ajo politike, ekonomike, arsimore, kulturore, në lëmi të sigurisë së përbashkët etj. Për vendet e Ballkanit bashkëpunimi bilateral dhe rajonal është paresor dhe në rrugën drejt integritimit (NATO, BE).

✓ **Çfarë ndikimi ka pasur pozita e volitshme gjeografike e Italisë në raport me vendet tjera?**

Duke patur parasysh faktin që Italia ndodhet në pjesën jugore të Evropës, në gadishullin në pjesën qendrore të detit Mesdhe, në veri të Shqipërisë, pastaj sipërfaqja e përgjithshme e Italisë dhe vija bregdetare që është 7,600km kanë pasur padyshim ndikim pozitiv në radhë të parë për zhvillimin ekonomik të saj por dhe në raport me vendet tjera. Ketu nuk bëjnë përjashtim as vendet e Ballkanit, sidomos Shqipëria.

✓ **Çfarë duhet të bëjë dhe ku duhet të punoj Qeveria e Shqipërisë për të siguruar antarësimin e vendit në BE?**

Elementet kyçe të cilat, në këtë rrugetim të Qeverisë së Shqipërisë drejt BE-së janë të domosdoshme, kanë të bëjnë me përparimin e vendit në konsolidimin e demokracisë së qendrueshme, sundimin e ligjit dhe të ekonominë së tregut.

✓ **Sipas jush, ku mendoni se ka nevojë diplomacia Shqiptare dhe Italiane për tu regulluar ose reformuar tërësisht?**

Padyshim që çdo herë ka nevojë dhe hapësirë për përmirësim dhe reformin në të gjitha fushat, ashtu dhe në atë të diplomacisë. Sa i përket diplomacisë Shqiptare mendoj se duhet punuar më shumë në drejtim të promovimit sa më të mirë të vendit, në rrafshin politik, ekonomik, kulturor, turistik etj. Kjo mund të arrihet vetëm me zhvillim dhe intensifikim të marrëdhënjeve të vendit me vendet demokratike, si SHBA, vendet e BE-së, por dhe me bashkëpunim fqinjësor me vendet e rajonit etj.

✓ **A mendoni se kriza e emigrantëve mund të ngadalësoj procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE?**

Kriza e emigrantëve ka gjasa të ngadalësoj procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në BE, sidomos nëse ajo përshkallëzohet dhe rritet fluksi i migrantëve që shfrytëzojnë Shqipërinë dhe rajonin si rrugë tranzitore. Sidomos kur dihen qëndrimet e BE-së dhe në vecanti të disa vendeve të rëndësishme lidhur me këtë problem. Barra bëhet dhe më e rëndë në prag të zgjedhjeve evropiane dhe politikave të brendshme të disa shteteve të BE-së. Problem i vecantë në këtë drejtim ngel disponimi anti-migracion në shtetet e BE-së.

✓ **Çfarë pasojash praktike mund të sjellë partneriteti strategjik mes dy shteteve?**

Partneriteti strategjik Shqipëri-Itali, sipas bindjes dypalëshe në radhë të parë ngel garanci për bashkëpunimin ekonomik, tregtar, rajonal e global. Në këtë drejtim Italia është zotuar për mbështetje të Shqipërisë gjatë drejtimit të Grupit të kontaktit për Mesdheun në 2019, Kryesisë së OSBE-së në 2020 dhe Grupit të kontaktit për Azinë në 2021.

Partneriteti strategjik, mund të hasë në pasoja praktike (negative) vetëm në rast mospërkushtimit në masë të domosdoshme, dhe në rast përshkallëzimi të situatës së brendshme në Shqipëri, si moszbatimi i reformave drejt BE-së, konflikti i brendshëm politik etj.

*Semra Ramadani*

- ✓ **Cili është roli I faktorit ndërkombëtarë për politikën e jashtme dhe marrëdhënjet ndërkombëtare?**

Cdo shtet I pavarur e harton vete politiken e jashtme dhe strategjine e veprimit ne skenen nderkombetare. Megjithate, faktorin derkombetar zakonisht kandikim ne raste krize, gjegjesisht per zgjidhjen e ndonje konflikti bilateral mes dy shteteve.

- ✓ **Cili është qëndrimi I ambasadorëve dhe diplomatëve në lidhje me situatat politike?**

Ambasadoret dhe diplomatet gjate sherbimit ne Perfaqesi Diplomatike Konzulore (PDK) perfaqësojne shtetin e tyre dhe jo veten si person ne shtetin e pranimit apo ne ndonje mission nderkombetare, keshtuqë, si rrjedhoje, ato veprojne ekskluzivisht ne baze te direktivave te ministrise se jashtme te shtetit te tyre.

- ✓ **A mund të kemi komplikime në marrëdhënjet bilaterale mesdy shteteve, nëse ndodhin ndryshime në kushtetutën e njerit shtet?**

Kjo mund te vjen ne shprehje vetem ne rast se me ato ndryshime cenohet integriteti I shtetit tjeter (psh. pretendime territoriale ndaj shtit tjeter)

- ✓ **A mund të presim se negociatat të prodhojnë zgjedhje përfundimtare në zgjedhjen e çështjeve ndërkombëtare?**



Ajo është një ndër mënyrat se si zgjidhen çështjet e hapura mes shteteve, dhe zakonisht është me paqësorja si metode.

✓ **Çka do të përfitoj politika e jashtme e Shqipërisë dhe vendet tjerat të Ballkanit pas integrimit në Bashkimin Europian?**

Politika e jashtme e Shqipërisë në atë rast do të përfitonte një pozitive me të mirë në skenën ndërkombëtare, do ishte shtet me stabil dhe me perkrashje me temadhe.

✓ **Sakandikuar Italia në procesin e integritit të Shqipërisë në Unionin Europian?**

Italia, si shtet fqinj, dhe shtet shumë present në Shqipëri, një partner strategjik i shtetit shqiptar është një ndër perkrashtimet me temedhenj të anetaresimit në Shqipëri në EU.

✓ **Çfarë përfitimesh sjellin takimet e diplomatëve me homologët e tyre, por edhe me zyrtar të tjerë, rreth çështjes së sigurisë?**

Diplomatet zakonisht përcjellin qëndrimet e shtetit të tyre në takimet me homologët e tyre dhe përfitimi me i madh nga këto takime është sqarimi i dilemave të cilat i kanë dy palët për pikat për të cilat diskutohet. Përfitimi ,fundja, është siguria me e lartë e përbashkët e shteteve.

✓ **A është e mundur situatë gjeopolitike të përshpejtojë integrimin e vendeve të Ballkanit në BE?**

Po. Do të duhej të merret si përgatitje, megjithatë nuk është se EU e shfrytëzon shumë këtë kartë në procesin e integritimit, por në vend të saj, ajo insiston në procedurat e saja të rregullta të reformave që çdo njëri shtet duhet të plotësojë para integritimit në vetë EU.

✓ **Në cilat sfera të interesit të përbashkët, mund të ndikoj më pozitivisht marrëdhënjet bilaterale?**

Te gjitha sferat, pa përjashtim. Duke u nisur nga ekonomia, kultura, arsimiti, siguria, turizmi e tj.

✓ **Çfarë ndikimi ka pasur pozita e volitshme gjeografike e Italisë në raport me vendet tjera?**

Si shtet mesdhetar, Italia ka qene dhe eshte nje nder shtet me me ndikim ne Europe dhe jo vetem ne lindjen e mesme. Italia gjithashtu eshte nje nder faktoret kyc kur vjen ne shprehje zgjidhja e konflik te vepreze te atje.

✓ **Çfar duhet të bëj dhe ku duhet të punoj Qeveria e Shqipërisë për të siguruar antarësimin e vendit në BE?**

Definitivisht te percjelle rekomandimet e KE-se ne implementimin e reformave kyce , sic jane ne gjyqesor, sundimin e se drejtes, administrate e tj.

✓ **Sipas jush, ku mendoni se ka nevojë diplomacia Shqiptare dhe Italiane për tu regulluar ose reformuar tërësisht?**

Cdo shtet gjithmone ka hapshire per reforma ne politiken e jashtme, sidomos ne kohen e digjitalizmit maksimal ne te cilen jetojme. Keshtuqe, edhe keto dy shtete munden te reformohen ne ate drejtim...

✓ **A mendoni se kriza e emigrantëve mund të ngadalësoj procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Be?**

Po, mundet, sepse shtetet europiane deshrojne qe pjese e familjes se tyre te jete nje shtet stabil me nje ekonomi te zhvilluar.

✓ **Çfarë pasojash praktike mund të sjellë partneriteti strategjik mes dy shteteve?**

Nese e keni fjalen per perfitime reale, atehere si cdo partneritet ashtu edhe partneriteti strategjik ne mes dy shteteve behet me qellim te realizimit te qellimeve te tyre afatgjate.

*Faton Bejta*

- ✓ **Cili është roli i faktorit ndërkombëtar për politiken e jashtme dhe marrëdhënjet ndërkombëtare?**

Roli i faktorit ndërkombëtar për politiken e jashtme të një vendi të caktuar është tejet e rëndësishme, ku në formë të ndryshme nëpërmjet sugjerimeve ndikon në kursin politik të shtetit në përkrahje të organizatave ndërkombëtare të ndryshme për ruajtjen e qetsisë në regjione të ndryshme dhe ruajtjen e stabilitetit, që ndikon pozitivisht edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ktu mund të shtojmë se vjen në shprehje edhe *Diplomacia* që nënkupton mirëmbajtja e marrëdhënieve në mes të shteteve, nëpërmjet marrëveshjeve si dhe metodave të zbatuara deri tek marrëveshja. Përndryshe diplomacia ndryshe thirret edhe arti i marrëveshjeve.

- ✓ **Cili është qëndrimi i Ambasadoreve dhe diplomateve në lidhje me situatat politike?**

Misioni i Ambasadoreve dhe diplomatëve në shtetet ku akreditohen rregullohet në bazë të Konventës së Vjenës për marrëdhënie diplomatike dhe Konventës së Vjenës për çështje konzulore, ku ambasadori dhe diplomatet për situata të ndryshme veprojnë në bazë të instrukcioneve që i marrin nga shteti dërgues (shteti që e dërgon) duke respektuar konventat e lartpërmendura dhe legjislativën e shtetit mikpritës (shteti ku është i akredituar).

- ✓ **A mund të kemi komplikime në marrëdhënjet bilaterale mes dy shteteve, nëse ndodhin ndryshime kushtetuese në njëri shtet?**

Nvaresisht nga ndryshimet e parapara, ne kuptimin e fjalës që me ndryshimet parapara të mos cenohen intereset e shtetit tjetër dhe nëse vjen në ndonjë komplikim eventuale të marrëdhënies bilaterale dypalshë, roli i diplomacisë është që komplikimet e tilla të tejkalohen nëpërmjet bisedimeve dhe të ruhen marrëdhëniet e mira diplomatike ndërmjet dy shteteve.

✓ **A mund të presim se negociatat prodhojnë zgjedhje përfundimtare në zgjedhjen e çështjeve ndërkombëtare?**

Negociatat janë pjesë e pandarshme e mjeteve diplomatike, për zgjedhjen e ndonjë kontesti të caktuar, në qoftë se edhe marrëdhëniet ndërmjet palëve negociuese të jenë të ftohura ose edhe në gjendje lufte, negociatat duhet çmuar se çdo herë duhet të egzistojnë, nga shkak që deshmimet nga e kaluara e dijmë se edhe shumë konflikte apo luftra nëpër botë, kanë përfunduar nëpërmjet aritjes së negociatave dhe në fund me marrëveshje apo traktate të nënshkruara.

✓ **Cka do të përfitoj politika e Shqipërisë dhe vendeve tjera të Ballkanit pas integrimit në BE?**

Benefitet e Shqipërisë dhe vendet e Ballkanit, pas integrimit në BE do të jenë në drejtim të vendim marrjeve në selinë e BE në Bruksel, si anëtare fuqi plotë në BE, me të nënkuptohet edhe ritja e ndikimit të politikës së jashtme të vendeve të Ballkanit.

✓ **Sa ka ndikuar Italia në procesin e integrimit të Shqipërisë në Unionin Europian?**

/

✓ **7. Çfarë përfitimesh sjellin takimet e diplomatëve me homologët e tyre, por edhe me zyrtarët tjerë, rreth çështjes së sigurisë?**

Për çdo takim diplomatik kur realizojnë me homologët e tyre rreth ndonjë situatë të caktuar, shprehin mendimet e tyre në bazë të informacioneve që i posedojnë dhe për takimet e realizuara i informojnë shtetet e tyre.

✓ **A është e mundur situatë gjeopolitike të shpejtojnë integrimin e vendeve të Ballkanit në BE?**

Situatë gjeopolitike mund ta përndihmojnë integrimin e vendeve të Ballkanit në BE, por patjetër nga ana e vendeve të Ballkanit duhet zbatuar edhe reformat që i kërkon Brukseli zyrtar nga ta.

✓ **9. Ne cilat sfera te interes te perbashket, mund te ndikojne pozitivisht mardhenjet bilateral?**

Interes I cdo shteti eshte te mban mardhenje te mira bilateral me cdo shtet, ne funksion te perparimit te mardhenieve politike, ne fushen e ekonomise, kultures etj.

✓ **Cfare ndikimi ka pasur pozitia e volitshe gjeografike e Italise ne raport me vendet tjera?//**

✓ **Cfare duhet te bej dhe ku duhet te punoj Qeveria e Shqiperise per te siguruar antaresimin e vendit ne BE?//**